

Ndërsa Kadareja niste rrugën krijuese, letërsinë tonë e kishin goditur tri hiataste të mëdha: 1. Vdekja e hershme e Migjenit më 1938. Askush nuk i ka shpëtuar as i shpëton hamendjes se çfarë vallë do të kishte sjellë një krijues i tillë me të dhëna gjeniu. 2. Ndalimi i Fishtës në të gjithë hapësirën shqiptare, në Republikën e Shqipërisë dhe në ish Jugosllavi si shovinizist antisllav në jetën dhe në veprën e tij. Të gjithë pajtohemi se letërsia, kultura, jeta shpirtërore, sidomos gjuha shqipe, sidomos zhvillimet gjuhësore shqiptare pësuan shumë rëndë nga ky përjashtim. 3. Heshtja e Lasgush Poradecit, më të madhit të lirikës sonë. Ishte heshtje e dhunshme në shkëmbim të lirisë fizike. Ishin tri hiataste të mëdha në gjëmën e përbashkët që sillte komunizmi në Shqipëri.

Ja mundësitë që edhe Kadareja të ishte një hiatus.

UDHËTIM ESTETIK NË APOGJETË E UNIVERSIT KADAREAN

Nga Skënder Buçpapaj



Shefkije Islamaj, studiuesja që ndjek majat e artit të gjuhës

Nga Tefë Topalli

(fq. 12)

Që prej 40 vjetësh, kur u shfaq me botime shkencore në lëmë të gjuhës së autorëve tanë, e kupton se prof. Sh. Islamaj, ka synuar dhe ka arritur të bëjë objekt të punës së saj veprat e tre emrave më të shquar të letërsisë shqiptare: *i pari*, *Jakov Xoxa*, në shkrimtarinë e jashtëzakonshme të të cilit, ka zbuluar se në të parën sagë romanore të letërsisë sonë.

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani “Fati i marrë” i Besnik Mustafajt

KJO ËSHTË VETJA IME E VËRTETË

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 8)

Përkitazi me librin me poezi të përzgjedhura “Treni nisej, faculeta digjej”, të poetit Adem Gajtani

RIKTHIMI NË SHKUP I POETIT ADEM GAJTANI

Nga Emin Azemi

(fq. 5)

Shënime rreth vëllimit me tregime “Ku shkojnë këto gra të çuditshme?” të Zoica Gjolla Popit

VËRTET, KU SHKOJNË KËTO GRA?

Nga Mark Simoni

(fq. 9)

Si e shkrova romanin
“Një grua midis dy burrave”
me shkrimtarin shqiptar
Skifter Këllici

nga Carrie Hooper

(fq. 14)



Piktura nga Pashk Pervathi

Në 100 - vjetorin e lindjes së shkrimtarit Atë Zef Pllumi

“FRANÇESKANËT E MËDHAJ”, NJË MODEL KUJTIMESH TË ARTA

Prof. dr. Alfred Çapaliku

“NUK E DIJSHIM SE DO MBËRRIJMË LIRINË”

Në bisedë me Gjergj Metën

LIBRI MÂ I BUKUR N’BOTË ...!

Në bisedë me Dhurata Shehrin dhe Persida Asllanin

Intervistë me poetin danez

NIELS HAV Vdekja është Tabu

Përktheu: Kujtim Morina

(fq. 22)

SYLVIA PLATH Mari Ventura dhe mbretëria e nëntë

Përktheu: Qerim Raqi

(fq. 20)



BIBLIOTEKË

Esmeralda Shpata

(fq. 14)

Atëherë, kur dinim të duheshim

Fatmir Alimani

(fq. 18)

Sekreti i Laokonit

Durim Çaça

(fq. 19)

Ritme kadence vere

Arben Meksi

(fq. 17)

Karikatura e së shtunës

Stefan Çapaliku, *Jokes of Albanian Communist Days*

BARCOLETA E FUNDIT E KOMUNIZMIT, HUMORI I FSHEHTË NË KOHËN E QEVERISJES SË ENVER HOXHËS

Nga Bozho Kovaçeviq

(fq. 10)

PËR LIBRIN FLITET E FLITET PA FUND DHE... BËHET ASGJË

(fq. 15)

Përshtypje nga Xhevair Lleshi

DASHURIA - NJË TABU NË FILMIN SHQIPTAR

Nga Vangjush Saro

(fq. 16)

Pati lindur të mëkurën, Kadaréja ndërroi jetë të hënën. Dita e parë e javës përkonte me datën e parë të muajit korrik. I ndriti fati. Për herë të fundit shikoi ditë. Nuk u largua as me këtë peng.

Ndërsa Kadareja niste rrugën krijuese, letërsinë tonë e kishin goditur tri hiatuse të mëdha: 1. Vdekja e hershme e Migjenit më 1938. Askush nuk i ka shpëtuar as i shpëton hamendjes se çfarë vallë do të kishte sjellë një krijues i tillë me të dhëna gjeniu. 2. Ndalimi i Fishtës në të gjithë hapësirën shqiptare, në Republikën e Shqipërisë dhe në ish Jugosllavi si shovinist antisllav në jetën dhe në veprën e tij. Të gjithë pajtohemi se letërsia, kultura, jeta shpirtërore, sidomos gjuha shqipe, sidomos zhvillimet gjuhësore shqiptare pësuan shumë rëndë nga ky përjashtim. 3. Heshtja e Lasgush Poradecit, më të madhit të lirikës sonë. Ishte heshtje e dhunshme në shkëmbim të lirisë fizike. U shpërblye duke mos ia ndaluar në Shqipëri veprën e deriatëhershme, duke e lejuar (detyruar) për bukën e gojës të përktente çfarë ta urdhëronin. Nga ardhja e komunizmit deri në fund nga Lasgushi kemi krijimtari të re të botuar vetëm epikat “Baladë për Muharrem Çollakun”, “Mbi ta” (poemë për luftën e Lumës kundër agresorëve serbë), “Kamadevën” poemë lirike filozofike në dorëshkrim dhe ditarin e tij në dorëshkrim.

Ishin tri hiatuse të mëdha në gjëmën e përbashkët që sillte komunizmi në Shqipëri.

Ja mundësitë që edhe Kadareja të ishte një hiatus:

Mundesia më e mirë ishte ajo e të arratisurit politik. Si Ernest Koliqi. Si Arshi Pipa. Si Martin Camaj. Si Bilal Xhaferi. Këta dhe të tjerë të arratisur politikë nga regjimi i Enver Hoxhës zhvilluan veprimtarinë e tyre politike, krijuese dhe jetësore kryesisht në Perëndim. Veprës së tyre të krijuar në Perëndim i mungoi lexuesi shqiptar si në Shqipëri dhe Ish Jugosllavi.

Në kujtimet e Helena Kadaresë “Koha e pamjaftueshme” përmendet një projekt dhe një tentativë e Ismail Kadaresë për t’u arratisur.

Mundësia tjetër ishte ajo e të internuarit apo edhe e të burgosurit politik. Krijimtaria e tij do të ndërpritej, vepra e deriatëhershme do t’i ndalohej. Është një listë tejet e gjatë e shkrimtarëve dhe artistëve që përfunduan në burgje, internime, përndjekje të vazhdueshme politike. Në këtë kategori përfshihen shkrimtarë që u rehabilituan pjesërisht, të tjerë që nuk u rehabilituan kurrë, disa prej tyre, ndonëse krijuan edhe në ato kushte, vepra e tyre edhe sot e kësaj dite është e pabotuar (në disa raste) ose pothuaj e pabotuar (në raste të tjera).

Mundësia e tretë dhe fatale: dënimi me pushkatim ose me varje. Këtë fat patën Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, Genc Lekaj (pushkatim), Hafiz Nela (varje).

Mundësi e katërt dhe fatale: vetëvrasja fizike. Kadareja në kujtimet e veta tregon se pas botimit të novelës “Përbindëshi” atij iu krijuan rrethana që mund ta çonin në vetëvrasje saqë ai e vinte jetën e tij brenda kllapave të rrumbullakëta (1936-1966).

Mundësia e pestë edhe më fatale: vetëvrasja shpirtërore.

Kadareja nuk u shndërrua në asnjërin prej këtyre hiatusëve. Një fat i madh i krijuesit dhe i vetë letërsisë shqipe, kulturës dhe jetës shpirtërore shqiptare.

U bë i famshëm në moshë shumë të re. E përballoi famën me sukses të plotë. Jo kushdo mund t’ia arrinte. Dhe është meritë e tij, në të cilën nuk mund t’i ndërlikohet askush tjetër.


Midis ngasjes së famës, muzës së krijimit dhe etjes për liri pati një harmoni nga më të përkryerat e mundshme.

HAPËSIRA E LIRISË

Në fillim të viteve 1990, më duket në

UDHËTIM ESTETIK NË APOGJETË E UNIVERSIT KADAREAN

Nga Skënder Buçpapaj



kthimin e parë pas mërgimit politik në Francë, Kadareja foli për hapësirën e lirisë. Secili krijues, sipas tij, e krijon dhe e zgjeron hapësirën e tij të lirisë. Dhe, mes tjerash, dha shembuj të kolegëve që kishin shkuar deri në pragun e krijimit vendimtar të hapësirës së lirisë, por nuk ia kishin arritur, duke përfunduar, së paku, në burg politik.

Ai vetë e shënon si një nga hapat më vendimtarë pikërisht novelën “Përbindëshi”. Nëse ai vetë thyhej apo nëse diktatura nuk e pranonte sfidën që i bëhej, ai përfundimisht ose do të binte në pranga ose do të vetëprangosej duke iu nënshtruar censurës dhe duke e vrrarë veprën e tij, duke bërë praktikisht vetëvrasje krijuese.

Kadareja ia ka pohuar me gojën e tij botuesit Bujar Hudhri se e ndiente veten të lumtur që ia arriti të botojë gjithçka që shkroi.

Gjatë diktaturës, nga veprat e krijuara, nuk u dërgua as për botim “Qyteti pa reklama”.

U dërgua “Në mesditë Byroja Politike u mblodh” (1974) e cila u hoq nga botimi në shtypshkronjë nga kryeredaktori i atëhershëm i gazetës “Drita”.

Poema iu dërgua sekretarit ideologjik të partisë Ramiz Alia për t’iu marrë miratimi ose jo i botimit. Ramiz Alia nuk e mori dot vendimin pa ia dhënë ta lexojë vetë Enver Hoxhës.

Vetë ky fakt na tregon përfundimisht se aparati i censurës ndaj Kadaresë fillonte me redaktorin më të thjeshtë dhe mbaronte me vetë Enver Hoxhën.

Me çdo krijim që Kadareja e dërgonte për botim, i vinte në provë të madhe botuesit dhe vetë aparatin e censurës. Redaktorët nuk e fshihnin se Kadareja ndaj çdo vërejtjeje redaktoriale, të cilën e merrte parasysh, bënte në krjimet e veta përmirësime artistike mahnitëse asosh jo vetëm shmangëse apo mashtruese ndaj censurës. Dhe me çdo krijim të ri të botuar arrinte një zgjerim të hapësirës së tij të lirisë. Triumfet më të mëdha të lirisë së tij kanë qenë pikërisht edhe rezistencat më të mëdha e më të rrezikshme të aparatit të censurës ndaj botimeve të tij.

Kadareja lindi në një periudhë kur Shqipërisë i vinte brezi më i ndritur i intelektualëve, krijuesve, filozofëve, i njohur si brezi i viteve ‘30, i tillë saqë vetë Kadareja thotë tek “Prilli i thyer” se nuk gjenin hapësirë ku të realizonin veten e tyre në një Shqipëri që sapo kishte filluar të mëkëmbej.

Pikërisht në atë Shqipëri mbretërore, të politikës së dyerve të hapura, shqiptarët u ndjenë më të lirë se kurrë dhe më krenarë se kurrë ndaj përkatësisë kombëtare. Për herë të parë në histori shqiptarët lindnin si qytetarë me ndjenjën e lirisë.

Atdhetarizmi kombëtar i krijuar në vitet e mbretërisë ishte thelbësisht i ndryshëm nga atdhetarizmi i mëvonshëm, ai i diktaturës apo i tranzicionit.

Siç e shënon me të drejtë ndonjë studiues, kur Kadareja shkoi në shkollë, poet kombëtar i shqiptarëve ishte Dante.

Shqiptarët nga qytetarë të një perandorie të madhe osmane, kishin kaluar në qytetarë të një shteti të vogël të hapur ndaj botës. Tek “Pallati i Ëndrrave”, një Qypërli, i përmendur në roman si “kushëriri”, thotë për shqiptarët, bashkëkombësit e tij: “- Ata do ta fitojnë ndonjë ditë pavarësinë vërtet. ... Do të humbin këtë hapësirë vigane ku fluturojnë si era, do të mbyllen në atë truallin e tyre të ngushtë, krahët do t’iu pengohen e do t’iu përplasen nga një mal në tjetrin, si shpendët që s’marrin dot fluturimin, do të vyshken, do të squllen e, më në fund, do të thonë: ç’fituam kështu?! Atëherë do të ngrenë sytë të gjejnë prapë atë që tretën, por do të jetë vonë.” (faqja 319, vëllimi XIX i veprës, botimi i vitit 2009, Onufri)

Nga një paradoks historik në tjetrin, nga qytetarë të asaj Shqipërie të vogël të pavarur, shqiptarët shndërrohen në qytetarë të një mbretërie italo-shqiptare-abisine, në kuadrin e shkallmimit dhe shpartallimit të plotë të gjeopolitikave, kur njerëzimi po jetonte në një perandori të vetme njerëzore. Kadareja u rrit si qytetar i kampit socialist, pra, i perandorisë lindore. Paradoksi i tretë i madh historik i shqiptarëve brenda të njëjtit shekull. Falë fatit që iu dha e që e ndërtoi vetë, Kadareja do të ishte ndër të vetmit që vetizolimin e Shqipërisë do ta thyente më së shpeshti, do të ishte gjithnjë e më shumë qytetar i botës me veprën e tij që përhapej anembanë globit dhe me udhëtimet e tij në Perëndim.

Ndjenja e tij e lirisë është edhe ndjenjë e lirisë për hapësirë. Askund në veprën e tij nuk ndihet përkatësia ndaj një vendi të vogël, një letërsie të vogël apo të një gjuhe të vogël. Në “Dimri i madh” apo në “Koncert në fund të dimrit”, dy të vetmet romane të tij epope, për shembull, hapësira nuk ndihet më pak se në romanin epope të Tolstoit “Lufta dhe paqja”. Tirana e Kadaresë nuk është më pak metropol se Moska e Tolstoit. Shoqëria shqiptare e çdo kohe të pasqyruar në letërsinë e Kadaresë ka sferat e saj të larta, ku lëvizin familjet e mëdha, me intriga, flirte, tradhti, krushqi, prapaskena po edhe marrëveshje të rëndësishme, edhe vendimmarrje të rëndësishme për fatet e saj të ardhme. Kadareja është një vetëdijës i madh, madje më i madhi, për gjuhën shqipe, nga e cila, ai nuk ka ndjerë kurrë ndonjë kufizim shprehjeje.

Gjithashtu, Kadareja ka një vetëdijë të madhe të hershme për paragjykimet ndaj një shkrimtari të një vendi të vogël, të një letërsie të vogël, të një gjuhe të vogël. E ndjen se të huaj, sapo të ndeshen me emrin e tij në ballinat e romaneve, do të pyesin: A ka ndonjë histori letërsia e vendit të tij, a ka ndonjë bashkëkohësi letërsia e vendit të tij?

Kadareja është krenar për letërsinë shqipe që daton nga Shekulli 16-të. Këtë e ka dëshmuar në veprën e tij, e ka dëshmuar edhe duke u përballur haptas me historiografinë e kohës, e cila nuk e njohte si letërsi të mirëfilltë artistike krijimtarinë e Buzukut, Matrëngës, Bogdanëve, Budit, Bardhit, Varibobës.

Që herët ai e vlerëson edhe letërsinë bashkëkohëse dhe i vlerëson kolegët bashkëkohës. Më 1969, në një shënim kritik për librin e parë poetik të F. Halitit, shkruante: “Letërsia... është një pasuri kombëtare... si të gjitha pasuritë shpirtërore të popullit, ajo krijohet me vështirësi dhe mundime të jashtëzakonshme, nga shumë breza e nga shumë njerëz.”

BINJAK I SHEKSPIRIT

Fëmijë 11-vjeçar, Kadareja do të shkruante me dorë Makbethin dhe e ndjen veten bashkautor të Shekspirit, i magjepsur nga tragjika e veprës. Dhe e dëshmon veten si njeri të ambicjeve të mëdha krijuese.

Kadareja do të ishte kështu binjaku romancier 372 vjet më i vonë i dramaturgut Shekspir ose 372 vjet më i ri se binjaku i vjetër.

Më 1958, 22 vjeçar, me poemën “Argjiro” bie në sy të vetë Enver Hoxhës. Për bashkëqytetësin në krye të Shqipërisë, mbiemri Kadare nuk është i panjohur, nuk është mbiemër që s’mund të mbahet lehtësisht mend. Me këtë poemë, Kadareja merr çmim të parë Republike.

Këtu zë fill përplasia e dy egove, më pak të dukshme dhe më shumë të padukshme, si ajo mes dy asjbergëve të lindur më shumë për të mos i hapur rrugë njëri-tjetrit.

Zë fill, pra, një trajektore e gjatë me luhataje dhe zikzake midis sunduesit politik dhe sunduesit shpirtëror të shqiptarëve.

Ishte redaktor në gazetën “Drita” kur telefoni ra dhe nga ana tjetër e tij ishte vetë Enver Hoxha. Diktatori e uroi dhe e përgëzoi për poemën e re që sapo kishte botuar. Lajmi, natyrisht përhapej kudo dhe kuptimi ishte: Kadareja është në vëmendjen e posaçme të diktatorit. Nëse i vinte e keqja mund t’i vinte vetëm nga diktatori personalisht. Por Bertolt Brechti dikur kishte thënë: “U ndesha me luanët dhe më mundën çimkat.” Ishte zgjuarsia e Kadaresë ajo që do ta shpëtonte nga pamëshira e vartësve të Enver Hoxhës, deri tek nëpunësit më të vegjël të regjimit, të cilët nuk pushonin së mbushuri dosjen e Kadaresë, në pritje që një ditë prej ditësh, diktatorit t’i luante mendja dhe, në ndërkryerje e sipër, ta hidhte Kadarenë në duart e tyre.

Menjëherë krijimtaria e Kadaresë është letërsi e rekomanduar shkollore dhe, pa vonuar, është e përfshirë në tekstet shkollore nga klasat e filllores deri në sistemin e lartëshkollor dhe postuniversitar. Poemat e tij recitohen në çdo mjedis shkollo, publik, mediatik. Romanet e tij dramatizohen, luhen në teatër, në ekranin e vogël, bëhen filma e tjerë.

Është krijuesi më tepër në qendër të kritikës dhe më i studiuar në Shqipëri.

Nga mesi i viteve ‘60 çdo vit në vijim boton së paku një libër të ri ose një libër të ribotuar. Jo vetëm çdo libër i Kadaresë, por edhe çdo bashkëpunim, kryesisht i shpeshtë, në “Drita”, “Nëntori”, “Zëri i rinisë”, gazeta e revisa të tjera është ngjarje artistike në

Shqipëri. Nuk e lë censurën për asnjë çast të ngopet me frymë.

Nga kjo kohë, në moshë të re 27-vjeçare, është shkrimtar në profesion të lirë. Prej atëherë është shef i vetvetes. Nuk është nën urdhërat e askujt. Nga kulla e tij e ngujimit, si një Gjorg malësor, çdo ditë, rreth orës 12... kur nuk ndodhet jashtë Tiranës apo jashtë Shqipërisë, shkon në Lidhjen e Shkrimtarëve, lëshon ndonjë batutë fine, e cila brenda minutës shpërndahet nëpër të gjitha mjediset. Ngjitet deri tek “Le lettre albanaise” revistën që drejton për shumë vite, ku botohet letërsi, kritikë, studime të letërsisë shqipe të përkthyer në frëngjisht. Merr pjesë edhe në mbledhjet e ndryshme të Lidhjes. Rikthehet në kullën e tij të ngujimit.

Më 1980 i botohet kolana e veprës së plotë në Prishtinë me dhjetë vëllime. Më 1981 i botohet kolana e veprës së plotë me dymbëdhjetë vëllime në Tiranë. Është arritje e madhe dhe fat i madh për një shkrimtar në atë moshë të shohë kolanën e veprës së tij të botuar. Është fillimi i rekordeve të paarrishme.

Në intervistën e parë dhënë “Zërit të Amerikës”, pas vendimit për të kërkuar azil politik në Francë, Kadareja u shpreh krenar se vepra e tij gjatë diktaturës është shitur në më shumë se një milion kopje në Shqipëri, një vend me popullsi të vogël, është shprehur krenar se i ka dhënë popullit të tij një letërsi të cilësisë së lartë, të pacënuar në këtë aspekt nga dogmat e realizmit socialist.

Gjatë karrierës do të merrte çmime të tjera të para Republike, çmime të tjera pothuaj të gjitha të para në konkurse kombëtare, do të merrte edhe çmime tejet të rëndësishme ndërkombëtare. Do t'i merrte të gjitha dekoratat që ekzistojnë në Shqipëri e në Kosovë, si dhe dekoratat më të larta në Francë.

Student në Moskë, shkruan romanin e tij të parë “Qyteti pa reklama”. Me këshillën e Drago Siliqit, nuk e paraqet asnjëherë për botim gjatë diktaturës. E teston censurën me një version tjetër original mbi të njëjtin subjekt, me dy vijime të romanit në “Zëri i rinisë”. I ka goditur kështu rëndë për herë të parë skemat ekzistuese. Censura kundërvepron ashpër. Kadareja për herë të parë zbrapset ndaj saj. (Përfundimisht “Qyteti pa reklama” është në duart e lexuesit vetëm pas largimit të diktaturës.) Kjo nuk mjafton që shija e keqe të mbetet e pashlyer tek aparati gjigant i censurës.

Siç e ka pohuar, kur po shkruante këtë roman, për herë të parë e ka kuptuar se ishte një shkrimtar i pazakontë.

E konfirmon këtë me “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, romanin e parë të botuar të tij, romanin e parë që i jep fat atij, letërsisë shqipe, kulturës shqiptare, njohjes sonë ndërkombëtare më shumë se çdo vepër tjetër, romanin e parë që troket në dyert e çmimit Nobel, të cilat, për faj të skemave të këtij mekanizmi, nuk do të hapeshin asnjëherë përgjatë dekadave.

VERIORI


Më vjen shpesh të them se Kadareja është vijues i drejtpërdrejtë i veprës së Fishtës dhe Migjenit. Veprat e tyre i ka njohur.

Është si një zbritje hyjnore që kapituajt e parë të “Gjeneralit...” i ka shkruar në një mot me shumë shi, në Turizmin e Vjetër të Shkodrës, ku kishte shkuar me shërbim nga gazeta “Drita”.

Edhe Kadareja, si Fishta dhe Migjeni, është madhëruar sa dhe kritik ndaj trashëgimisë sonë kombëtare.

Migjeni për të është një uragan i ndërprerë, ndërsa nga Fishta, te “Krushqit janë të ngrirë” ka si lajtmotiv vargun (ne dhe serbët) “n’mni t’shoshqit kena lë”.

Kadareja është jugori më verior i letërsisë shqipe. Në vijimësi kohore vjen pas Mitrush Kutelit, që ka shkruar poemë për Kosovën dhe që ka përshtatur në prozë mjeshtërisht



poema të Eposit Heroik të Veriut.

Kongresi i Drejtshkrimt të vitit 1972, ndër të tjera, synonte që t'i ndërpriste marrëdhëniet e toshtërishtes me gegnishten. Këto marrëdhënie ishin thelluar gjithanshëm falë ndikimit të Drejtshkrimt të vitit 1916, deri atëherë në fuqi.

Letërsia e Kadaresë është faktori i jashtëzakonshëm jugor i ruajtjes dhe thellimit dhe shumëfishimit të marrëdhënieve midis dy dialekteve, siç shënova, të ndaluara nga politika gjuhësore në Shqipëri.

Jo e vështirë për të që gjeniu ynë i letrave të fushohet në terrenin gegë. Shkollimin, po e dimë, e kishte filluar me abetare geqe.

Periodha e Luftës së Dytë Botërore, që përkon me fëmininë e hershme të shkrimtarit, është edhe periudha kur dashuria për Kosovën ishte në modë. Ishte lënda vendimtare për atdhetarizmin shqiptar. Kush merrte notë kaluese në këtë lëndë, ishte atdhetar i lauruar. Ndikoi fuqishëm këtu edhe dërgimi i mësuesve shqiptarë në ish “trojet e robnueme”, Kosovë dhe trojet e tjera shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të vitit 1913, si dhe dërgimi i shumë jugorëve në administratën e ngritur atje gjatë kësaj periudhe. Ndikuan kryekreje intelektualë të tillë si Mitrush Kuteli, Asdreni, Vasfi Samimi e tjerë me poemat, me reportazhet e gjera, me veprat monografike e tjerë. Të mos e harrojmë vargjet e famshëm lasgushianë “duke rendur mepërmes të Shqipërisë/ Drini plak e i përmallshëm po buron prej Shënd Naumi”.

Për të ardhur tek tema veriore, tek lënda dhe shpirti verior ishte vendimtare tema e Kosovës. “Atje larg në veri” është poezia e përfshirë në vëllimin “Motive me diell”, kushtuar qytetit të Gjakovës. Pra, Kadareja e njeh Kosovën si veri të Shqipërisë. (“Fusha e Kosovës, në Shqipërinë Veriore, ku ai (Mark Alemi, shënimi im) nuk kishte qenë kurrë...” (f. 394, Pallati i nderrrave, botimi i vitit 2009, Onufri)) Po aty është edhe poezia “Sa herë kaloj mbi qiellin tënd Kosovë”. Tema historike (me romanin “Kështjella”) shënon një hap tjetër pa kthim në këtë drejtim.

Eseja “Autobiografia e popullit në vargje” (1971), ku Kadareja mbron më mirë se askush shqiptarësinë e Ciklit të Kreshnikëve dhe të Eposit Heroik Shqiptar (të veriut) në tërësi shënon parapërgatitjen e tij për tek tema veriore. E thellon më tej zotërimin e tij në këtë aspekt me njohjen e plotë të asaj çfarë është shkruar nga shqiptarët dhe të huajt për këtë trashëgimi shpirtërore dhe për Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Në minierën e pafund të eposit tonë, Kadareja has në damarin kryesor, arterin e konstitucionit shqipar, fjalën e dhënë,

besën, e cila jepet për së gjalli dhe mbahet edhe për së vdekuri, çka e ka vetëm eposi shqiptar dhe nuk e ka asnjë epos tjetër. Fjala e dhënë, besa janë ato që ngjizin një roman si “Kush e solli Doruntinën”, por e shënojnë deri edhe një roman si “Pallati i nderrrave”, më përfaqësuesi i Kadaresë në garën për çmimin Nobel, madje edhe në indin në tragjik të romanit, kur, me urdhër të vetë sulltanit, përgjaket darka e Qypriinjeve, theren rapsodët lahutarë shqiptarë, gjithçka nguroset pikërisht tek vargu “Të ka zanë vorri, o me besë të dhanë”. Dhjetë faqet që i kushtohen në roman kësaj ngjarjeje janë nga më brilantët jo vetëm në letërsinë kadareane po edhe në atë botërore. Kulti shqiptar i fjalës së dhënë, i besës, me një fjalë identiteti i pazhbëshëm i kombit shqiptar, trondit, me kulm e me themele, edhe tiranitë më jetëgjata të globit.

Tek “Prilli i thyer”, duke e vënë në gojën e shkrimtarit Besian Vorpsi, Kadareja



shkruan për Kanunin e Lekë Dukagjinit: “- Një kushtetutë e vërtetë e vdekjes... Për të flasin shumë dhe gjithfarë gjërash, megjithatë, sado i egër dhe i pamëshirshëm të jetë ai, për një gjë jam i bindur: kjo është një nga kushtetutat më monumentale të lindura mbi fytyrë të rruzullit tokësor dhe ne, shqiptarët, duhet të jemi krenarë që e pollëm atë.” (faqe 90, botimi i vitit 2009, Onufri)

Më poshtë, po aty: “- Po, duhet të jemi pikërisht ashtu, krenarë.... Rrafshi është i vetmi truall në Europë, që, duke qenë pjesë e një shteti modern europian dhe jo një vendbanim tribush primitive, i ka flakur ligjet, ngrehat juridike, policinë, gjyqet, me një fjalë, krejt makinën shtetërore; e ka flakur, më kupton, i ka pasur dikur dhe i ka hedhur për t'i zëvendësuar me ligje të tjera, morale, të cilat janë kaq të plota, saqë i ka detyruar zyrtarët e huaja të pushtimit dhe, më vonë, administratën e vetë shtetit të pavarur shqiptar, t'i njohin ato dhe ta lënë kështu Rrafshin, domethënë gati gjysmën e mbretërisë, jashtë mbikqyrjes së shtetit.”

Në faqen vijuese: “... me atë ligj të ri, besën, nismëton gjithçka.”

Apo: “Si çdo gjë e madhërishtme, kanuni është përtej mirësisë dhe ligësisë.”

Më 1980, i ftuar në përrurimin e botimit të kolanës së veprës së tij, e viziton për herë të parë Kosovën, ku gjen një pritje të pashembult vëllazërore. Kthehet në Shqipëri dhe boton reportazhin e gjatë, të paharrueshëm “Në Kosovë, mes vëllezërve”. Konsolidon kështu një lidhje të fuqishme e të fortë me këtë anë veriore të Shqipërisë, Kosovën.

Ardhja tek tema veriore përkon me periudhën e të ashtuquajturit realizëm magjik në romanet e Kadaresë. (Përveç “Kronikë në gur”) në këtë cikël përfshihen “Prilli i thyer”, “Kush e solli Doruntinën”, “Dosja H”, “Lulet e flohta të marsit” (e deri te “Kukulla”). Tema veriore vijon edhe me “Krushqit janë të ngrirë”, “Tri këngë zie për Kosovën” e tjerë.

Tek Eposi Heroik Shqiptar (i veriut), Kadareja në romanet e tij arrin që të marrë tragjikën e heroikës së tij, ashtu si Eskili dikur merrte tragjikën nga eposet homerike, nëpërmjet atmosferës shqiptaro-ilire të mitologjisë së veriut arrin të përftojë atmosferën mitologjike të antikitetit.

Te realizmi magjik kadarean fjalja është edhe më urtane, edhe më filozofike si nyjat në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ku deri fjalët dhe fjalëzat kanë vendndodhjet e tyre si të dhëna aty njëherë e përgjithmonë.

Pothuaj si në përroin psikik, shkrihen kufijtë mes autorit dhe personazheve. Dialogu kalon nga ai jo i paraqitur grafikisht

deri te ai i paraqitur grafikisht, duke u njëjtësuar me gjuhën e autorit në rastin e parë dhe duke e përfshirë e mospërgjashtuar në rastin e dytë. Nganjëherë nuk e përdor as shenjën e dialogut. (Kadareja nuk i përdor thonjëzat në ligjëratat e drejta, i përdor vetëm në citime.) Malësorët e Kadaresë janë monologues edhe kur bisedojnë me veten, edhe kur bisedojnë me të tjerët. Edhe intelektualët e tij bëhen robër estetikë të këtij parimi. Edhe vetë gjuha e autorit.

Do shënuar këtu se Kadareja e zotëron në mënyrë të përkryer kohën në vepër, e zotëron në mënyrë të përkryer zemberekun e kohës, për t'i vonuar, ngadalësuar, ngërçuar ngjarjet, për t'i shpejtuar e përshpejtuar ato deri në taskaje saqë janë gati të mos i pranojnë fare shenjat e pikësimit. Përdorimi i dendur i një shenje siç është viza e dialogut, për shembull, në një prozë të vogël si “Në periferi pranë aeroportit” e mban në vendnumëro kohën, në mënyrë që ndarja midis studentit shqiptar që po rikthehet në Tiranë dhe së dashurës ruse që po mbetet në Moskë, të mos ndodhë.

Me pasurinë e pafund të fjalëve geqe, me figurativitetin e saj mahnitës, me mjetet fjalëformuese geqe, Kadareja rison, pastron dhe pasuron më tej fjalorin e shqipes së lëvruar, me brumë të mirëfilltë gegë Kadareja e vë shqipen në lartësitë e mëdha të çdo gjuhe të madhe.

PAS DE RADËS, NAIMIT, FISHTËS

Shkrimi im për Gjergj Fishtën, i dhjetorit 1990, botuar në “Drita”, i pari shkrim afirmues për poetin tonë kombëtar në 45 vjet në Shqipëri, kishte titullin “Një sovran i letrave tona”.

Kisha parasysh atëherë sovranë të tjerë të letërsisë shqipe. Sovrani i parë ishte arbëreshi Jeronim De Rada. Me Jeronim De Radën fillonte letërsia jonë e re, e cila paraprihej nga Letërsia e Vjetër ose, siç quhej ndryshe, letërsia e priftërinjve të veriut, si dhe nga Letërsia e Bejtexhinjve. Të dyja këto periudha të shtrira në Shekujt XVI - XVII- XVIII deri në fillim të Shekullit XIX kanë emrat, veprat dhe dukuritë e tyre përfaqësuese. Në dialektin arbëresh, shqipe arkaikë e ruajtur në Gadishullin Apenin prej shekujsh, e shpëtuar nga ndikimet otomane, por e prekur nga ndikimet e italishtes, shkruan kryeveprën e letërsisë sonë “Këngët e Milosaos”, vepra të rëndësishme si “Këngët e Serafina Topias”, “Skanderbeku i pafanë”, drejton gazeta e revista, merret me hulumtime gjuhësore të shqipes, i kushtohet arsimit kombëtar, është një rilindës i kombit 360 gradësh. Jeronim De Rada është, prandaj, i papërsëritshëm në letërsinë tonë.

Sovrani i dytë i letërsisë shqipe është Naim Frashëri. Me një shqipe të kulluar pothuaj të paprekur nga otomanishtja, me alfabet latin, Naimi sjell vëllimin e parë poetik në shqip “Lulet e Verësë”, poemën lirike “Bagëti e bujqësi”, poemat epike “Istori e Skënderbeut” dhe “Qerbelaja”, si dhe “Fletore e bektashinjve” e “Vjersha për mësonjëtorët e para”. Është, qiriri që e djeg veten për t’iu bërë dritë shqiptarëve, poeti që rilind shpirtin kombëtar shqiptar. Më shumë se poet kombëtar, Naimi është profet kombëtar.

Sovrani i tretë i letërsisë shqipe është Gjergj Fishta. Është pasurues i pashoq i gjuhës shqipe të lëvruar në një vepër të realizuar në gjinitë, lirike, dramatike, epike, satirike dhe në publicistikë. Është veprimtar gjuhësor, me rol të madh në njësimin e alfabetit shqip. Është i pari shqiptar kandidat për çmimin Nobel. Është i pari shqiptar anëtar i një Akademie të huaj të Shkencave, madje i një akademie perëndimore. Fishta ka një vepër epike të papërsëritshme, ka një vepër satirike të paarritshme në letërsinë shqipe.

De Rada, Naimi, Fishta janë sovranë



të traditës të letërsisë së re shqipe. Ismail Kadare është sovrani i letërsisë së sotme shqipe, sovran bashkëkohës.

Krijimtaria e Kadaresë, e shtrirë në shtatë dekada, përbëhet nga tri periudha të saj. Në periudhën e parë, deri në vitin 1968, merret kryesisht me poezi dhe prozë. Në këtë kohë vihet në krye të brezit krijues të viteve ‘60, brezit të artë të letërsisë shqipe. Në periudhën e dytë merret kryesisht me romane, të cilat përkthehen dhe botohen në Francë pothuaj menjëherë, pastaj edhe nëpër botë.

Kështu Kadareja bëhet faktor përfaqësues i letërsisë, kulturës dhe realitetit shqiptar. Një rol të tillë e pati De Rada në kohën e tij. Me këtë vetëdijë ai krijonte ura njohjeje me botën italiane dhe evropiane. Nga ky kënd komunikonte me Lamartinin, duke ia dërguar atij për ta lexuar “Milosao”. Një rol të tillë e pati me vetëdijë edhe Naimi. Ai shkroi një vëllim poetik dhe një novelë në persisht, përkthyer me frymë naimiane nga Vehxhi Buharaja. Shkroi edhe në greqisht. Me poemën “Dëshirat e vërteta të shqiptarëve” në këtë gjuhë, Naimi është zëdhënës dhe përfaqësues vizionar i shqiptarëve në marrëdhëniet me fqinjët. Fishta është sekretar i përgjithshëm i delegacionit tonë në Konferencën e Paqes në Paris. Fjalimi që ai përgatiti dhe e lexoi Imzot Luigj Bumçi është një traktat vizionar me vlerë të përgjithshme. Fishta, duke lobuar me krahun katolik të politikës gjatë një udhëtimi të posaçëm matanë oqeanit, realizoi njohjen e Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E përfaqësonte Shqipërinë në konferencat ballkanike në Athinë, Sofje, Bukuresht e Ankara. Atje do të ndeshem me “kaprreçë”, iu shkruante zyrtarëve të Ministrisë së Jashtme. Kaprreçë në veri iu thonë drerëve me brirë të mëdhenj të fuqishëm.

Edhe Kadareja ka vetëdijen se është faktor diplomatik i shqiptarëve në marrëdhëniet me botën, sidomos me Perëndimin. Dhe e kryen këtë rol në mënyrën më shembullore.

Tashmë është i pakonkurueshëm, i gjithëpranuar në krye të hierarkisë së letërsisë shqipe. Në letërsinë brenda kufijve shtetërorë diskutohej vetëm se kush ishte i dyti, i treti apo i katërti e me radhë. Pas hapjes së kufijve, letërsisë sonë i bashkohet edhe ajo e krijuar në Kosovë e trojet e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, po edhe ajo e krijuar në mërgim. Gjithashtu i bashkohet letërsia e burgjeve. Prej atëherë mund të diskutohet vetëm se kush janë të dytët,

të tretët, të katërtit e me radhë në krye të hierarkisë së letërsisë shqipe.

Duke filluar nga romani “Kështjella” Kadareja solli dhe ia dha qytetarinë temës historike me theks aktual në letërsinë shqipe të kohës. Theksi aktual ishte një armë e fuqishme, e tillë vetëm në duart e një Kadareje, kundër aparatit të censurës, por edhe me rreziqe të panumërta anësore. I jepet qytetaria kështu edhe asaj letërsie që jo doemos i përmbush të pesë parimet e realizimit socialist, pikësëpari letërsisë pa hero pozitiv. Kadareja vetë e kishte kuptuar se nuk ishte i lindur për heroin pozitiv. I krijon kështu vetes liri për të manovruar në terrenet turke-otomane si dhe në terrenet sovjetike-lindore

Dy pyetjet gati të pamunguara në intervistat për të huajt janë: sa i përket letërsia e tij realizmit socialist dhe a e shikon veten fitues të Nobelit. Zihet ngushtë, nga një anë, se nuk mund ta shqiptojë të kundërtën e pikëpamjeve të tij ndaj të vetmit realitet të atëhershëm të një letërsie të realizimit socialist në botë. Nga ana tjetër, në përballjet me Tiranën komuniste, nuk nguron, madje ngulmon haptas që pse letërsia jonë të mos quhet më mirë “letërsi socialiste” dhe jo “letërsi e realizmit socialist”.

Ndaj tundimit të çmimit Nobel, Kadareja sillet gjithashtu me etikë shembullore. Njëzet e sa vjet është në grupin e ngushtë të kandidatëve për Nobel. Dhe çdo herë, pas shpalljes së Nobelit të radhës, pyetja shtrohej: Po Kadareja? Pse nuk e mori Kadareja? Pse Akademia e Nobelit nuk ia dha çmimin e merituar Kadaresë. Nëse shumë prej atyre që e merrnin këtë çmim, shpejt harroheshin, Kadareja mbetet në qendër të vëmendjes, si shkrimtari që e meritoi çmimin Nobel, por ai iu mospranua për arsye joletrare nga Akademia e Nobelit.

Fqinjët tanë kanë nobelistë të Letërsisë, por Kadareja është shkrimtar më i mirë se të gjithë këta. Asnjëri nga bashkëkohësit evropianë të Kadaresë që e mori Nobelin e Letërsisë nuk është më i madh se Kadareja.

Nobeli nuk do t’ia shtonte famën Kadaresë. Nobeli do të jepte drejtësi për veprën e tij, do të konfirmonte vendin e pamohueshëm të saj, të letërsisë shqipe dhe të gjuhës shqipe në hierarkinë botërore.

Kadareja shkruan letërsi, përfshirë prozë, të shkurtër, të mesme apo të gjatë, pa rënë asnjëherë në prozë. “Romani është poemë.” A nuk thotë kështu Ernesto Sabato?

Fjalja, sado e thjeshtë, sado e përbërë, në shkrimet e Kadaresë ka frymëmarrje ritmike, kadencë, ndërthurje masash

brenda strukturave më të vogla apo më të mëdha sintaksore, karakteristike për poezinë. Shkrimi i tillë duket sikur recitohet, të paktën në heshtje, në sfond nga autori. Dhe e përcjell si mënyrë leximi, këtë cilësi të shkrimit të tij edhe tek lexuesi në çdo takim me shkrimet e tij.

Parimi estetik prijës i prozës së Kadaresë është parimi motërzues i pafundëm, në rrathë më të mëdhenj a më të vegjël bashkëqendrorë, që, duke ruajtur qendrat e tyre, krijojnë rrafshe që priten mes tyre, pa e nxjerrë askush tjetrin nga orbita e tij. Linjat, motivet, personazhet, situatat, deri tezat e vëna në gojën e personazheve apo të shqiptuara drejtpërdrejt në eseistikën e autorit, motërzohen mes tyre, rimerren nga një vepër në tjetrën, nga një më e hershme tej tjetra më e vonë në tërësinë e larmishme të veprës së Kadaresë. Kjo kërkon nga autori, gjatë më shumë se shtatë dekadave krijimtari, që ta ketë pothuaj përmendsh, ta ketë të freskuar e të rifreskuar deri në hollësi gjithë përmbajtjen e veprës së tij.

Konkretisht, kemi të bëjmë kështu me parimin kozmogonik krijues, pra, me parimin universkrijues.

Në larushinë e saj dhe në pafundësinë e saj vepra e Kadaresë është ndërtuar si njësi e vetme. Ky është universi kadarean aq shumë i përmendur.

Në paralelet që vijnë nga thellësia e shekujve të globit dhe që shtrihen në thellësinë e shekujve të globit qëndron universaliteti kadarean aq shumë i pashoq.

Tek “Pallati i Ëndrrave”, për shembull, ku ngjarjet zhvillohen në Shekullin XIX, në Stamboll, po mund të ndodhnin edhe në Tiranën e Shekullit XX, kemi: “Diellisht (sulltanit, shënimi im) spërkaste gjithkah, ndryshe s’kishte si të shpjegohej që edhe me lakth në fyt, të dënuarit klithnin: rroftë sulltani!” (f. 346, botimi i vitit 2009, Onufri).

Fantazia e tij është tejpermasore sa edhe e saktë, e pagabueshme.

Kadareja nuk e krijoi dot në bashkëkohësi kritikën e tij në gjuhën origjinale të krijimtarisë së tij. Ndonëse u shkrua aq shumë për të. E kuptonte dhe nuk ishte aspak i lumtur. I mungoi ndër shqiptarët një autoritet tjetër i mendimit kritik si Arshi Pipa, që mund të dëgjohej në Perëndim.

Pas ndarjes së Kadaresë nga jeta, u rikujtu shpesh vargjet e Çajupit për Naim Frashërin. “Vdiq Naimi, po kush mbeti,/ o moj Shqipëri e mjerë./ Vdiq Naimi, po kush mbeti./ Si Naimi s’ka të tjerë.” Dhe u përsërit shpesh shprehja: “Ismail Kadareja nuk i vjen më Shqipërisë.” Për arsyet pse De Rada, Naimi apo Fishta nuk i vijnë Shqipërisë, për të tjera që unë i përmend në këtë esë dhe për shumë arsye të tjera Ismail Kadareja është i papërsëritshëm.

Të katër, po për të njëjtat arsye, janë të pashfronëzueshëm, janë të pashfuqizueshëm. Historia ka dëshmuar dhe do të dëshmojë se asnjë koniunkturë politike, artistike apo çfarëdo tjetër, nuk e ndryshon vendin e tyre në letërsi.

Vepra e Kadaresë ka dhe do të ketë lexues, të të gjitha niveleve dhe interesave edhe nëpër botë. Por më i lazdruari (siç e parapëlqen këtë fjalë Kadareja në vend të i privilegjuari) është lexuesi shqiptar, ai që e shijon drejtpërdrejt në burim magjinë kadareane. Më i lazdruari i të lazduarve, natyrisht, është lexuesi bashkëkohës i Kadaresë, ai që e shijoi magjinë kadarena kur ajo sapo shqiptohej.

DONTE TË VDISTE NË VERË

Në periudhën e tretë të krijimtarisë, Kadareja u muar kryesisht me eseistikë. Për brezat e sotëm dhe sidomos për brezat e ardhshëm eseistika e Kadaresë është një dëshmi, një kujtesë, një testament. Kadareja i ka shpallur idealet e tij jetësore dhe estetike, porosinë dhe amanetet e tij të

shkrimtarit gjenial, të idealistit kombëtar, të evropianit të madh.

Si askush në letërsinë shqipe, ndoshta edhe në letërsinë botërore, Kadareja ia lehtëson në mënyrë të tejshkajme punën mendimit të ardhshëm kritik, atij letrar, filozofik, jolettrar, jofilozofik. Në eseistikën e tij është përfshirë gjithçka që është e rëndësishme dhe me të cilën mund të merret kritika e ardhshme, të cilën vepra e Kadaresë do ta krijojë, pa dyshim, në mungesën fizike të autorit. Kadareja hedh dritën e tij të plotë në raportet që pati me letërsinë, me kohën, me kombin, me politikën, duke iu mëshuar veçanërisht raporteve të tij me diktaturën komuniste dhe me diktatorin komunist.

Në këtë mision ka dhënë ndihmesë të veçantë edhe libri “Koha e pamjaftueshme” i shkruar nga Helena Kadare, bashkëshortja dhe kolegia e tij e pandarë për shumë dekada. Gjithçka që është e parëndësishme ka mbetur jashtë eseistikës së tij dhe jashtë librit të përmendur të Helenë Kadaresë.

Edhe eseistika është krijuar mbi parimet motërzuese, duke rimarrë tema, motive, personazhe, idera të trajtuara nëpër krijimtarinë e tij në poezi apo në prozë dhe duke i shtjelluar ato në një mënyrë mjaftueshëm shterruese. Kështu njohësve sistematikë të veprës së Kadaresë iu plotësohet kureshtja që lind me të drejtë tek admiruesit e një shkrimtari. Ndërsa njohësve të rinj iu nxitet kureshtja për veprën e Kadaresë. Natyrisht, kureshtjet ndaj shkrimtarëve të madhësisë së Kadaresë nuk do të reshtin kurrë, por ato gjithnjë përgjigjen do ta gjejnë tek vepra e tij, përfshirë edhe te eseistika e tij, e cila qëndron lart edhe artistikisht sa poezia dhe proza e tij.

Në vitet 2007-2012 në Shqipëri, nga Onufri, iu botua vepra e plotë me 22 vëllime në shqip, në Francë, paralelisht, iu botua vepra e plotë po me kaq vëllime në frëngjisht. Një arritje e rrallë dhe fat i rrallë për një shkrimtar që vinte në vend të huaj. Më 2023, nga Onufri, iu botua vepra e plotë, në 7 mijë faqe, në shtatë vëllime “Shtatëdhjetë vjet krijimtari në 7 vëllime.” Një arritje e rrallë dhe një fat i rrallë. Kadareja, edhe pasi nuk shkruante më libra të rinj, pati jetë aktive krijuese duke bërë ripunime përfundimtare të krjmtarisë së tij të përfshirë në këtë kolanë.

Binjaku i tij më i hershëm, Uilliam Shekspiri (23 prill 1564- 23 prill 1616), vdiq në të njëjtën ditë që pati lindur. Shekspiri e kishte të lehtë ta pranonte si ditë vdekjeje 26 prillin, sepse ajo binte në pranverë. Kadareja nuk mund ta pranonte ditë vdekjeje 28 janarin, sepse i binte në mes të dimrit. Prandaj donte të vdiste në një ditë vere. Këtë vendim e shpallte që herët në jetën e tij: “Gjonit i dukej se do të vdiste atëherë kur ai ta donte vetë këtë. Atij i dukej sikur të gjithë të tjerët do të vdisnin pa dëshirën e tyre. Kurse ai nuk do të vdiste pa dëshirën e tij. Ai e ndjente si vdekja qëndronte jashtë tij, megjithëse aq pranë.

.....
Mërkuri vdiq, mendoi prapë Gjoni... Gjithë kjo baltë i rëndonte mbi trup. Sa e tmerrshme! Ai do të vdiste në një kohë vere, atëherë kur livadhet do të kenë lulëzuar dhe baltë të mos ketë fare.

Balta e lagur mbi trup nuk durohej. Ai do të vdiste në verë.” (“Qyteti pa reklama”, f.153-154, vëllimi 1 i veprave, botuar më 2007, Onufri)

Ashtu si e vinte dëshirën e tij në meditimet e Gjon Kurtit (një nga emrat e shumtë veriorë të personzheve të tij) Kadareja, siç donte ai vetë, vdiq në verë, kur sapo ishte larguar qershori, kur livadhet kishin lulëzuar dhe nuk kishe baltë fare.

Dhe 1 korriku, deri sivjet një datë jo aq e ngarkuar me ngjarje, do të ketë një peshë të një rëndësie tjetër.

Përkritazi me librin me poezi të përzgjedhura “Treni nisej, faculeta digjej”, të poetit Adem Gajtani, botuar nga Shtëpia botuese AGORAPRINT, Shkup

RIKTHIMI NË SHKUP I POETIT ADEM GAJTANI

Nga Emin Azemi

Shtëpia botuese AGORAPRINT e Shkup ska risjellur për lexuesit poetin Adem Gajtani, permes një përzgjedhjeje poezish nga opusi i tij poetic. Poezitë e këtij libri (“TRENI NISEJ, FACULETA DIGJEJ”) vijnë nga vëllimet poetike : “Drita në zemër” (1961), “Dryni i heshtjes” (1964), “Ti këngë, ti zog i largët” (1968), “As dru, as zog-dashuri” (1973), “Unazë” (1974), “Në ëndërr kënga” (1975), “Amfora e fundosur” (1977) dhe “Kënga e mjellmës” (1980), duke i ofruar lexuesit të sotëm një spektër më të gjerë e më të kompletuar nga opusi krijues i Adem Gajtanit.

Kush ishte Adem Gajtani?

Adem Gajtani u lind në Podujevë (Kosovë) - 21 gusht 1935 dhe vdiq në Shkup - 19 gusht 1982. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, kurse Fakultetin Juridik në Shkup.

Me krijimtari letrare merret që nga viti 1955. Ka bashkëpunuar me gazetatat dhe revistat n “Zani i rinisë”, “Rilindja”, “Jeta e re” etj. “Dëshira” është poezia e parë e botuar e Adem Gajtanit, në Revistën “Jeta e re”, nr. 1-2/1955, fq. 103.

Fillimisht punoi korrespondent i “Rilindjes” nga Shkupi, pastaj ishte redaktor i kulturës në gazetën “Flaka e Vëllazërimit” në Shkup, deri sa vdiq në vitin 1982.


Krijimtaria letrare

Adem Gajtani është autor i shumë veprave me poezi, drama dhe tregime. Ka shkruar edhe për fëmijë (“Goca e detit” - 1966, “Lule më lule”- 1972 dhe “Gejzeri i blertë” - 1982). Ka shkruar vetëm një përm-

bledhje me tregime-”Malbrezet” (1982). Në këtë libër janë të përfshirë 12 tregime të botuara nëpër gazeta e revista gjatë viteve 1959-1963. Tregimet ndahen sipas një simetrie: 6 të parave u prinë mestitulli “Malbrezet e qëndresës” (shtjellohen sub-jekte nga Lufta e Dytë Botërore), kurse 6 të dytave “Malbrezet e dashurisë” (të përshkuara nga një notë intime erotike).

Në vitin 1962 në “Jeta e re” e botoi dramën poetike “Dielli i mbramjes, dielli i mëngjezit”, realizuar edhe nga Teatri Shqiptar i Shkupit (atëherë Teatri i Kombësive). Një vlerësim kritik mbi këtë dramë kishte dhënë edhe shkrimtari Luan Starova, i cili në mes tjerash kishte shkruar: “... në dramën “Dielli i bramjes, dielli i mëngjezit” të Adem Gajtanit janë fiksuar, janë ngjallur gjendjet e brendshme, që i shoqërojnë ngjarjet tragjike... Gajtani nëpërmjet lojës së skeleteve, ëndrrave, hijeve, jehut të fyellit magjik, i vendos në një strukturë kreative thirrjet tragjike shekullore të popullit të përfshirë në betejë me konzervativen, të ertën, me destruktiven. Situatat surrealistike që e karakterizojnë, si dhe dramat e Lorkës, këtij teksti dramatik vetëm ia rrisin sugjektivitetin dhe ekspresivitetin”. (Luan Starova, “Dramskoto tvorestvo vo literaturata na albanskata narodnos vo SR Makedonija” (dorëshkrim në arkivin e Institutit të Letërsisë Maqedonase), 1985, fq.30)

Opusi poetik i Adem Gajtanit përbëhet prej veprave: “Drita në zemër” (1961), “Dryni i heshtjes” (1964), “Ti këngë, ti zog i largët” (1968), “As dru,as zog-dashuri”



(1973), “Unazë” (1974), “Në ëndërr kënga” (1975), “Amfora e fundosur” (1977), “Kuq” (1978), “Kënga e mjellmës” (1980).

Në përkthim të tij, lexuesi maqedonas pati rastin të njihet me romanin e Ismail Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (“General na mrtva vojska”, Shkup, 1976) me vëllimin poetik “Ëndrra që vazhdon” (“Sonit sto prodolzuvu”) të Ali Podrimës, Shkup, 1978 dhe , bashkë me Gane Todorovski përktheu edhe romanin për fëmijë “Lepuri me pesë këmbë” të Rifat Kukajt.

Poezitë e Adem Gajtanit janë përkthyer në maqedonisht, serbokroatisht, sllovenisht, italisht, turqisht, bullgarisht, spanjolisht, hungarisht dhe rumanisht.

Adem Gajtani një nga emrat më të shquar në vitet 50/60

Adem Gajtani i takon gjeneratës së poetëve shqiptarë (bashkë me Enver Gjerqekun, Fahredin Gungën, Din Mehmetin, Murat Isakun, Azem Shkrelin, Rrahman Dedajn etj) që me krijmtari letrare filloi të merret qysh në vitet ‘50 të shekullit të kaluar.

Në fazën e parë, poezia e tij bart karakteristikat e një lirizmi subjektiv, por më vonë, në saje të pjekurisë së arritur në trajtimin e temave dhe ideve, në saje të një forme e vizioni poetik dukshëm do të kontribuojë në transformimin dhe modernizimin e strukturës së kësaj poezie, siç e ka vërejtur edhe Agim Vinca në punimin e tij, “Poezi e simbolit, protestës dhe ironisë”,botuar në “Jeta e re”, nr. 5/1985, fq.855. Poezia e Adem Gajtanit do të ndjek frymën dhe metodat krijuese të poezisë shqipe që krijohej në vitet 50 dhe 60 të shekullit të kaluar, duke “qenë sa nën ndikimin e mirëkuptimit të politikës zyrtare ndaj novatorizmit letrar, aq edhe nën ndikimin e timbreve të reja që depërtojnë përmes ndikimeve të jashtme”. (Rexhep Qosja,nga parathënia e “Antologjisë së lirikës shqipe”, Rilindja, 1979, fq. 40.

Në zbërthimin e profilit krijues të Adem Gajtanit kanë marrë pjesë disa autorë, kurse me këtë rast po e veçojmë një mendim të Xhevat Gegës, i cili në parathënien e veprave të zgjedhura, të botuara nga “Flaka e vëllazërimit”, 1985, në mes tjerash shkruante: “Poezia e Adem Gajtanit karakterizohet nga pjekuria e arritur dhe stili asociativ e modern, me metaforën universale dhe porosinë humane të obesrvimit filozofik e racional, gjithmonë duke gjurmuar harmoninë e plotë të jetës, aftësinë e vokacionit të bujshëm që gjithmonë të na ofrojë të bukurën e të mirës.

Individualitetin e vet të dalluar poetik Adem Gajtani do ta arrijë edhe nëpërmjet ndjenjës suptile ndaj traditës kulturore e shpirtërore kombëtare dhe ndaj aktualitetit të avansuar të kohës, gjë me të cilën poezinë e vet do ta bëjë moderne, evropiane, por gjithmonë të lartësuar mbi tabanin e koloritit të këtij nënqiellit tonë”.

Rikthimi i tij, në procesin e komunimit dhe receptimit me lexuesin e sotëm, përmes kësaj përzgjedhjeje poetike, botuar nga shtëpia botuese AGORAPRINT, besojmë se do të ndihmojë në rinjohjen e këtij poeti, i cili pa të drejtë kishte mbetur margjina e vëmendjes sonë teoriko-letrare.



100-VJETORI I LINDJES

KËSHTU FOLI ATË ZEF PLLUMI
ME GAZETARËTLIBRI MÂ
I BUKUR
N'BOTË ...!Në bisedë me
Dhurata Shehrin dhe
Persida Asllanin

- At Zef, cilët kanë qenë librat e parë që keni lexuar dhe pëlqyer në fëmijërinë tuaj?

- Në letërsinë shqipe librin e parë që kam lexue ka qenë "Lahuta e Malcis", dhe mendoj se çdo shqiptar duhet ta lexojë. Ma vonë unë kam fillue me lexue edhe romane. Kryesisht romane fmijsht. Ishte letërsi hungareze e përkthyme italisht, si per shembull "Djemtë e rrugës Pal", ndërsa para tij kam lexue një roman po italisht të një autori të quejtun Francis Fin. E mandej kam vijue me lexime të tjera. Në moshën 17-vjeçare kam lexue "Krim e ndëshkim" të Dostojevskit, më ka pëlqye shumë, por më duket që ishte një roman që të riun dhe adoleshentin e tradhëton fare. Më kujtohet kur një ditë Gjon Shllaku, profesor i filozofisë, më tha gjatë drekës: "Ndigjo këtu, ti je tue lexue Dostojevskin". "Ku e din ti?" i thashë. "Të njof nga sytë, - m'u gjegj -, asht e treta ditë që ti je tërbue fare. E ç'roman je tue lexue?" I them "Delitto e castigo" - ishte n'italisht. "Ah, po ku e ke gjetë?" "Në bibliotekë, aty janë rresht të tanë veprat e tij". "Ndigjo, - më thotë, - atij libri i vjen era raki, duhan, myk, kafe, prostituta, nuk ka kurrfarë të mire e të bukur aty për ty, por janë gjithë këto sende të shemtueme. Ti je tepër i ri për me e lexue. Ma vonë kam me të kshillue vetë se shka me lexue prej tij...".

- Dhe, sipas tij, kur duhet ta lexoje veprën "Krim e ndëshkim"?

- Ah, kur t'ishem rreth tridhetë vjeç, jo ma përpara. Por, më tha, kur të rritesht edhe pak, se halà je adoleshent, mund të lexojsh "Vllaznit Karamazov". Megjithkta, më porositi, libri ma i bukur në botë asht "Don Kishoti".

- Mendoni edhe ju sot se ky është libri më i bukur në botë?

- Edhe unë. Dhe është ma aktual i gjithmonë. Në shqip janë dy përkthime, nga dy përkthyesa të mdhajt, si Fan Noli në vëllimin e parë ashtu Petro Zheji në të dytin. Për mendimin tem, Zheji ka përkthye ma mirë se Noli. E ka përkthye shumë ma mirë e shumë ma shqip.

- Vëllimi i dytë është dhe më i vështiri?

- Edhe ma i vështirë, por edhe pa lexue të parin nuk bahej... Tash e dimë, janë edhe klasikët grekë e romakë. Ata s'i përmenda se nënkuptohen. Shikjoni, ata kanë mbriritë kulmet e letërsisë dhe ata duhet t'i njofi çdo njeri i kulturuem. Nuk ka pra njeri pa lexue, në daç "Iliadën" në daç "Odisenë", e sidomos "Odisenë", që asht ma pak heroike se "Iliada". Por janë vepra të cilat e pjekin mendimin e njeriut. Gjithashtu, mirë do t'ishte që në gjuhën shqipe të qenë perkthye Trubadurët. Mjerisht, nuk i ka hy

punës kerkush, megjithëse është baza e të gjithë letërsisë europiane. Unë i kam lexue italisht, kam qenë i ri, por më kanë pelqye, se janë shumë të bukura. Janë gadi-gadi si rapsoditë tona. Në letërsinë shqipe, përveç Fishtës, nuk ka si këto vepra që përmenda, por janë të tjera vepra që duhen njoftë prej çdo shqiptari.

- Por, a mund të quhen ato klasike?

- "Kanuni i Lek Dukagjinit" ose "Kanuni i Maleve" është vepër që duhet njoftë prej gjithë shqiptarve, se aty janë bazat e traditave tona. Kanunin duket sikur e ka vetëm Veri, por në fakt asht i të gjithë shqiptarve. Gjithë shqiptarët e kanë në zemer e në mendësi. Nuk është letërsi, por duhet lexue patjetër. Mandej janë prrallat, si të Donat Kurtit dhe legjendat tek "Visaret" e Bernardin Palajt, të cilat formojnë një letërsi më vëdi të karakterit shqiptar. Asht Gjergj Elez Alia, një personazh të cilit duhet me i ngrit një monument të madh, ashtu si Gjergj Kastriotit. Gjergj Elez Alia në letërsi asht hero real! Mandej, prej letërsisë artistike shqiptare dahan dy shkolla: ajo e klerit katolik dhe e realizmit socialist. Nga e para dalin kulmet dhe veprat dominuese në gjysën e parë të shekullit XX. Janë të letërsisë, nuk po them shkodrane, por edhe të tjera, edhe laike, si Lasgush Poradeci që ishte bashkohor me ta, Mitrush Kuteli. Ata kanë shkruar ndryshe, por edhe këta janë

pjesë e kësaj shkollës së parë. Për sa i takon realizmit socialist, më vjen keq ta them, por kanë vlerë veç veprat e Kadaresë, nga të cilat si ma kryesoret çmoj dy: "Kronikë në gur" dhe "Çështje të marrëzisë", që kishte me qenë vazhdim i së parës.

- At, cili është libri i fundit që ju ka pëlqyer në letërsinë shqipe?

- "Çështje të marrëzisë".


- Cilin nga librat tuaj do të këshillonit për lexim?

- "Rrno vetëm për me tregue" si dhe "Fratin e Pashallarëve Bushatlij". Së shpejti besoj se del edhe botimi i dytë i "Fratit". Për këte botim më kanë ardhë, nga disa profesorë arbresh, disa dokumenta arkivi, shumë interesante, që vërtetojnë se kjo ngjarje nuk është vetëm fantazi e jemja.

- A mund të themi se "Fratin..." ka ndonjë paralele me "Princin" e Makiavelit?

- Jo. Ka një ndryshim të madh n'ideologji. Për Makiavelin mund të bash gjithçka për politikën, deri vrasje, ndërsa Frati ka si bazë vetëm dashurinë. Le të themi se "Fratin" i Bushatlijve është antipod i "Princit" të Makiavelit.

Nëntor 2006 (bot. postum "Hylli i Dritës".....)

“NUK E
DIJSHIM
SE DO
MBËRRIJMË
LIRINË”Në bisedë
me Gjergj Metën

Kush ka rastin ta takojë, kupton se pas një burri të kërrusur prej moshës dhe prej vuajtjeve të burgut, gjendet një njeri energjik dhe i kthjellët. Nuk i mungon mprehtësia dhe rreptësia në argument, sikurse nuk i mungon as delikatesa, ëmbëlsia dhe sensi i humorit. At Zef Pllumi, prift katolik françeskan, nxënës i Fishtës dhe i Harapit, ka vuajtur shumë vite në burg gjatë kohës kur religjioni ishte i ndaluar prej ligjit komunist. Megjithatë në fjalët e tij gjen plot ngushëllim dhe shpresë, sikurse gjen edhe mirësi të pafund. Flet ngadalë dhe peshon çdo fjalë. Më së miri e ka treguar në veprat e tij e sidomos në tre vëllimet "Rrno vetëm për me tregue". Por kësaj here e intervistua për kujtimet e tij lidhur me vitet e para të lirisë fetare dhe politike në Shqipëri në dhjetorin e vitit 91. Ndërsa tregon, e ndjek një buzëqeshje e vazhdueshme dhe në këtë buzëqeshje shprehet mirësia e një njeriu që ka ditur të vuajë, por mbi të gjitha të falë.

- Atë Zef si e keni përjetuar ëndrrën e lirisë në burg?

- Na, besa-besë, kur kena kenë në burg nuk na e ka marrë mendja se dalim ma jashtë. Na e dijsim se liria do të vijë, por se ia mbrrijmë na vetë, këte nuk na e ka marrë mendja kurrë, sepse edhe shnetin nuk e kishim të mirë. Kena kenë shnetligj, jo si sot, se sot jemi njiqind herë ma mirë. Kemi kenë të vuejtun e stërvuejtun, me pleqni në shpinë e për këte arsye nuk na e merrte mendja se ia mbrrijmë ditës së lirisë. Megjithkëte, ndaj edhe e kam shkruar edhe në vëllimin e tretë *Rrno vetëm për me tregue*, kur ishem në burgun e Shënavisë (Sarandë), natën e Kshndellave, kur rashë me fjetë, nuk po më merrte gjumi, ishte natë Kshndellash e isha tuj mendue, edhe m'u duk se andej nga mesnata po bijshin kumbonët, e përnjimend po bijshin kumbonët. Prej kuriozitetit, sepse kisha dëshirë me i ndie me një za ma të fortë, dola jashtë n'obor, por ishte ftohtë e nuk ndigjova kurrë. Dy herë e përsërita këte punë dhe ndodhte e njajta gja. Sa hyjsa në shtrat, ndigjojsa kumbonët, kur delshem jashtë, nuk i ndigjojsa ma. N'ate ças erdh një mik i emi, ishte i burgosun edhe ai, një Ruzhdi Çoba, e më tha: "Zef, ça ban këtu?" I thom: "Dola me ndie se m'u duk sikur kanë ranë kumbonët". Korfuzin e kishim shumë afër e i thashë: "M'u duk sikur m'i solli era zhurmat prej Korfuzit, por tash nuk jam tue i ndigjue ma". "Ik, më tha, se po ftofesh!" Edhe hina mbrenda e fjeta. N'e nesret nadjë Ruzhdiu m'u afrue e më tha: "Si ishte ajo puna e kumbonëve?" E i tregova. Më tha: "Kumbonët i ke ndie sak. Unë, tha,

due me të thanë një gjasend. Kam ndejtë tue mendue gjithë natën, se nuk më ka marrë gjumi qysh se të kam pa ty. Mrenda vjetit, mbas 12 muejsh, kena me pas lajme të mira.”

Në krye të vjetit në gjithë Europën lindore, tue përfshi edhe Rumaninë, ra komunizmi. Mbetëm vetëm na! Por, kur u zbërthye komunizmi n’Europën lindore, ishte e sigurtë se edhe te na do të vinte ajo ditë, se nuk kishim ka me ia mbajtë. Dhe ajo ditë erdhi pikërisht mbas një viti. Megjithçse nuk e kishem besue se do t’ja mbërrij, ajo ditë mbërrijti!

- A mund të na përshkruani çastet e para të lirisë, d.m.th. nga viti 89, kur jeni liruar nga burgu, deri në dhjetor të 91-shit, kur erdhi demokracia?

- Në 89 ende Shqipnia ishte “shkëmb graniti i marksizëm leninizmit” në breg t’Adriatikut edhe ishin ende parrullat. Edhe pse në Rumani kishte ra komunizmi, prap se prap këta nuk kishin ndër mend me lshue pë... s’pakut ashtu bërtitshin këta. Megjithëkëtë, ne na kanë lirue përnjiherit të gjithë priftent, mbrenda një dite, pamvarsisht se ishim ndër burgje të ndryshme, me 11 prill 1989, që ishte dita e vdekjes së Enver Hoxhës. Aq sa, tue qesh, un thojshem: “Paj na liruen për shpirtin e Enver Hoxhës”! Un ishem në Shënvasi, dom Simon Jubani ishte në Burrel... e mue më kishin prue para pak ditësh në Tiranë, në burgun e Saukut, që tash asht burgu i grave. Isha bashkë me disa puntorë nga ata që ndërtojshin pallate aty afër. Ishte një kamp i vogël, ku ishin të tanë ustallarë, e aty më kishin prue dhe mue. Kështu që lirimimi më kapi këtu në Tiranë. U lirova. Kur u ba dekreti për 5 priften, bashkë me ne u lirue edhe një djal i ri. Ishte një maqedonas prej Prespet... edhe kishte dashtë me hikë në Maqedoni, e kur e kishin xanun në kufi, i kishin thanë: Pse deshte me hikë? Pse tradhtove? Ai u përgjigjet: “Jo, un s’deshta me tradhtue atdheun, por deshta me u ba prift... e shkova në Maqedoni me u ba prift”. Ai ishte një djal rreth 22 vjeç dhe kishte dishirin me u ba prift. Gjatë burgut, kinse po lujschim shah me të, un i spjegojshem Ungjillin dhe jetën e Krishti, se ai s’dijte kurgja. U lirue edhe ai me ne, sepse e thirrshin të tanë “prift”, e kështu hini edhe ai në listën tonë. Pesë priftën katolikë dhe ai djal i ri.

Mbas nja tri ditësh erdhën nipat e mi e më morën. Shkuem te një motër e emja që ishte e martueme në Tale të Lezhës. Shkova atje, sepse s’kishem ku me shkue tjetër. S’kishem njerëz tjerë të mi. Ndejta aty rreth dy muej. Gjatë asaj kohe çojshem meshë përditë në shpi të motrës, tinës. Aty vijshin kushritë e të afërmit e tyne, por dikur aty erdh Këshilli i fshatit e i thanë motrës që ky njeri nuk asht i regjistruem këtu... dhe me të vërtetë unë regjistrimin e kishem në Shkodër. Ata thanë: Kemi informata që ky çon meshë këtu. Mbas kësaj u nisa për Shkodër me ba dokumentat. Në Shkodër kam fjetë nëpër familje të ndryshme, kush të më thirrte. E nxora letërnjoftimin, e nxora shpejt, sepse para se me hi në burg aty ishte baba i Gjergj Liqejzës, që i kisha vue kunorë tinës dhe ai më kishte shtie mue në një regjistër të veçantë, kështu që emni u gjind shpejt. E bana pasaportën për një orë. M’u dojte me ndejë në Shkodër, se te motra nuk ishte ma e mujtun.


Nga familja në familje, në fund xuna vend te shpia e At Shtjefën Pistullit. Nipave dhe stërnipave të tij u thojshem se sot një vjet kjo punë ka marue, sot një vjet këtu, në këte oborr, kanë me hi makinat. Ata qeshnin me mue. Unë u thojshem se nuk na kanë lirue kot, se isha fort i sigurt që kishte ardhë dita e lirisë.

- At Zef, ju keni ushtruar aktivitetin tuaj religjioz që në fillim në Tiranë. Çfarë mund të na thoni për Tiranën e atyre viteve?

Na meshtarët kishim një organizim të mbrendshëm mes vedit dhe ndajshim detyrat e secilit. Mendojshim edhe një punë: kishte një probabilitet që në Shkodër dhe pjesën e katundeve katolike rreth Shkodrës mund e lejojshin lirinë e fesë, por a e lejojshin në tanë Shqipninë, se kishim të bajshim me komunistat?! Ishin po ata që kishin sundue për 50 vjet. Pamvarsisht se në Shkodër kishte fillue demokracia. Edhe pse nuk ishte lejue pluralizmi politik, me daljen e katolicizmit, me lirinë e fesë, edhe të katolikvet edhe të muslimanvet, ishte lirue gjendja. Por a lirohej gjendja në Tiranë? Enveri ishte aty në midis të pjacës, i madh 9 metra. N’anën tjetër, në të hyme të bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, në njenën atë ishte Lenini e në tjetrën anë ishte Stalini. Ishin të tanë në frone të veta. Erdha në Tiranë. Mendova me çue meshë natën e Kshndellavet. Në Tiranë kisha ardhë qysh me datën 8 dhjetor. Shkova me takue Dom Ndoc Sahatçinë, që ndodhej në Tiranë, i cili ishte kenë famullitari i fundit i Tiranës. I thash Dom Ndocit se duhej me kremtue meshën natën e Kshndellavet. Ai tha: “Nuk bajmë gja pa lejen e qeverisë”. Atëhere u vumë e i shkruem një letër Ramiz Alisë, tuj i kërkuë që për natë të Kshndellavet me thanë meshë. Nuk na erdhi kurrfarë përgjegjet. Ishte koha kur Universiteti nuk bante shkollë, se ishte çue rinia me kërkuë pluralizmin politik. E n’ato ditë un ndejta këtu në Tiranë dhe u mundojshem me dijtë si po shkon puna. Sepse pluralizmi politik ishte shumë i randsishëm për Shqipninë: flitej tinës dhe bahej tinës. Ndeja ato ditë këtu, derisa u formue Partia Demokratike. Ktheva për pak ditë në Shkodër, por mbasi isha ma i riu dha ma i gjindshmi e mbasi kisha shumë miq e kisha ku me fjetë, frenit më caktuen me u nisë në Tiranë. Erdha përsëri në Tiranë. Me Dom Ndocin i shkruem telegram Ramiz Alisë me daten 8 dhjetor, mbasi nuk kishim marë asnjë përgjegje prej letërës sonë. Aty i kërkonim që natën e Kshndellavet me çue meshë. Mbas dy ditësh vjen postieri te Dom Ndoci dhe thotë: “Shkoni në Komitetin Ekzekutiv e kërkon, do t’ju japin përgjigjen e telegramit Ramiz Alisë”. Shkuem me marë përgjigjen dhe na lexuen tekstin që thonte: “T’i plotësohet kërkesa Kishës Katolike sipas ligjeve në fuqi”. Ligjet në fuqi nuk lejojshin shërbim fetar...!

Megjithate naten e Kshndellavet né e kremtuem meshën. Lajmërimet që kishim vù nepër shtylla përmeshën e natës së Kshndellavet hiqeshin prej njerëzve të Sigurimit. Por ate natë kishte plot njerëz. Ditën e Kshndellavet edhe ma shumë. Megjithëse policia na kishte detyrue me lajmëruë 3 ditë përpara çdo herë që çojshim meshë, nuk u ndalëm. N’ato ditë kishte shumë vizita nga drejtues të lëvizjes studentore dhe nga shumë studenta, që merrshin pjesë pothuëjse në çdo meshë.

“Standard”, 8 dhjetor 2005



Në 100 - vjetorin e lindjes së shkrimtarit Atë Zef Pllumi

“FRANÇESKANËT E MËDHAJ” - NJË MODEL KUJTIMESH TË ARTA

Prof. dr. Alfred Çapaliku

“Për të kuptuar se përse i shkruan ai kujtimet do të na duhej të njihnim gjithsesi personin dhe personalitetin e tij.”

Aurel Plasari (1)

Libri me shkrime në formë refleksionesh “*Françeskanët e mëdha*”, Tiranë, 2001 i Atë Zef Pllumit u prit me kureshtje e ngrohtësi nga opinioni publik shqiptar në fillimin e shekullit XXI. Jehona përcillet deri në ditët tona. Memorialistika kushtuar françeskanëve të mëdhenj OFM nis me një deklaram *sui generis* të autorit:

“Ka disa vite që e ndjej barrë të randë në shpirt për me shkruë këtë libër kujtimesh, në shej mirënjohje për ata që më edukuen ashtu si deshën vetë, me ndjenjat e krenarisë kombëtare, të respektit dhe kritikës për të gjitha mendimet njerëzore, të lirisë personale e kolektive. Jam tepër i gëzuem se më duket sikur po laj një detyrim të madh ndaj tyne.” (2)

Kujtimet e një fëmije që po rritej me ëndrrën për t’u bërë frat , më tej mbresat e një françeskani të ri për sivëllezërit e tij e mandej përshtypjet e një personaliteti kishtar për shtyllat kulturore të kombit tonë, shfaqin portretet vezulluese të njëmbëdhjetë shkrimtarëve të Shkollës Letrare Françeskane të Shkodrës. Ata janë madhështorët: Gjergj Fishta (1871 - 1940), Shtjefën K. Gjeçovi (1874 - 1929), Pal Dodaj (1880 - 1951), Vinçenc Prennushi (1885 - 1949), Marin Sirdani (1885 - 1962), Anton Harapi (1888 - 1946), Justin Rrota (1889 - 1964), Bernardin Palaj (1894 - 1946), Donat Kurti (1903 - 1983), Benedikt Dema (1904 - 1971), Gjon Shllaku (1907 - 1946). Jemi të një mendimi me autorin, se Kuvendi Françeskan do të mbetet një fenomen i papërsëritshëm në historinë e kulturës shqiptare.

Shkrimtari i dymbëdhjetë i kësaj dyzine të ndritur del me përvujtëni e modesti midis rreshtave të librit. Ai është Zef Pllumi (**28 gusht 1924, Mali i Rencit, Leznë - 26 shtator 2007, Romë, Itali**), i cili shprehet me admirim të madh e me respekt të thellë:

“Kuvendi Françeskan ishte një akademi e vërtetë që pregatiste intelektualët e rij të Shqipnisë me ndjenjat patriotike, kulturë, art e shkencë ... Ndër këto shkrime tregoj pak a shumë vetëm njohjet e kujtimet e mia personale të fëminisë e rinisë sime, të cilën, kur me mall e nostalgji e kujtoj, nuk mund rri pa ofshajtë për “kohën e artë” që dikur pati kultura shqiptare në Shkodër.” (3)

Emblemës françeskane Atë Gjergj Fishta i janë kushtuar dy rrëfime shpirtërore në këtë përmbledhje, i pari në gjalljen e tij dhe e i dyti mbas kalimit në amshim. Mbetet për një kohë të gjatë në mendjen e lexuesve vrojtimi lakonik i Poetit kombëtar:

“Un dishroj që Shqipnisë t’i dalin edhe shumë shkrimtarë e poetë, por kjo poezia asht një dhanti e natyrës. Kur mungon talenti, atëherë asht ma mirë që të baheni doktora e inxhinjera ose edhe këpucarë, se sa shkrimtarë të këqij. Një shkrimtar i keq i ban shumë dam popullit që e lexon.” (4)

Zef Pllumi ishte pesë vjeç mes lojnash në Mal të Rencit, kur u vra barbarisht në Zymb të Prizrenit Atë Shtjefën Konstandin Gjeçovi. Imazhi i tij vjen veç në ligjëratë të zhdrejtë, për shkak të mungesës së kontaktit fizik. Shtatëdhjetë e dy vite më pas autori e përkujton me një kuintesencë prekëse veprën e pamort të kodifikuesit të maleve tona, Atë Shtjefën Gjeçovit:

“... Kanuni i Lekë Dukagjinit, pa dyshim,



përfaqëson kartën e identitetit shqiptar... Portreti i Gjeçovit asht Kanuni i Lekë Dukagjinit, portret identik i shpirtit shqiptar.” (5)

Risjellja para syve dhe pranë zemrës së lexuesit e figurës komplekse të Atë Palë Dodajt vjen përmes vlerësimit të Atë Zef Pllumit ndaj letërkëmbimit të pafund e të çuditshëm të tij:

“E vërteta rrin e ndryme ndër kasaforta arkivale me shumë çelësa sekrete, një nder këta çelësa ishte edhe Patër Pali, përse i përket kohës në të cilën jetoi.” (6)

Ipeshkvi i Sapës dhe poeti i ëmbëlsisë Atë Vinçenc Prennushi përshkruhet i gjallë dhe vjen para lexuesit përmes një dialogu me novicin 16 vjeçar Zef Pllumi, në oborrin e kishës së Nënshatit:

“ - Çka të pëlqen ma tepër këtu te unë?”. I përgjegja se mbi të gjitha më pëlqejnë pëllumbat. Ai qeshi lehtë me buzën në gaz, mandej më tha: “ - Ti me të vërtetë mbiennin e ke Pëllumbi, por pamjen e ke ma tepër te skyfteri.” (7)

Personalitetin e historianit Atë Marin Sirdani, shkrimtari Atë Zef Pllumi e pikëzon te kryevepra e tij “Skanderbegu mas gojëdhanash”:

“Kjo asht një vepër e madhe ku shkenca lidhet me folklorin. Legjenda dhe historia aq sa kapërthehen njena me tjetrën, aq edhe përputhen. Këtu asht merita e madhe e At Marinii.” (8)

Stilin oratorik të shkrirë me artin letrar të Atë Anton Harapit, autori i librit e jep si dëshmitar okular, përmes freskisë së mbajtjes mend të porosisë proverbiale të padër Antonit:

“ - Ti don me u ba frat?”. “ - Po - ia ktheva unë”. “ - Me të vërtetë?”. “ - Po, po, po!”. Atëherë At Antoni nxori nga qafa e vet një medalje t’argjenditë dhe e vuni në qafën time: “ - Rueje këtë medalje! Kur të rritesh paraqitu në Kolegjën Françeskane dhe porsa ta shohin këtë kanë me të pranue!” (9)

Autori i refleksioneve të shpirtit Atë Zef Pllumi ia çmon Atë Justin Rrotës, në distancë kohore, librin e tij mësimor të mirënjohur “Literatura shqipe”, botuar për herë të parë në Shkodër më 1925 dhe ribotuar i plotësuar po aty më 1934:

“Ky tekst shkollor kje i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe dhe i punuem me kritere të shëndosha pedagogjike sa edhe sot, mbas afër 80 vjetësh, do t’ishte i nevojshëm për shkollat e mesme.” (10)

Me Atë Bernardin Palajn, zbuluesin e ADN - së shqiptare, i riu Atë Zef Pllumi

(Vijon në faqen 9)

Në kohën e utopizmit socialist, kanonizuar tek socrealizmi, dhuntia e të parashikuarit i njihej vetëm largpamësit, por, me raste, shfaqej dhe Naimi si orakull. Pasi të recitoheshin vargjet: “Lum kush të rrojë/ta shoh Shqipërinë Zonjë”, do thuhej: i madh Naimi, e parashikoi Shqipërinë e së ardhmes, pavarësisht se nga koha e shoqeve na mbeti “Zonja nga qyteti” e R. Pulahës. Këtë atribut poetit po ia njeh dhe Besnik Mustafaj në romanin e tij destopik “Fati i marrë”, duke i vënë vargjet e Naimit në krye të librit: “U ngrit fati i Shqipërisë/Si i vdekuri nga varri/Mori udhën e Azisë/Duke rendur si i marri”. (Në kujtesën popullore i vetmi i vdekur, që ngrihet nga varri për të shlyer një premtim, është Kostandini.) Fati mori udhët e Azisë, po për ku? Përsëri përgjigjen e marrin nga Naimi: “Dielli lind andej nga perëndon”. Nëse Naimi fatin e Shqipërisë e lidh me Skënderbeun, De Rada, do shkruajë për “Skënderbeun e pafat”? (Fat të mbrapshtë kishte dhe Frosina e dashuruar me Skënderbeun.) Në romanin “Naltësimi i Iskanderit”, nga ku Besnik Mustafaj merr frymëzimin, flitet për një dashuri me shikim të parë të vajzës së Huniadit me princ Iskanderin. (Janë shkruar libra për marrëdhëniet intime të Skënderbeut, sikurse dhe për historitë erotike të mbretit Zog, përkundër dendyt të Parisit. “E dashura e Stalinit” titullohet një libër kushtuar jetës rozë të bolshevikut të kuq. Përherë duhet një Helenë apo një Penelopë për të vënë në provë “burrat e shtetit”).

Romani destopik i Mustafajt ndahet në tri pjesë të titulluara: “Përkthyesi M.B”, “Historiani D.D” dhe “Biografi B.J”, ku secili ka një histori të vetën, në dukje pa ndonjë lidhje me “Fatin e marrë”, por, janë pikërisht këta të inicialeve, që, lëvizin fijet e rastësive e të subjektit. Përkthyesi sjell historinë intime të Iskanderit në shqip, historiani rrëfen lidhjen dashurore të anglezit me gjakovaren Hana, ndërsa biografi ofron fakte dhe ngjarje tronditëse, sikurse është masakra e Manastirit ku u vranë 502 krerë fuedalësh shqiptarë. Edhe pse personazhe të dorës së dytë, ata janë kontributorë në vlerat e romanit, duke e ushqyer me fakte dhe xixa, që ndezin fantazinë e autorit të romanit. Që të gjithë i lidh: fati i Shqipërisë. Gjithsesi se bepçiu mbetet, Benjamin Disraeli, fillimisht duke lartësuar Iskanderin, më pas, si dashnor pasionant i myslimanës nga një familje e madhe gjakovare dhe, në fund: si kryeministër i Anglisë për të ndikuar në fatin e Shqipërisë, pse jo dhe të romanit? Adhuruesi i Bajronit kthehet në burim frymëzimi për shkrimtarin Mustafaj gjë aq, sa ai nuk ngurron të shtrojë pyetjen: çfarë fati do të kishte Shqipëria pa Mbretërinë e Bashkuar, kur diktatori Hoxha, sikurse dihet, e shihte inglizin si një rrezik? Si mbiu kaq pa pritur kjo dashuri për Shqipërinë tek kryeministri dhe mbretëresha e Anglisë, pyet autori, por që realisht nuk pati duk, nëse i referohemi Traktatit famëkeq të Londrës. Sipas autorit kjo enigmë duhet zbërthyer dhe ai përpigjet ta bëjë, duke vënë në lëvizje një përkthyes, një historian dhe një biograf, por më shumë veten si diplomat, i cili i dorëzohet shkrimtarit sapo trulloset nga situata që premtojnë art. Të gjithë punojnë për autorin e romanit. Mos vallë një preferencë e hebreut të konvertuar në katolik, i të mirënjohurit Benjamin Disraeli, po merret për dëshirë? Gjithsesi Besnik Mustafaj këmbëngul të zbërthejë një kod nga romancierit dhe kryeministri anglez, i cili ka një histori intime me një shqiptare nga Gjakova, Hana, me të cilën vë kurorë, edhe pse një myslimane, fakt që s’ia përmend askush në Londrën e krishterë. (Nëse shkrimtari kryeministër shkruan romanin “Naltësimi i Iskanderit” në mediat

Romani “Fati i marrë” i Besnik Mustafajt

KJO ËSHTË VETJA IME E VËRTETË

Nga Fatbardh Amursi

shqiptare bëhen përpjekje për çmitizimin e heroit tonë, duke tentuar ultësimin e tij, me gjoja, zbritjen në tokë. Thua se po flitet për një kozmanaut.)

Nuk mund t’i shpëtojë vëmendjes sonë fakti, që, thuajse të gjithë personazhët përfshihen në procesin e konvertimit, herë duke ndërruar fe dhe herë duke u natyralizuar në një shtetësi tjetër. Shpesh lihen sarajet për oborret mbretërore, aq sa Shqipëria të përngjan me një monarki të Lekës IV, që pret t’i bashkohet Mbretërisë së Bashkuar më shumë se sa Bashkimit European. Nëse Skënderbeu dashurohet me të bijën e Huniadit, pesë shekuj më pas është mbreti Zog, që do të lidhë kurorë me hungarezin Geraldinë. Autorit i pëlqen të vërë në dukje: “aftësinë e mrekullueshme që ka identiteti shqiptar për t’u përshtatur

me rrethanat”, duke mos u tjetërsuar, shkombëtarizuar. Një dukuri e përshtatjes është dhe konvertimi, që, në shumicën e rasteve shfaqet si pragmatizëm. (Historiani D.D, i cili “nuk kishte thënë një fjalë të vetme rreth origjinës së tij shqiptare”, në vend të interesohet për rrënjët e veta e ha meraku për rrënjët e ish kryeministrit Çerçill, por dhe mbiemri i D.D-ës tërësisht mysliman, s’ tërheq vëmendje në botën anglo-zakone, sikurse ndodhi dhe me gjakovaren Hana, e konvertuar në katolike, sapo bëhet gruaja e shkrimtarit anglez. A mund të quhet kovertim kthimi në fenë e të parëve të tu? Feja, tek asnjë personazh s’ është pengesë, madje as raca, përkundër fisit. Personazhët edhe pse i përkasin një mjedisi fanatik, me lehtësi mund të kthehen në kozmopolit. Historiani D.D, përkundër këmbënguljes



të të atit, i shmanget hamendjes së tij se bashkëshortja kishte lidhje gjaku të largët me familjen mbretërore, gjë që në Mbretërinë e Bashkuar i kthehej në favor, por ai tregohet indiferent. Biografi kishte nevojë për një xixë, që të përflakej në fantazinë e tij. Nga faktet zgjidhte vetëm ato, që i përshtateshin qëllimit të tij. Zbulon letrën e Çerçillit në marrëveshje të fshehtë me Stalinin në mungesë të Rusveltit, ku në ndarjen e re të botës pas luftës së Dytë Botërore Shqipëria mbetej 100% në influencën angleze, gjë që s’ ndodhi, sikurse dhe në copëtimin e luftës së Parë Botërore, ku simpatia angleze, nuk ndryshoi asgjë në gjëmën e shqiptarëve. (Napoleoni nuk ia dha lirinë Polonisë, sikurse ia kishte premtuar konteshës Maria Valeska, me të cilën u dashurua marrëzisht, ngaqë qëllon të jetë i marrë.)

Për të kuptuar debatin mediatik të Rexhep Qoses me Kadarenë, i sajuar për publikun me titullin e fryrë si një përplasje titanësh, do u këshilloja të paqartëve të lexonin romanin e Besnik Mustafajt “Fati i marrë”. Iskanderi para se të takohej me Huniadin, heq uniformën e turkut, pra, “zhvesh rrobat e robërisë”, ato allaturka dhe vishet me rrobat allafrenga të të parëve të tij, duke u kthyer nga bej në princ. S’ ka tjetër, që të rrezatojë prirjet e shqiptarëve veç Heroit Kombëtar. “Kjo është vetja ime e vërtetë.”-do shprehet Iskanderi, sikurse shkruhet në librin e anglezit.

“-Baba! Turk është princ Iskanderi?

-Jo, është shqiptar.”-i përgjigjet Huniadi së bijës.

Iskanderi duke veshur rrobat allafrenga: nis kthimin e tij në identitet, por, krahas Gjergj Kastrioti ai do të thirrej dhe Skënderbe. “Atëherë po ndërron një mbret mysliman me një mbretëreshë të krishterë?”-do i thonë Iskanderit, gjithnjë sipas autorit anglez. Ahmet Zogu, edhe pse mysliman e shpalli veten mbret, ku si model do kishte uniformën plotë shkëlqim të perandorit austro-hungarez, ndaj zgjodhi për mbretëreshë një hungareze, të krishter, së cilës i ndërtoi dhe një kishë të vogël, ku ajo të bënte ritet fetare. “Si e pamundur dukej për t’i pajtuar tek i njëjti njeri besnikërinë ndaj dy burrave, të cilët ishin armiq për vdekje me njëri-tjetrin: sulltan Murati dhe Janosh Huniadi.” (Kjo e pamundur kthehej në forcë zakoni, sikurse e shohim të përsëritur në familjen gjakovare Dreni me lidhje të forta me Stambollin, me sulltanin, njëherësh dhe me Vatikanin dhe Papën.) Në krye të 10 mijë jeniçerëve, zgjedhur prej dorës së tij, Iskanderi kthehet në Krujë. Një jezuit e pajis “me vërtetimin e pagëzimit në kishën e Shën Gjergjit në Krujë, lëshuar nga atë Pal Engjëlli”, të cilin Iskanderi do e emronte Ministër të Jashtëm, detyrë që e ka ushtruar dhe autori i romanit. Kisha e dikurshme e Shën Gjergjit, ku Iskanderi ishte pagëzuar që kthyer në xhami. “Është radha jote ta



shëmbësh dhe aty të ngresh sërisht kishën e Shën Gjergjit. Ndryshe çfarë çlirimi i paske sjellë popullit tënd?”-i thotë princi grek Nikea, Gjergjit.

Kur nisa të lexoja kapitullin “Masakra” mu kujtua “Komisioni i festës” i Kadaresë, ndaj mu shtua kurjoziteti të shihja si do e përshkruante Besnik Mustafaj. Më rezultoi një nga kapitujt më të bukur të romanit. Mehmet Reshit pasha, me origjinë gjermane, konvertohet në mysliman. Masakrës së Manastirit i paraprijnë shkarkimet dhe emrimet e reja. Një prej të shkarkuarëve ishte dhe Ismail bej Vlora, në atë kohë kryetar i “Beslidhjes” së Beratit. Qyteti mbante erën e pilafit të gatuar me erëza që vinin nga Uzbekistani. Në varrimin e bejlerëve të masakruar nuk u lejuan as ritet fetare. Ata të gjithë ishin myslimanë. (Sipas statistikavë serbët në Kosovë shkatërruan qindra xhamija dhe asnjë kishë.) Para se t’i hidhnin në një gropë të përbashkët krerëve u rrëmbyen sendet me vlerë. Veç lirave turke prej floriri u grabitën para angleze, franceze, austro-hungareze. Një detaj ky që flet shumë. Kuajt e kapedanëve i therën dhe i bën suxhuk për ushtarët. (Këtë masakër në përmasat e një genocidi një studjues ekranesh do e quajë një masë shtërnguese, që, Porta e Lartë u detyrua të bënte ndaj disa rebelëve, që bllokonin rrugët tregtare të karvaneve.) Por, masakër ndodh të bëjnë dhe shqiptarët mes tyre, sikurse na e përshkruan autori në kapitullin “Ura si vend i punëve të dreqit”. Dy karvane në kapërcim të një ure gjenden përballë. Secili i kërkonte tjetrit t’i hapte rrugë. Plas pushka dhe dasmorët kthehen në mortorë. Nusja e tmerruara mbyllet në vetvete. “Njeri karvan duhej t’i linte radhën tjetrit për të kaluar i pari. Kaq e thjesht do të kishte qenë dhe e keqja do të ishte shmangur.”-do i thotë kavalieri nga Anglia, Hanës, duke mos kujtuar përjetimin e krenarisë prej të dy palëve. (Abaz Aga shoqëruesi i shkrimtarit anglez kish studjuar në Stamboll në një kolegji të huaj, i kishte shërbyer mbretit të Egjiptit Mehmet Aliut, sikurse kish udhëtuar në Amerikë dhe në Britaninë e Madhe, njeri i bredhur, i cili i merrte në besë të huajt, por me ndryshim nga tradita e paraardhësve këtë zanat e bënte me shpërblim. Për më tej, kish në plan të rikthehej në Egjipt, në Kajro për të ndërruar fenë, në atë krishtere. “Gjendja e ndërmjetme shpirtërore sjell një pasiguri të pashembullt identitare.”-shkruan autori. Ai që e paguan shtrenjtë këtë të ndërmjetme është Abdullah Dreni, i cili pranon të strehojë në saraje, autorin e masakras së Manastirit. Kryengritja e udhëhequr nga Sulejman Vokshi ndan: mercenarin nga luftëtari. I dërkojnë fjalë Abdullah Drenit se armiku i atdheut nuk merret në besë nga shqiptari. Nuk është i vetmi që zgjedh llogoren e gabuar për të luftuar, ndaj: “Llogorja, ku beson se të çon në rrugën e nderit”, duhet zgjedhur, vë në dukje autori. Kryengritësit bashkë me armikun e tyre, Maxhar pashën, nuk falin as Abdullah Drenin dhe ata që i shkuan pas. Kreu i fisit kujtonte se po i bindej Kanunit. Sarajet ia bëjnë shkrumb e hi. Meqë në saraja, luftëtarët që e sulmuan kishin ndër të vrarët dhe njerëzit e tyre, shfaqet një rrezik. Nis të interesohen se kush kishte qëlluar mbi ta. U desh ndërhyrja e Sulejman Vokshit që të shmangej gjakmarrja. Shumica e kryengritësve ishin myslimanë, qoftë Abdullah Dreni apo Maxhar Pasha, sikurse dhe Hana, e cila do të bëhej gruaja e kryeministrit anglez. Fati i marrë nuk i shpërblen të gjithë. Nga Azia ai po merr rrugët e Evropës. Nëse këtë roman nuk di ta lexosh midis rreshtave, nuk i merr të gjitha kënaqësit, sikurse mund të humbasësh orientimin nga dikresionet e vazhdueshme...

Shënime rreth vëllimit me tregime “Ku shkojnë këto gra të çuditshme?” të prozatores Zoica Gjolla Popi, botim i MUZGU-t

Vërtet, ku shkojnë këto gra?

Nga Mark Simoni

Kur mbyll librin me tregime të Zoica Gjolla Popi patjetër që e ndjenë se ke dalë nga një univers ngjarjesh impresionante, nga një rrebesh historishë dhe personazhesh tipikë, nga furtunë dramash dhe elektricitet subjektesh. Por ndjenë njëkohësisht se si aureolë të rri shija e këndshme e një libri të veçantë dhe interesant, një letërsi intensive, e rrëfyer me shumë kujdes, me rafinitura e filigrame.

Targeti i letërsisë së këtyre prozave patjetër që është portreti i femrës, punuar me shumë delikatesë, me një fjalor që i shkon shumë përshtat kësaj qenje fine, dhe ato duken si fajanca, tepër fragile, plot mister dhe ndjesi, rrethuar shpesh nga një jetë mondane, si miledi të traditës, me banesa plot statuja dhe piktura, me shumë hare dhe muzikë, siç ka dhe paralele të tjera që vijnë nga mizerabiliteti, me ndodhi tragjike dhe ekzistenciale, që luhen në katet e errëta të shoqërive.

Zoica hyn në rezonancën e personazheve, ndjenë frekuencat e shpirtit të tyre, është prezent shumë pranë dramave që ato përjetojnë, vuan me to, jeton jetën e tyre në jetën e saj.

Te “Miqhtë e heshtjes” është antipodi i zonjës arrogante të shtëpisë dhe Edës, puntore e përvuajtur dhe dinjitoze. Jo pa qëllim autorja shëtit në gjithë tregimin takat e rënda dhe agresive të pasunares, që portretizojnë karakterin e saj të vrazhdë, dhunues dhe arrogant. Luksi i rëndë i shtëpisë së saj ia shtojnë akoma më tepër potencën e arrogancës.

Krejt ndryshe karakterialisht është një zonjë tjetër, në një banesë po tjetër, dhe me një sjellje krejt ndrysh ndaj Mirelës, ndihmëses së shtëpisë. Ana është me shumë botë, pikturon, ka një stil aristokratik të të jetuari, dashuron me shumë finesë dhe emocion, i shërben me fisnikri Kristos së saj të sëmurë, don si sytë e ballit Vjolën e saj të brishtë e shumë të butë. Pikturon vazhdimisht dhe kjo i jep dimension estetik karakterit të saj si personazh.

Regjistri i të shkruarit të kësaj autoreje, në tregimin “Melodi të pa harruara” zbret një kat më poshtë, atje ku ka njerëz me halle dhe me probleme ekzistenciale, ku ka ca dhimbje e ngushtica, por ku ka po ashtu dhe hare e muzikë, ku jetojnë ngusht me shtëpi por të lirë në shpirt, ku ka edhe një plakë Selaniku që numron plot inatë këpucët e refugjatëve të cilët i ka futur me qera, por dhe një emigrante shumë të ndjeshme që i sajdis e dorovit muzikantët e vobegë siç është Nina e mirë, që pret një beb të vogël, dhe kujdeset dhe për Lilën, ciganen e bukur që vjen pas muzikantëve që nga atdheu i tyre i largët.

Prozatorja Zoica Gjolla Popi i ka dhënë shumë vend përshkrimeve të detajuara të ambienteve, çka na tregon se kjo autore ka shumë shije. Mure me piktura, parqe me statueta dhe skulptura, shatërvane me imitacione, parqe me vepra arti, gra të veshura me shumë shije, ku Zoica i shkruan detaj për detaj si një stiliste, na e bëjnë skenën e ngjarjeve shumë pikturike, imazhiniste, filmike dhe na përfshijnë dhe ne si lexues në dimensionin e tyre.

Gjeografia e ngjarjeve është e gjërë dhe dinamike, duke kaluar sa në një vend në tjetrin. Teatri i ngjarjes tashmë shpërngulet në Milano, në tregimin “Një natë pa gjumë”. Prozatorja e ka shkruar me shumë dhimbje dhe shqetësim këtë tregim, ku në qendër janë rrëfimet rrënqethëse të një grupi kosovarësh, që punojnë në emigracion, vetëm e vetëm për të ndihmuar financiarisht luftën. Në qendër është një i ri që ka brenda vetes edhe dhimbjen e madhe të vrasjes së të vëllait e xhaxhait, por edhe revoltën, edhe filozofinë e lirisë, edhe dashurinë dhe malli për shenjtërinë e vendit të tij.

Droni projektor i kësaj Zoica Gjolla Popi

lëviz pa rreshtur sa në një hapsirë në tjetrën. Në tregimin “Një ngjarje e papritur” skena është Kallamata. Një grua e re shtatzënë, Keti që shëtit mëngjeseve parkut së bashku me një çift të moshuarish, sulmohen nga një motorrist për tu grabitur. Tregimi ka shumë ankth, gjendje të ngrra dhe suspansi dhe mbyllet jo vetëm me ndalimin e motorristit, por dhe me një përfundim krejt të papritur.

Edhe tregimi “Ndërmjet dashurive” e ngre perden e skenës në një park tjetër, por tashmë pak më tutje, në Selanik. Personazhi kryesor, një nuse e re takon Jorgon, një zotëri i mbajtur, por i rënë nga vakti i një dashurie të kahershme e shumë interesante, karakter kaubojsi dhe ca sarahosh. Tregimi mbahet pikërisht në rrëfimin e gjatë të Jorgos, të bukur e të ndërlikuar të kësaj historie të veçantë dashurie.

Pothuaj i gjithë ky libër me tregime është i përshkuar nga drama të forta, përplasje karakteresh dhe interesash, keqkuptime, kapërthime ndjesishë, densitet energjishë njerëzore që shpërfaqen në ndodhi të mprehta dhe të rrezikshme. Në këto proza ka shumë ngjarje të ngjeshura, që përbëjnë dhe nuklin e mundësisë që këto tregime më vonë të zgjerohen, për të na dhënë vepra më të gjëra, më gjithëpërfshirëse, më imponuese me historitë e tyre interesante. Ndoshta proza “Jeto kohën Tea” është një mundësi befasuese dhe fatlume për tu trajtuar në të ardhmen edhe si një novelë më e zgjeruar, mbasi në subjektin e saj ka shumë energji, skena sugjestive, personazhe impenjativ, ritëm ndodhishë dhe dinamikë ndjesishë. I gjithë tregimi është odisea, kalvari dhe aventura e jetës së kësaj vajze të brishtë e të pafajshme, që merret peng nga ingranazhet e ashpër të një shoqërie të vrazhdë e maskiliste. Ngjarjet nisin me detajet e një dashurie dhe mbyllen me situata shumë të papritura.

Megjithëse Zoica Gjolla Popi duket se ka në letërsinë e këtij libri tema që janë të familjarizuara me lexuesin, por kjo autore përdor magjinë e të shkruarit dhe trajtimin krejt ndryshe të subjekteve, ka një stil tjetër nga çfarë jemi mësuar të lexojmë zakonisht, fut në përdorim psikologjinë e personazheve, përdor me shumë sukses filozofinë e gjërave dhe ngjarjeve, ndërton profile interesante karakteriale të personazheve.

Dhe çka është më e bukura për lexuesin e këtij libri, mbasi ai rri i gozhduar nga ngjarjet dhe mbanë frymën pezull se si po përfundojnë situatat, zgjidhjen fantastike ia jep kjo prozatore tashmë e maturuar. Të gjithë tregimet kanë një Happy End, (fund të lumtur), sepse Zoica Gjolla Popi është një njeri shumë dashamirëse dhe pozitivitetin e saj ndjehet që e ka patologji, që pa tjetër ndikon shumë dhe në letërsinë që ajo shkruan.



(Vijon nga faqja 7)

u takua fillimisht te redaksia e “Hyllit të Dritës”, si bashkëpunëtorë të revistës. Autori cilësimin e personalitetit të tij ia bën në dy kohë, më 1943 në Shkodër dhe më 2001 në Tiranë:

“At Bernardini nuk ishte vetëm korifeu i folklorit shqiptar, por edhe shkencëtar i vërtetë. Udhëzimet e tij më janë ngulë gozhde në rininë teme, që atëherë e deri sot që jam në moshën e fundit të pleqnisë.” (11)

Memorialisti konçiz Atë Zef Pllumi vetëm me dy fjali, njëra sintetike dhe tjetra analitike, rrok mbarë opusin e shkrimtarit poliform dhe mbledhësit të përrallava kombëtare **Atë Donat Kurti**:

“At Donat Kurti asht vjollca e letrave shqipe... Nuk punoi për lavdinë e emnit të vet, por vetëm me qitë në pah ata shka populli ynë kishte të ruejtun prej shijes e mendimit të vet estetik, etik e filozofik nëpërmjet kangëve, përrallave e lojnave. ” (12)

Universalizmin e autorit **Atë Benedikt Dema** prozatori Atë Zef Pllumi e jep përmes dy veprave të tij themelore leksikografike që u kushtoi jetën: “Fjalori enciklopedik” dhe “Fjalori historik i veprës “Lahuta e Malcis””:

“ Shumë vite ndej aty i kërrusun mbi tavolinë tue punue “Fjalorin enciklopedik, vepër kolosale, pesë - gjashtë vëllimëshe , që kërkonte njohuni të gjithanshme e kohë pune të gjatë kambëngulëse. Mbi fjalorin enciklopedik punoi deri në vdekje ... Në Arkivin e Shtetit gjindet një fond i randësishëm me veprat e tij.” (13)

Frati filozof **Atë Gjon Shllaku** përshkruhet me respekt të thellë dhe me mall të pashuar nga penda e ish - nxënësit të tij Zef Pllumi:

“Atë Gjoni në Liceun françeskan konsiderohej si profesor ma i pregatitun. Në kohën e vet thohej se ishte njeriu ma i naltë i kulturës shqiptare .Gëzonte simpatinë e gjithë rinisë shqiptare të shkollueme sepse kishte ide e projekte shumë të avancueme.” (14)

Rikujtimet e ngjyruara të Atë Zef Pllumit, risjelljet në horizontin e pritjes të lexuesit të personaliteteve të kulturës të asaj kohe, shoqëruar me ngjarje të përjetuara me intensitet dhe me rrëfime situatash, mund të cilësohen si krijime të ndjera, bazuar mbi dëshmi unike mbresash të pafshishme. Libri 150 faqesh i Atë Zef Pllumit e merr lexuesin me vete, mbasi është model i kujtimeve të arta.

Ai ka aromën e veprës më përfaqësuese të po këtij autori **“Rrno vetëm për me tregue”**, e cila mbas botimit të parë më 1995 në Tiranë u ribotua më 2006 rishtazi në Tiranë dhe më 2015 sërishtmi në Shkodër. Ajo vepër e bëri autorin të famshëm në letërsinë dokumentare, të kthyer si me bekim prej tij në letërsi artistike.

Mbas kësaj përqasjeje të natyrshme midis vlerave të tyre mendojmë se libri me kujtime i Atë Zef Pllumit **“Françeskanët e mëdhaj”** e meriton njëlloj ribotimin që do t'i jepte atij jetën e dytë plot sukses.

REFERENCA:

- Dr. Aurel Plasari: “Nën këmishën e hekurt të kujtimeve”. At Zef Pllumi OFM. Rrno vetëm për me tregue. I. Libri i kujtimeve. Pjesa e parë 1944 - 1951. Botimi III. Shkodër, 2015, f. 7.
- At Zef Pllumi:“Parathanie”. Françeskanët e mëdhaj. Tiranë, 2001, f. 8.
- Idem: fq. 6 - 7, 8.
- Idem: “Kur u njoha me Fishtë”, f. 12,
- Idem: “At Shtjefën K. Gjeçovi për Fë e Atdhe”, fq. 39, 42.
- Idem: “At Pal Dodaj, diplomati i paemnuem”, f. 47.
- Idem: “Vinçenc Prendushi, i dashtun, i përzemërt, i qeshun e bujar”, fq. 64 - 65.
- Idem: “Marin Sirdani, studiues i historisë së popullit”, f. 68.
- Idem: “At Anton Harapi. Shkrimtari e oratori”, f. 76.
- Idem: “At Justin Rrota, gjuhëtar i shquem”, f. 81.
- Idem: “At Bernardin Palaj dhe origjina e ciklit të kreshnikëve legjendarë”, fq. 108 - 109.
- Idem: “At Donat Kurti, vjollca e letrave shqipe”, f. 125.
- Idem: “At Benedikt Dema, enciklopediku”, fq. 136 - 137.
- Idem: “At Gjon Shllaku, filozofi sociolog”, f. 147.

Cleveland, SHBA, më 21. 08. 2024.

Shqipëria është një prej vendeve më të rëndësishme dhe më të harruara në kohët e Luftës së Ftohtë, por Stefan Çapaliku ndërmorri një hap për riafirmimin e kësaj teme, shkruan Bozho Kovaçeviçi në recensionin e librit të Çapalikut mbi humorin antiregjim në Shqipëri. Nëpërmjet “Jokes of Albanian Communist Days”, Çapaliku edhe një herë zmonton frikën nga regjimi i Hoxhës me të cilin bota, mendon ai, nuk është e njohur mjaftueshëm.

Stefan Çapaliku (1965) është shkrimtar i njohur shqiptar – prozator, poet, eiseist dhe dramaturg - veprat e të cilit janë përkthyer në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, polonisht, serbisht, maqedonisht dhe turqisht. Ka lindur në Shkodër, ndërsa në Universitetin e Tiranës përfundoi studimet për gjuhë shqipe dhe letërsi. Studimet i vazhdoi në Itali, Çeki dhe Angli dhe më tej, në vitin 1998, u doktorua në Universitetin e Tiranës. Nga vitit 1993 deri në vitin 1998 ishte shef katedre për letërsinë në Universitetin e Shkodrës. Nga vitit 1998 deri në vitin 2005 ishte ndihmës ministër i kulturës për publikimet dhe bibliotekarinë, për librin në përgjithësi. Nga viti 2005 Çapaliku është profesor i Estetikës në Universitetin e Tiranës dhe drejtor i Qendrës së Studimeve të Artit. Është fitues i shumë çmimeve për shfaqje në festivalet teatrale ndërkombëtare. Ka bërë përpjekje edhe si rregjizor i filmit dhe teatrit. Nga viti 2021 është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ministria e Kulturës e ka shpallur shkrimtarin më të mirë të dramës në vitet 1993, 2003, 2007, 2012, 2016, 2023.

Përveç veprave letrare, opusi jashtëzakonisht i gjërë i Çapalikut përfshin libra shkencorë, nga libri mbi satirën e politikanit, rilindasit, përkthyesit dhe shkrimtarit shqiptar Gjergj Fishta (1871-1940), të cilin e ka publikuar në vitin 2005, nëpërmjet “*Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqiptare*” (1997), *Estetika moderne* (2006) dhe *Ars Albanica* (2017) deri te vepra *Arti në Shqipërinë postkomuniste* (2021), e cila deri tani është përkthyer në portugalisht, polonisht, gjermanisht, frëngjisht dhe turqisht. Në opusin e tij bën pjesë edhe historia e fotografisë në Shqipëri, por edhe antologjia *Shija, pijet dhe aromat në letërsinë dhe artin shqiptar* (2024), të cilën e ka publikuar së bashku me bashkëshorten Elekrtnë. Kjo antologji sjell në shikim të motiveve të natyrës së qetë në pikturën shqiptare e shoqëruar me shembuj përshkrimesh të përgatijes së gjellëve dhe ritualeve të gatimit në letërsinë dhe poezinë shqiptare.

Atyre kroatëve, të cilët gjithsesi e kuptojnë gjuhën serbe më mirë se shqipen, ju rekomandoj të lexojnë romanin e tij nga periudha e komunizmit në Shqipëri *Secili çmendet sipas mënyrës së vet*, të cilin e ka publikuar shtëpia botuese beogradase CLIO. Ata që nuk e dinë, por kanë durim, do të duhet të presin përkthimin kroatisht të këtij libri vitin e ardhshëm në publikimin e Matica Hrvatska (Ama e Kroacisë)

Dukshëm Çapaliku është i kënaqur me kalimin e Shqipërisë nga komunizmi në demokraci.

Në këtë artikull do t'i referohem libërthit të *Jokes of Albanian Communist Days* (Barcoleta nga koha e komunizmit shqiptar) i cili është botuar në Tiranë këtë vit. Që në moton e librit shenjohet drejtimi i mënyrës së të menduarit e Çapalikut:

Cila ishte barcoleta e fundit e komunizmit? Tranzicioni politikë shqiptar.

Dukshëm, Çapaliku nuk është i kënaqur me kalimin e Shqipërisë nga komunizmi në demokraci. Është e dukshme edhe këmbëngulja e tij që edhe këtë libër, sikurse bën në shumë tregime të tij, të zbërthejë frikën nga regjimi i Evner Hoxhës, me të cilën, mendon ai, bota nuk është e njohur mjaftueshëm.

Pjesa hyrëse e studimit fillestar, të titulluar sipas njërës prej këngëve propagandistike të kohës së komunizmit *Me gëzim po shkoj në punë*, e drejton gishtin te fakti se numri dhe intensiteti i shakave për llogari të pushtetit është në përpjestim të drejtë me thellësinë e krizës nëpër të cilën kalon pushteti. Shqipëria në kohën e pushtetit komunist ishte pohimi i gjallë i këtij rregulli. Gjatë pothuajse gjysëm shekulli shërbimi i Sigurimit të shtetit informonte rregullisht Komitetin Qendror mbi barcoletat kundër regjimit si formën më të rrezikshme të propagandës armiqsore. Por, ndërsa pushteti i atërhershëm këtë veprimtari e konsideronte jashtëzakonsiht të rëndësishme, ka mbetur prapa puna e organizuar për mbledhjen e anekdotave të asaj kohe, si dhe studimi i tyre sistematik.

Tregimi i barcoletave është ritual në të cilin çdo dëgjues ka të drejtë të tregojë barcoletën e

Stefan Çapaliku, *Jokes of Albanian Communist Days*

Barcoleta e fundit e komunizmit, humorit i fshehtë në kohën e qeverisjes së Enver Hoxhës

Nga Bozho Kovaçeviç

Përktheu: Xhelal Fejza (Marrë nga “ideje.hr”)

Autori i këtij shkrimi është filozof dhe politikan kroat. Ka lindur në Pakrac – Kroaci me 11.01.1955. Është diplomuar për Filozofi në fakultetin Filozofik të Zagrebit. Themelues dhe redaktor kryesor i revistës “Gordogan”, redaktor në Institutin “Globus”. Ka dhënë leksione për filozofinë dhe sociologjinë në Fakultetin Teknologjik dhe në Akademinë e Arteve dramatike në Zagreb. Është një prej themeluesve (1989), të Partisë “Social-liberale” kroate, deputet në parlamentin kroat 1992-2000, ministër për mjedisin 2000-2003, ambasador i Kroacisë në Federatën Ruse 2003-2008, pastaj edhe kolumnist në shumë portale interneti dhe mësimdhënës në Shkollën e Lartë Dag Hamarskjöld. Veprat e tij kryesore janë: “Rasti i revizionistëve zagrebas” (1989), “Psikoanaliza dhe e majta” (1989), “Bota pas Luftës së Ftohtë; teoria dhe praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare (2015), “Ide për politikën” (2021). “Gjendje e jashtëzakonshme: historia, pandemia, pansllavizmi” (2023))

tij pasiqë të gjithë kanë qeshur me paraadhësen. Ndoshta dallimi themelor mes barcoletave dhe rrëfimeve komike qëndron në atë se ato janë ideuar për t’u treguar para të tjerëve, në mënyrë që të përjetohen ndërsa tregohen, e nuk destinohen, nëpërmjet një përshkrimi preciz, në procesin e ruajtjes së vazhdueshme. Shqiptarët, si edhe popujt e tjerë që jetuan nën regjimet totalitare, e kanë përdorur humorin për të lehtësuar jetën në kushte nga më të papërshtatshmet; të treguarit dhe dëgjimi i barcoletave ishte një terapi e llojit të vet, njëfarë shërimi nga jeta e padenjë që ishin të detyruar të jetonin. Kur Çapaliku thotë se qëllimi i barcoletave është “të ndajë dhe lirojë njerëzit nga tortura e komediantëve profesionistë” (8) supozon se ky pohim ka të bëjë me kohën e pushtetit totalitar, veprimet absurde të të cilit ishin në vetvete herë herë qesharake, e kësisoj edhe përfaqësuesit e tyre – sado seriozisht ta kuptonin veten ata – mund të quhen komediantë profesionistë.

Por, për kuptimin e barcoletave, gjë e cila siguron suksesin te dëgjuesi, ka rëndësi njohja e kontekstit. Në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë shtetasve të së cilës i’u ishte e ndaluar të udhëtonin jashte vendit, u ndërtua në kohën e komunizmit Hotel Tirana Internacional. *Të hysh brenda* në Shqipëri nënkuptohet të hysh në burg, ndërsa *të dalësh jashtë* do të thotë të udhëtosh jashtë shtetit. Për këtë shqiptarët u kuptonin shumë mirë barcoletëbërësin nga Shkodra Tefë Palushi i cili për hyrjen e tij në Hotel Tirana shpiku barcoletën:

Kur hyra si me pas dalë jashtë dhe kur dola jashtë si me pas hy mbrendë.

Në mënyrë që ndokujt barcoleta e mëposhtme t’i duket qesharake, duhet ta dijë se është krijuar në kohën kur kryerja e bisedave nëpërmjet celularit ishte tejet e shtrenjtë në Shqipëri, e kësisoj njerëzit nga Gjirokastra që konsiderohen kopracë, gjë që është e krahasueshme me paragjykimet për bracanët tanë (Bracanë- banorë të ishullit Brac në Kroaci. Shën. përkth.)

Një burri nga Gjirokastra po i digjej shtëpia. E pyesin komshinjtë e shqetësuar nëse ka thirrë zjarrfikësit. Ai përgjigjet: u dërgova një mesazh që të më thërrasin.

Pas këtyre shpjegimeve në parim mbi supozimet e nevojshme që barcoleta e dikujt të mund të jetë një barcoletë e sukseshme, Çapaliku përqëndrohjet te konteksti i komunizmit shqiptar. Komunizmi këtu, mendon autori, ishte më i egër se askund tjetër. Ishte një lojë pa rregulla e luajtur tërësisht sipas dëshirës së udhëheqësit të madh për të bërë të pamundur çfarëdo forme të lirisë individuale. Është pranuar nga të gjithë qëndrimi se pikërisht regjimi komunist shqiptar ishte më gjakatari, pohon Çapaliku. Nënvizon të dhënat mbi 59.000 të burgosur politikë gjatë 45 viteve të pushtetit komunist në Shqipëri, nga të cilët 7.022 vdiqën në kampet e punës, 6.027 kundëstarrë të regjimit komunist gjatë këtij gjysmë shekulli u eliminuan fizikisht nga pushteti komunist në Shqipëri.

Gjithsesi, kronikanët e krimeve komuniste të Jugosllavisë komuniste do të pohojnë se në shfira relative dhe absolute regjimi i Titos ia ka kaluar

atij të Hoxhës nëse si viktima politike numrohen të gjithë ata njerëz, pjestarë të uishtrisë kuislinge, që anglezët ua dorëzuan pushtetit jugosllav. Por, regjimi i Titos pas shpëputjes me Stalinin dhe pas larjes së pamëshirëshme të llogarive me mbështësit e Informbyrosë (*prostalinistët - shën përkth.*) evolui duke e ulur represionin, ndërsa regjimi i Hoxhës eci në drejtimin e kundërt. Në tërë periudhën pas konsolidimit të pushtetit në vitin 1945 deri në fundin e tij në vitin 1990 në Jugosllavi kishte rreth 100.000 të burgosur politikë. Duke patur parasysh dallimin për nga madhësia të të dy vendeve, Shqipëria, në këtë këndvështrim ishte e pakalueshme.

Këmbënguljen e tij të të qenit në vend të parë të Shqipërisë në këtë rang listë të palavdishme të krimeve politike Çapaliku e agumenton edhe me faktin se madje as informatorët nga terreni dhe as personat që shkruanin versionin e fundit të raportit për kreun e partisë nuk guxonin të përmendnin emrin e Enver Hoxhës madje as në kuadrin e citimit të asaj që i vëzhguari, armik i regjimit, kishte thënë. Deri në vdekjen e Enver Hoxhës në vitin 1985 në këto raporte ai përmendej si udhëheqësi, ndërsa pas vdekjes e deri në shpërbërjen e regjimit të tij si themeluesi i Partisë. Kësisoj Hoxha, pra, nuk e kishte mundësinë që, duke lexuar këto raporte, të argëtohej me formën burimore të barcoletave të krijuara për të.

I bindur se ka rrëfyer çudira që nuk kanë ekzistuar ndokund tjetër, Çapaliku citon emrat e qyteteve që u ka ngjitur regjimi i Hoxhës emra të rinj. Kam frikë se në këtë këndvështrim Shqipëria ka qënë e prapambetur në krahasim me Jugosllavinë. Madje edhe në këndvështrimin e emrave personalë nuk do të mundm të thonin se, përshembull, emri Marenglen (Marks, Engels, Lenin), të cilët viheshin në Shqipëri, është më i çuditshëm se emri Lems (Lenin, Engles, Marks, Stalin), të cilin e mban një ish mjek në Pula të cilin e njoh personalisht. Nuk ka nevojë të përmendim në mënyrë të veçantë se kam njohur disa persona me emrin Saveta, Sovjeta ose Sovjetka. Por që të gjithë këto ishin barcoleta të paqëllimshme të krijuara nga koha e hershme e komunizmit jugosllav. Hoxha në fund të viteve gjashtëdhjetë ndaloi besimin fetar dhe vënien e emrave tradicionalë të lidhura me fenë. Gjetja e një kopjeje të Biblës, libri lutjesh ose ikone në banesën e ndokujt ishte e mjaftueshme që i zoti i tyre të dënohej me burgim shumëvjeçar. Në Shqipëri kjo ndodhte kur pushteti jugosllav kishte inicuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Vatikanin. Ky proces, mes tjerash, do të rezultojë me lulëzimin e veprimtarisë botuese katolike me publikimin e përkthimit të plotë të Biblës në gjuhën kroate në vitin 1968, dhe do të kurorëzohej me vizitën e Titos te papa Pavli VI në vitin 1971. Përsëri duhen theksuar drejtimet e kundërta në zhvillimin e dy regjimeve: Ai i Hoxhës me kalimin e viteve bëhej më i ngurtë, ndërsa ai i Titos më i relaksuar.

Opsioni i vënies së emrave të rinj revolucionarësh rrugëve dhe shesheve i ka mundësuar barcoletëbërësve shqiptarë të krijojnë këtë barcoletë:

-Përse je nervoz?

-Se kam për një takim me një mikun tim.

-Bukur...

-Bukur, bukur, por nuk po mund ta kujtoj a thamë në orën tre në sheshin e Pesë Heronjve apo në orën pesë në Sheshin e Tre Heronjve.

Duke i mbetur besnik qëndrimit lokalpatriotik, Çapaliku përmend një sërë personash realë nga Shkodra që krijuan barcoleta për llogari të regjimit të Hoxhës. Një prej tyre është edhe Mark Bregu. Por, sipas asaj që tregon Çapaliku, kjo nuk është barcoletë e krijuar, por ngjarje e jetuar. Bregu kërkon takim te ministri i shëndetsisë për të kërkuar ndihmë për mjekimin e të birit. Ilaçi dhe terapia për këtë sëmundje nuk ishin të mundura në Shqipëri e kësisoj Bregu deshte t’i lutej ministrit që të birit t’i mundësohej mjekimi jashtë shtetit. Ja si e përshkruan Çapaliku takimin e Bregut me ministrin:

Ministri e dëgjoi dhe i tha se me shumë dëshirë do t’a kishte ndihmuar, por buxheti nuk e lejon një gjë të tillë; thjesht nuk ka para.

-Si është e mundur që nuk ka para? Çfarë është kjo politikë buxhetore? Kjo është e pamundur, - thirri Marku.

-Dëgjo, a mendon se e di më mirë se unë? Foli ministri me seriozitet.

-Natyrisht që ju e dini më mirë. Por unë di diçka tjetër: nëse atyre në Shkodër u them se shteti nuk ka para, do të më fusin në burg. Ja këtë di unë.

Për fat të keq, Çapaliku nuk na thotë asgjë për fatin e Mark Bregut. Ne nuk dimë nëse ai u përndoq pasiqë i’u përgjigj në atë mënyrë ministrit ose nëse e tregoi këtë histori në Shkodër. Apo mos ka zgjedhur me vëmendje se cilit t’ia tregonte që të mos arrinte në veshët e agjentëve të Sigurimit të Shtetit?

Çapaliku konstaton në mënyrë ironike se “komunizmi nuk ishte asgjë tjetër veçse rruga më e gjatë dhe më e dhimbshme për në kapitalizëm” (7). Por në Shqipëri, mendon ai, kjo rrugë ishte më e vështirë se askund tjetër. Ndërkohë e fyen shumë fakti se në një sërë studimesh mbi humorin e zi në shtetet komuniste Shqipëria është anashkaluar. Ai nënvizon se Ben Leëis, regjizori i njohur filmik dhe autor i librit të pakrahasueshëm *Hammer and Tickle. History of Communism Told Through Communist Jokes*, Shqipërinë dhe eksperiencën e saj të vuajtjeve nuk e ka përpunuar. Që ta ngushëlloj, mund të them se as Jugosllavia komuniste nuk është përpunuar në këtë libër. “Kam folur pak për barcoletatat në Jugosllavi sepse ishin identike me ato që tregoheshin në pjesën e mbetur të Europës komuniste” (Leëis 2008:11). Me këtë konstatim lakonik Leëisi pa dashje ka fyer krenarinë e atyre ish jugosllavëve që ishin të bindur se atdheu i tyre i atëhershëm – pushteti i të cilit i lejonte qytetarët t’u vinin fëmijëve emrat që dëshironin, të udhëtojnë jashtë shtetit dhe brenda vendit të argëtoheshin me kulturën popullore perëndimore – ndryshonte në gjithçka nga Bashkmi Sovjetik dhe vendet e bllokut Lindor, madje edhe në formën dhe përmbajtjen e barcoletave politike.

Por, Jugosllavia – në krahasim me Shqipërinë plotësisht të anashkaluar – në këtë libër gjithsesi ka qënë e pranishme dhe e përmendur. Leëisi ka biseduar me disidentin çekoslovak Jirij Gruntoran i cili i ka shpjeguar se çekët dhe sllovakët, pas invazionit sovjetik në muajin gusht të vitit 1968, nëpërmjet humorit kanë shprehur superioritetin e tyre intelektual ndaj okupatorëve. Sikur kjo të kishte ndodhur në ndonjë vend tjetër, përgjigja do të ishte ndryshe. Ndoshta jugosllavët do t’i kishin dhënë përparësi luftës, por ne këtu - ne atyre u treguam superioritetin tonë intelektual dhe asnjë plumb nuk e shkreh. Nuk e di nëse kjo është mirë apo keq, por unë kështu e shoh” (Leëis 2008:2203)

Jugosllavia pra, në sytë e ish disidentit çekoslovak ka ruajtur lavdinë e vjetër heroike të themeluar në lëvizjen nacional-çlirimtare më të madhe dhe më të organizuar në luftën që nga viti 1941 deri në vitin 1945 dhe te JO-ja historike e Titos drejtuar Stalinin në vitin 1948. Çekët dhe sllovakët në vitin 1968 vendosën të mos luftojnë me armë por me barcoleta. Ja edhe një shembull i këtij superioriteti intelektual të çekëve ndaj sovjetëve:

Përse e ndërtojmë socializmin? Sepse është më e lehtë se të punojmë.

Cili është armiku më i madh i socializmit? Pranvera, vera, vjeshta, dimri dhe imperializmi.

Kur do të realizohet socializmi në Çekoslovakinë? Kur secilit ai t’i vijë në maje të hundës.

Çapaliku e përmend Leëisin në kalim e sipër, por me antropologen australiane Shanoon Woodcock hyn në polemikë të hapur. Ajo në një përmbledhje ka publikuar studimin e saj për humorin shqiptar me titullin *Mungesa*

e barcoletave shqiptare mbi socializmin ose përse disa diktatura nuk janë qesharake. Këtë formulim Çapaliku e konsideron diçka që nuk ka ku shkon më qesharake. Woodcock ka qëndruar në Shqipëri nga vitit 2003 deri në vitin 2005 dhe ka biseduar me shumë shqiptarë dhe shqiptare. Sipas eksperiencës së saj, njerëzit tregonin barcoleta të bazuara në paragjykimet tradicionale mbi domethëniet rajonale (si puna e asaj se në Gjirokastrë njerëzit janë kopracë, ndërsa në Shkodër të prirur për shaka), për raportet mes muslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve, por jo për kohën e komunizmit. Ka dëgjuar barcoleta mbi politikanët aktualë, por jo për Enver Hoxhën. Këtë Çapaliku e ka komentuar kështu:

“Mund të them vetëm se bashkëpuntorët e saj shqiptarë, të të cilët është mbështetur kur ka grumbulluar materialin, janë përqëndruar vetëm te komunistët e betuar ose njerëz askushi ose qëndrimi i saj gjatë mbledhjes së kodeve dhe konteksteve të rrëfimeve komike ka qënë jo adekuat”. Akuzu drejtuar bashkëpuntorëve dhe bashkëpuntoresve të Shanon Woodcock është akoma më e rëndë sepse ajo ka cituar edhe emrat e atyre njëmbëdhjetëve, si dhe ka falenderuar gjithë pjeshtarët e diasporës shqiptare në Australi me të cilët është takuar rregullisht në restorantin Rozafa në Sidnej. Meqënëse në qarqet e emigrantëve dihet rregullisht se cili shkon në filan lokal dhe më cilin shoqërohet, akuzu e Çapalikut mund të shkaktojë shqetësim nëse ndonjë prej tyre e lexon këtë libër.

Woodcock ka vënë re se shqiptarët tregojnë po qejf barcoleta për Enver Hoxhën dhe komunizmin dhe në bazë të kësaj kaonkludon se ndoshta nuk ka patur barcoleta për llogari të pushtetit komunist në kohën që ai zgjaste. Çapaliku kundërshton këtë konkluzion të saj. Pikërisht me këtë libër ai përpigjet të përgjënështrojë tezën se shqiptarët nuk janë tallur me udhëheqësin komunist dhe qeverinë e tij. Për këtë ka shumë rëndësi për të të theksojë se pikërisht Shkodra ka qënë vatra e këtij produksioni ironik. Duke kundërshtuar atë që ka shkruar Woodcocku, Çapaliku përmend tre raporte të Sigurimit në të cilat kreu i partisë informohej mbi shpeshhtësinë e barcoletave kundër pushtetit. Por, ai me këtë nuk kundërshton eksperiencën e saj nga qëndrimi në Shqipëri nga viti 2003 deri në vitin 2005. Në ndryshim nga rumunët të cilët në kohën e qëndrimit te saj shumëvjeçar tregonin barcoleta mbi diktatorin komunist Çausheku, shqiptarët i kanë treguar pa dëshirë shaka për llogari të Enver Hoxhës.

Të bie në sy fakti se Çapaliku nuk e tregon përmbytjen dhe konkluzionet në të cilat ka arritur Woodcocku në studimin e saj. Ajo është përpjekur të shpjegojë shkaqet e mungesës së gatishmërisë për të treguar barcoleta nga koha e komunizmit në Shqipërinë postkomuniste. Meqënëse ai e dinte se Shkodra ka qënë vatër e numurit më të madh të barcoletave për llogari të pushtetit të Hoxhës, ajo është befasuuar për faktin se nuk ka marrë atë që ka kërkuar. Ja çfarë ka thënë për këtë:

“Gegët veriorë kanë qënë të përndjekur sistematikisht nga ana e regjimit të cilin në përgjithësi e drejtonin toskët. Për gegët ekzistojnë streotipe si më pak të zhvilluar, të rritur me kulturën tradicionale dhe ligjet e bashkësisë lokale, si më religjiozë (sepse janë katolikë) se muslimanët jugorë. Stereotipi për shkodranët si barcoletëbërës ka lidhje me konstruksionin e gegëve si armiq të më të dukshëm të regjimit dhe është interesante të vësh në dukje se pikërisht shqiptarët e moshës së mesme të rritur në Tiranë me kapital të madh social ishin ata që i thanë asaj se shumica e barcoletave ishin politike, dhe gjithmonë i theksonin se këto barcoleta ishin me prejardhje nga Shkodra, ka kërkuar jo vetëm skenarë shakash në Shkodër, por po ashtu ajo është dukur si tregim barcoletash antiregjim. Duke i'u përgjigjur lutjes time që të më dërgonte disa barcoleta, një mikeshë nga Tirana më dërgoi një barcoleta të krijuar në Shkodër dhe më shtoi se nuk e kuptonte përse miqtë e saj shkodranë tashmë nuk i tregonin. Kur pyeta miqtë e mij shkodranë, njëri m'u përgjigj: “Ne tregojmë barcoleta që të bëjnë për të qeshur, jo për Enver Hoxhën”. (Woodcock u Hamilton, Kelly, Minor, Noonan 2010:54).

Ja ajo barcoleta që zonjushës Woodcock i dërgoi mikeshja e saj nga Tirana, dhe për të cilën miqtë e saj shkodranë i thanë se nuk është për t'u qeshur. Duhet të sqarojmë se barcoleta ishte reaksion ndaj slloganit të Hoxhës se shqiptarët hanë edhe bar por armikut nuk i kërkojnë ndihmë: Një ditë zotëri Xhemal Dymylja, kryetar

bashkije i Shkodrës, pau një grumbull njerëzish që po hanin bar rreth përmendores së heronjve në sheshin qendror. U bërtiti: “Çfarë po bëni! Shoku Shehu do të vijë për vizitë te ne pas një jave, e ju hani barin! Ja secili nga 100 lekë dhe largohuni!” Një javë më vonë Shehu erdhi dhe kur pau njerëzit që kishin rënë në gjunjë dhe po hanin barin rreth përmendores u tha: “Shokë, javën tjetër do të vijë këtu Enver Hoxha! Ja secilit nga 500 lekë dhe ikni që këtu!”. Javën tjetër një veturë e zezë erdhi te sheshi dhe nga ajo doli Enver Hoxha. Duke vënë rë njerëzit që po hanin bar u tha: “Mos e hani gjithë barin sepse kemi një dimër të gjatë para nesh”.

Është e kuptueshme që kjo barcoletë konsiderohej antiregjim sepse tregonte se njerëzia ishin të detyruar tyë hanin bar për të mos vdekur urie. Por kjo barcoleta njëkohësisht tallet edhe me besnikët e regjimit si dhe me vetë udhëheqësin e madh. Ndoshta pikërisht për këtë në Shqipërinë postkomuniste nuk konsiderohej qesharak. Ndërsa, përshebull, në Jugosllavi, kjo barcoletë mund të lindte pas ndarjes me Stalinin në vitin 1948, kur vërtetë regjimi kishte në dispozicion pak ushqim dhe aleatë, Hoxha njerëzit e tij i ftoi të hanin bar në vitet shtatëdhjetë. Atëbotë atë JO-në e tij historike ua tha kinezëve, pasi që kishte hequr dorë nga Jugosllavia në vitin 1948 dhe Bashkimi Sovjetik në vitin 1961. Në kohën kur Jugosllavia begatonte duke gëzuar frytet e kulturës liberale, industrializimin e realizuar me sukses dhe sukseset ekonomike me vendet e Botës së Tretë, Shqipëria gjendej në prag të urisë. Ajo që për ish jugosllavët e fillimit të shekullit 21 ishte e kaluar e kahershme të cilën e mbanin mend dëshmitarë relativisht të pakët të asaj kohe, në Shqipëri në fillim të shekullit 21 shumica e aktorëve të këtyre ngjarjeve fatkeqe ishin ende gjallë dhe aktivë. Likujdimi i fundit i një pjesari të kreut shtetëror dhe partiak në Jugosllavi ishte vrasja e Andrija Hebrangut në vitin 1948, ndërsa Enver Hoxha urdhëroi likujdimin e kryeministrit të atëhershëm dhe bashkëputorit më të ngushtë në vitin 1981.

Duke gjurmuar për shpjegimet e faktit se në fillim të shekullit 21 shqiptarët nuk tregonin me qejf barcoleta për kohën e Enver Hoxhës, Shanon Woodcock e drejton gishtin te fakti se, edhe përkundër përpjekjeve të mëdha emancipatore të pushtetit komunist, lidhjet dhe raportet tradicionale mbetën të rrënjosura thellë në shoqërinë shqiptare. Meqënëse ndëshkimi i një pjesari të familjes si element armik të gjithë anëtarëve të familjes së tij u përcaktonte biografinë e tyre negative, e cila përcaktonte qënësishtëm shanset e tyre për fitimin e të drejtës për arsimim dhe mundësi për përparim profesional, shumë familje këmbëngulën që sëpaku njëri prej tyre të ishte në Parti në mënyrë që t'u siguronte mbrojtje. Ky fakt mund të jetë edhe shpjegim i pjesshëm i mosgatishmërisë së përgjithshme të shoqërisë

shqiptare postkomuniste për lustracionin sepse ky nënkuptonte përndjekje dhe ndëshkim të atyre që ndihmuan familjet e tyre për të evituar fatin më të keq në kohën e komunizmit. Për këtë ajo konkludon:

“Në Shqipëri, skena e identitetit të përbashkët shqiptar antiregjim nuk ka ekzistuar deri në vitin 1990. Liderët dhe burokratë socialistë kanë intensifikuar ndarjet tradicionale familjare dhe rajonale nëpërmjet institucioneve dhe kontrollit të lëvizjeve të popullit”

Përcaktues me rëndësi i identitetit shqiptar ishte nacionalizmi të cilin pushteti komunist e potenconte. Hoxha arri t'i imponohej tërë kombit si garanti i vetëm i mbijetesës së tij në mbrojtje nga armiq të jashtëm. “Hoxha nuk u bë qesharak pas vitit 1992 sepse njerëzit në përgjithësi e identifikonin me qëllimin e mbijetesës nacionale, që nxiste Enver Hoxha” (61). Mungesa e barcoletave për atë është pasojë e faktit se shqiptarët akoma mendojnë se mbijetesa e shtetit shqiptar është meritë e Enver Hoxhës dhe e politikave të tij sado që nga ato kishte shumë të pakënaqur në kohën kur këto politika zbatoheshin, mendon Sharoon Woodcock.

Ajo, në vitin 2010, nga janari deri në korrik, bëri kërkime ekstensive mbi gjendjen dhe presidepozicionin e shqiptarëve. Bëri shumë biseda me njerëzit, dhe rezultatet i'a paraqiti publikut në librin *Jeta dhe lufta. Mbijetesa e diktaturës në Shqipërinë komuniste*. Rezultatet e këtij kërkimi të dytë - megjithëse ai nuk orietohej për studimin e barcoletave nga koha e komunizmit – përputhen me këndvështrimet që kishte fituar gjatë kohës së qëndrimit të saj të parë në Shqipëri. Në hapësirën publike është e dukshme mungesa e përpunimit të rasteve të atyre njerëzve që kanë qënë të ballafaquar me përndjekjet dhe vetëdëshirën e pushtetit komunist. “Pjesë e madhe e problemit është se ‘secili e di’ se familjet kanë qënë të internuara me gjenerata të tëra, ndërsa shembujt më popullorë në publik, historitë që përsëriten në televizion dhe në mediat e shkruara, kanë të bëjnë ekskluzivisht me eksperiencat e fëmijëve adoleshentë të anëtarëve të Partisë që u ballafaquan me spastrimet ndërsa ishin në pozitat e fuqisë shtetërore apo shoqërore, dhe jo historitë e njerëzve të zakonshëm” (Woodcock 2016:143). Njerëzit që u rritën në vitet tetëdhjetë dhe të cilët regjimi i përndoqi, për shkak të përkatësisë së tyre në familjet e papërshtatshme, dëshmojnë ashpër dhe në mënyrë diskriminuese se pasardhësit direktë të përfaqësuesve të atij regjimi janë në pushtet edhe në Shqipërinë kapitaliste.

Woodcocku ka biseduar edhe me atë të cilët gjatë komunizmit kanë patur biografi pozitive dhe me atë biografia e të cilëve ka qënë negative. Nga të dyja palët ka marrë pohimin mbi atë se regjimi komunist ka shfrytëzuar ndasitë tradicionale në shoqëri duke i kundërvënë

kundër njëri tjetrit njerëzit nga grupimet e ndryshme. Vëmendje të veçantë ia kushtuar fateve të pakicave vllahe dhe rome që kanë qënë të diskriminuara në kohën e komunizmit, por ky diskriminim është rritur në kohën postkomuniste. Ka nënvizuar se nuk është për t'u lavdëruar pozita e grave të cilat, në kuadër të shpalljes së barazisë me burrat, kanë fituar mundësi dhe detyrime në kryerjen e punëve që deri atëherë kanë qënë të rezervuara për burrat, por nuk kanë qënë të liruara nga punët tradicionale të grave në familje. Kjo barazi, gjithsesi, nënkuptonte edhe përgjegjësi të njejtë sikurse e kishin edhe burrat, gjë që do të thoshte zbatim të të njejtave masave shtypëse në rastin e bërjes së gabimeve, tregimit të barcoletave kundër pushtetit ose dhënies së deklaratave të pavend në publik apo në rastin kur në grup kishte informatorë të sigurimit. Pozita e grave ka qënë akoma më e vështirë sepse aborti ishte i ndaluar ndërsa kondomët apo pilulat kontraceptive ishin të ndaluara, e me këtë rast është rënduar edhe promovimi i tyre shoqëror dhe profesional. Për hir të së vërtetës, duke theksuar këto aspekte pa asnjë dyshim negative të realitet komunist, Ëodcocku gjithsesi ka anashkaluar faktin se vetëm në Shqipërinë komuniste gratë e të gjitha besimeve fetare dhe të të gjitha moshave kanë fituar mundësinë që arsimimit dhe të marrjes se rolit, i cili, në kuadrin e lidhjeve dhe raporteve tradicionale ishte plotësisht i paaksesueshëm. Disa nga bashkëbisedueset e saj, të cilat kanë qënë të diskriminuara në kohën e regjimit të Hoxhës, gjithsesi kanë qënë mësuese ose inxhinjere me karriera të respektueshme për të cilat as nuk do të mund të ëndërronin sikur të jetonin në kohën e shoqërisë tradicionale shqiptare.

Edhe në këtë libër, si anash, ajo është marrë edhe me barcoletat. Njëra prej tyre fliste për informatorin i cili shkruante shumë denoncime e pikërisht për këtë përfundoi në burg. Atje e pyetën nëse kishte nevojë për ndonjë gjë, e ai u lut t'i jepnin letër dhe pendë. “Kjo barcoletë përbën përgjigjen më të mirë të cilën shqiptarët japin për pyetjen përse spiunët kallzonin: sepse kjo ishte gjithçka që mund të bënin për të treguar besnikërinë e tyre dhe tregonte edhe telashet në shtetin socialist” (150). Por ajo vazhdon të mendojë se gjithsesi barcoletat në Shqipëri tregoheshin rrallë: “Pikërisht, trauma e kontrollit të vazhdueshëm shtetëror dhe numuri i madh i informatorëve të paguar, i kombinuar me dënimet për tregim barcoletash deri në tetë vite burgim në përputhje me nenin 55 të Kodit Penal, dëshmon për atë se barcoletat tregoheshin rrallë, madje edhe mes miqve ose në familje”


Duke krahasuar me dënimin e njerëzve mbi atë sesi jetonin në kohën e komunizmit me ato që përshkruajnë gjendjen në Shqipërinë postkomuniste Woodcocku vjen të konkluzioni rrënues:

“Nëse përfaqësuesit e shtetit do të merreshin me padrejtësitë historike, atëherë, veprimtaria postsocialiste e të dy partive politike që kanë punuar për përfitimin e tyre dhe në dëm të shqiptarëve të zakonshëm për të cilët pohojnë se i përfaqësojnë po ashtu do të njihej se e padrejtë. Shumica e njerëzve që punojnë me përkushtim dhe kujdesen për fëmijët e tyre kanë qënë të shfrytëzuar dhe të trajtuar keq edhe nga qeveritë postkomuniste pikërisht si edhe nga regjimi socialist” (205)

Çapaliku, sikurse pamë më lart, eviton të merret me konkluzionet të cilat ka nxjerrë Woodcocku mbi bazën e studimit të saj mbi barcoletat mbi regjimin komunist në Shqipërinë postkomuniste. Po ashtu nuk ka komentuar as librin e publikuar gjashtë vjet më vonë mbi Shqipërinë postkomuniste në të cilën shumica e atyre të cilët në vitet tetëdhjetë i janë nënshtruar represionit ka përshtypjen se sot janë në pushtet trashëgimtarët e pushtetmbajtësve të dikurshëm komunistë dhe se padrejtësitë dhe raportet e vjetra ende vazhdojnë. A e pranon ai apo jo, Woodcocku në njëfarë mënyre ka vërtetuar saktësinë e shakasë që ai ka vënë si moto të librit të tij:

Cila ishte barecoleta e fundit e komunizmit? Tranzicioni politik shqiptar.

Çapaliku ka ndërmarrë një hap me rëndësi për afirmimin e temave të anashkaluara nga koha e Luftës së Ftohtë. Shqipëria është një prej këtyre temave, dhe në mënyrë të veçantë kapitulli mbi barcoletat mbi regjimin komunist. Tezën se këto barcoleta kanë ekzistuar dhe se pushteti ka përndjekur egërsisht ata që i kanë treguar, ai e ka plotësuar edhe me një përmbledhje interesante të barcoletave të cilat, në sajë të botimit në gjuhën angleze, janë të arritshme edhe për publikun lexues ndërkombëtar.



I

Që prej 40 vjetësh, kur u shfaq me botime shkencore në lëmë të gjuhës së autorëve tanë, e kupton se prof. Sh.Islamaj, ka synuar dhe ka arritur të bëjë objekt të punës së saj veprat e tre emrave më të shquar të letërsisë shqiptare: *i pari, Jakov Xoxa*, në shkrimtarinë e jashtëzakonshme të të cilit, ka zbuluar se në të parën sagë romanore të letërsisë sonë, e ka përdorur fjalën në ligjërimin e tij të shkruar për të karakterizuar aq bukur *një kohë Shqipërie* dhe një brez shqiptarësh, anën psikike të tyre dhe pasurinë shpirtërore në periudha dramatike të jetës, nëpërmjet shprehjeve popullore dhe frazeologjisë, artit të gjuhës; *i dyti*, Gj.Fishta, që thuri ode dhe epope të pavdekshme për historinë kombëtare në një periudhë të luftës për ekzistencë të tyre, duke i kënduar lavdisë së gjuhës shqipe e popullit të tij, që po bënte Shqipërinë dhe do të bëhej shpejt edhe vetë; ndërsa *i tretë*, akademiku Qosja, shkrimtar dhe studiues i thellë i letërsisë sonë, që e ka çmuar fjalën e lashtë shqipe, sepse ajo është treguar *më e fuqishme sesa kërcënimet që i janë bërë gjatë shekujsh*, edhe sepse *Gjuha, në të vërtetë, është pasuria jonë më e madhe*.¹

Gjuhën e këtij shkrimtari e studiuesi, akademiku dhe mjeshtri të vërtetë të letërsisë, merr të studiojë prof. Islamaj kësaj radhe, pasi ka kaluar në filtrin e analizës stilistike veprat e Xoxes dhe Gjergj Fishtës. Dhe do ta bëjë këtë pasi vetë R. Qosja ka realizuar para shumë viteve *Profile shkrimtarësh*: nga De Rada e Naimi, nga Mjeda e Noli, nga Hivzi Sulejmani, Nonda Bulka e Esad Mekuli.² Idhtare dhe perudhëse e teorisë stilistike të trajtuar për herë të parë në gjuhësinë tonë nga Xh. Lloshi, Sh. Islamaj ka përvetësuar analizat dhe vështirësitë stilistike koherente për autorë e vepra artistike të shkrimtarëve tanë të shquar, veçse, me monografinë **“Ligjërimi, Gjuha dhe Stili”** në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes – ajo ka realizuar një studim të pazakontë, tej gjerësisë dhe përmasave që jemi mësuar të shohim në kërkimet e fushës këta vitet e fundit.

II. Struktura e veprës

Struktura e veprës së autores sonë, dallohet si në vështirimin didaktik, ashtu edhe në thellësinë e paraqitjes, në atë masë sa monografitë e prof. Islamaj, krejt lehtë mund t’i përfshijmë në programe mësimore, përndryshe, në ato pasuniversitare të *Masterit shkencor*, sepse ato janë tekste të gatshme mësimore për lektorim. Kështu, do të na shërbente *Gjuha e Jakov Xoxes* dhe monografia e gjerë për *Gjuhen e stilit e Gj. Fishtës*, në dy vëllime. Në këtë mënyrë, ajo ia del të ndërtojë një stilistikë të veprave të Rexhep Qosjes. Për çdo 10-12 vjet ajo na ka dhuruar punime që, deri më sot, di t’i bëjë vetëm ajo për autorë të tillë e në përmasa si këto, për shkrimtarë që janë në maje të letërsisë shqiptare; prandaj dhe themi se autorja synon e i ngjit këto maja të artit letrar, me aq pasuri gjuhe e stili për t’u admiruar e marrë shembull nga krijuesit e brezave më të rinj, të çfarëdo shkolle të pretenduar prej tyre...

Nuk mund të lihet pa u pohuar se vepra që kemi sot në dorë prej profesores Shefkije ka një bibliografi të pasur, që i përgjigjet fushës dhe argumentit të trajtuar, një mbështetje burimore teorike, që pothuajse vjen e barazohet me emra studiuesish dhe vepra të vjela nga gjuhëtarë vendës dhe të huaj, në raportin 75 me 75. Midis tyre 13 vepra janë të autores sonë, e cila ka krijuar bibliotekën e saj me tituj studimesh në lëmë të gjuhës e stilit të shkrimtarëve.

1 Xhevat Lloshi, Shqipja qysh u është dukur? Sa e ëmbël, sa e bukur! albas, Tiranë, 2016, f. 101.

2 Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri, Tiranë, 1988.

SHEFKIJE ISLAMAJ – STUDIUESJA QË NDJEK MAJAT E ARTIT TË GJUHËS

Nga Tefë Topalli



Bien në sy nga bibliografia, si autorë të njohur perëndimorë të traditës, ashtu edhe më modernët, të shquar në linguistikën e përgjithshme dhe në fushën speciale siç është stilistika, ligjërimi, oratoria, teksti, figurshmëria etj.; por një pjesë e mirë janë edhe studiues nga bota sllave, për të cilët, mund të themi, kanë qenë e janë të privilegjuar studiuesit kosovarë, për shkak të përvetësimit të gjuhës serbo-kroate, që kanë pasur si gjuhë të parë e të dytë në arsimin e shkollave të tyre. Kujtojmë me kolegë të mi, para shumë vitesh, kur prof. Kostallari, rekomandonte që, për provimin pasuniversitar të *Gjuhësisë së përgjithshme* (ai ishte lektori i parë i kësaj discipline universitare për shumë vite), na rekomandonte të lexonim vepra linguistike që në Prishtinë, ishin përkthyer e botuar nga profesorët e atjeshëm, si b.f. akademiken serbe Milika Ivić (1923-2011), për veprën e saj në dy vëllime *“Pravci u lingvistic”* I, II. Kjo ka ndihmuar mjaft për atë brez studiuesish të viteve 1970-1990. Dua të them jo pak autorë të bibliografisë së kësaj vepre, na vijnë të cituara prej autores, të përkthyer nga gjuha serbokroate. E mendoj se ky është një përfitim plus për lexuesit e hulumtuesit e këtij lëmi studimor.

Në monografinë e gjerë njihemi me prurje të reja të studimit të kësaj fushe, si për shembull “Ligjërimi emocional”,³ të cilat na vijnë si trajtesa që, në këtë masë shtjellimi, janë për herë të parë në studimet tona albanologjike; dhe kjo realizohet vetëm me një vepër artistike, nëpërmjet romanit “Nata është dita jonë”- vështuar në kontekstin morfosintaksor. Ajo e ka gjetur këtë roman si *gjedhe më se të përshtatshme për analiza të ndryshme letrare, diskursive, poetike e sidomos gjuhësore stilistike për të zbuluar se ç’tipare moderne e postmoderne e karakterizojnë këtë vepër letrare artistike të R. Qosjes, në të vërtetë për të kuptuar ç’risi dhe ç’strategji eksperimentuese shfrytëzon autori në narracionin e tij*.⁴ Përveç romanit të akademikut Qosja, vjen e shpaloset mendimi i Xhozef Konradit, në parathënien e veprës së tij “Zezaku nga anija Narcis”; ajo shpjegon se në shkrimtarinë e R. Qosjes, emocionaliteti arrihet *me anë të përsëritjes* në rrafsh leksiku e sintakse (shoqëruar me shembuj), duke mënjeluar qëllimshëm rrjedhën kronologjike të ngjarjeve, zë fill intimiteti i lexuesit me narratorin

3 Shefkije Islamaj, Ligjërimi, Gjuha dhe Stili – Në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2021, f. 454-495.

4 Po ajo, po aty, f. 455.

e personazhin kryesor, pohon autorja, duke krijuar një përzierje të ligjërimin të drejtë e të zhdrejtë, si një analogji me romanet e Xhojsit dhe Folknerit. Romani “Nata është dita jonë”, roman pa fabul, vjen larg kanoneve të traditës, me shtesa ndërtektore, dhe *shtresa ndërtektore* etj. E gjithë kjo e ka bazën tek *pasuria e gjuhës shqipe, me njësi gjuhësore: fjalë, shprehje e ndërtime që shprehin gjendje nga më të ndryshmet emocionale, me variacionet e ngjyresat e tyre të shumta*....⁵

Me shumë interes janë sythet që shtjellon autorja për njohuritë e lidhura me emocionet si kategori semantike e psikike dhe ligjërimin emocional, që aktualizohet në dy kodet: *verbal* dhe *jo verbal*. Ky roman, sipas gjuhëtares, jep mundësi të vështrohet natyra poetike e tij, njëherësh edhe nyjetimi i ligjërimin emocional: *me anë të përsëritjes, ndërtimeve me parataksë, rendit të mjeteve shprehëse, intonacionit thirrmos, tonit të ngritur, anasjelles* etj. Veçori të tjera shfaqen për dukuri të rendit: *prapavendosjet, tejvendosjet, degëzimet fjalësore, me shumë shenja pikësimi* (që përbëjnë pauzat e masave të ndryshme); *copëzimi, ritmizimi dhe shtimi a përforcimi i emocionalitetit të shprehjes*, me ndikim në tekstin e narratorit, shndërruar në *narracion të theksueshëm lirik, subjektiv e të poetizuar*. Nënvizohet gjithashtu se përbërësit e stilit të Qosjes shfaqin *afërsi me poezinë e parimet e ndërtimit të saj*. Në pasurinë gjuhësore të romanit pohohet se ka ndërtime të ndryshme fjalësore: me frazema të karakterit proverbial, aforistik, gnomik burimesh e tipash të ndryshëm, shpesh, edhe me ndërhyrje të autorit: modifikime e zgjerime strukturore e kuptimore. Të gjitha këto prurje terminologjike e konceptuale, autorja na i shoqëron me shembuj të shumtë e të plotë nga kontekste të ndryshme, të cilat dëshmojnë se *ligjërimi emocional* në prozën e R. Qosjes, nuk mund të studiohet njësoj si në një kontekst jo letrar, sepse ka një ndryshim midis *njohjes racionale* dhe *asaj afektive*. Ky emocionalitet, sipas autores sonë, ndjehet edhe në përdorimin e *fjalëzave*, ku përfshihen pjesëzat, të pasura në llojin e tyre (*dëftuese, përcaktuese, saktësuese, shtuese, veçuese, përafruese, modale: mohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse, apo pjesëzave emocionale-shprehëse* (f.473); vihet në dukje, gjithashtu, edhe roli i *pasthirrmeve* në prozën letrare të R. Qosjes, si dhe aktualizimi i një tipi ligjërimi (për romanin “Nata është...”), prej të cilit përftohen shprehje *sugjeruese, lutëse, urdhëruese*,

5 Po ajo, po aty, f. 456.

kërcënuese, qortuese, arsyetuese, përcmuese, tallëse, mohuese; brenda kësaj vepre me strategji komunikuese *urrejtjen, së cilës i bashkëngjiten: zemërimi, frika, zhgënjimi – si emocione shtesë*. Me një vështrim të thelluar nga studimet e derisotme, na vjen trajtimi i *Ligjërimin emocional dhe subjektiviteti i përemrave vetorë* (f.483 e vijim), nisur me aksiomën e gjuhëtarit frëng E. Benvenist “Përemri *unë* është ai që thotë *unë*, vetëdija për veten është e mundshme vetëm nëse provohet në kundërvënien midis *unë* dhe *ti*” dhe më tej, përemri *unë* është zëri i autorit, i narratorit ose i folësit”.⁶ Jepet në këtë syth edhe raporti midis ligjërimeve të drejtpërdrejta e të zhdrejta me *individualitetin subjektiv të personazheve*.

Jemi tërhequr në mënyrë të veçantë nga **Pjesa V** e monografisë së autores për prurjet koherente që sillen lidhur me *Figurshmërinë dhe teknikën postmoderne* (f.601), në vijim *Shumësia kuptimore dhe estetike e metaforave* (f.603), me studimin e thuktë të këtij tropi dhe raportet me vdekjen e katër grupet e që emërtohen: *konceptuale; të ndijimeve, metaforave që shprehin marrëdhënien hapësinore, orientuese, kohore, objektore; ato që shprehin rrjedhoja fizike të vdekjes*, ku gjen vend e zbardh mendimin e John L. Austin, në veprën *Kako djelovati rijeçima* (f.623), krahas interpretimit të George Lakoff e Mark Johnson - edhe këta në vepra të përkthyer në serbokroatisht; pa lënë jashtë citime prej studiueses e përkthyeses së njohur F. Papeleka, nga vepra e saj “Rexhep Qosja: bisedë e pambaruar” “OM”, Prishtinë, 2018, f. 375. Përgjatë prozës së akademikut Qosja, njihemi me përcaktimet e shumta që gjuhëtarja jonë i bën vdekjes, nisë nga çifti antonimik: *Vdekja-terr, jeta-ditë; Vdekja-e zezë, e flohtë, e lagësht, e frikshme; Vdekja-poshtë; Vdekja- domosdoshmëri; Vdekja-dënim; Vdekja-pafuqi e njeriut; Vdekja-padrejtësi; Vdekja nuk është vetmi; Vdekja-frikë/ dhembje; jeta përcakton vdekjen; vdekja-gjymëjetë; Vdekja-bashkëshoqëruese; Vdekja-dhë; Vdekja-heshtje; Vdekja (varri)-page, qetësi, drejtësi, e vërtetë; vdekja-luftë me jetën; Vdekja-ndarje/bashkim; Vdekja-bukuri; Vdekja-dashuri; Vdekja-pavdekësi; Vdekja – fuqi*.

Janë shumë të goditura segmentet ku trajtohen: Stilematika e krahasimit (f.638) dhe llojet e shumta të krahasimit (f. 648): *i thjeshtë, i zgjeruar, krahasimet e zhvilluara, ai argumentues, stolisës, si dhe krahasime konkrete, të njohura të ligjërimin popullor*. Njihemi këtu edhe me trajtimin që i kanë bërë kësaj figure Keneth Burke dhe Zdenko Lesić, në librat përkatës të tyre. Të kësaj natyre-shterruese- në planin e stilit të prozës së Qosjes, na duket shtjellimi që autorja u bën “Vlerave stilistike të përsëritjes” (f.666), të cilat dalin në shkrimtarinë e autorit të *Ditareve* me aq vlera, më tepër në *ligjërimin spontan* (përcakton gjuhëtarja) nëpërmjet mjeteve të tilla, si: *epifora, anadiploza, apostrofi, paralelizmi sintaksor* (me dy dhe tre ndërtime paralele) – të gjitha që ia shtojnë *stillogjenitetin* tekstit të shkrimtarit. Në prozën e romaneve që bën objekt hulumtimi, ajo ka gjetur edhe paralelizma sintaksorë *në kontakt e jo në kontakt*, si dhe dallon *përsëritjen në krye të paragrafëve*-vështuar njëri pas tjetrit. Këtu mësojmë për figurën retorike të *poliptotonit*⁷ për herë të parë përgjatë kësaj analize, krahas përsëritjes tjetër, quajtur *paragmenoni*,⁸ ashtu se si duhet të udhëhiqemi kur regjistrujmë rastet ku këto përsëritje dalin njëherësh me një të tretë, siç është epanalepsa. Dhe për këto, shprehet autorja, *figurat e përsëritjes, posë si fije lidhëse ndihmojnë sidomos të veçohen e të shquhen detajet, për të cilat Rexhep Qosja është mjeshtër i pakalueshëm*.... kjo e afron

6 Po ajo, po aty, f. 483-484.

7 poliptotoni – figurë retorike që realizohet me përsëritjen e fjaëve të njëjta, por në rase të ndryshme e me funksione të ndryshme sintaksore.

8 paragmenoni – përsëritja e fjalëve të afërta nga ana etimologjike (shpjegon vetë autorja)

*prozën e romaneve të tij, shpesh, me poezinë lirike.*⁹

Në këtë nivel të lartë njohjeje na sillet sythi “Epiteti dhe shumëllojshmëria e tij”(f. 686-708), ku shkrimtari ynë i shquar, edhe pa qenë një parnasion i vërtetë, i sjell atiributet me shumë mjeshtëri e me vend në të gjitha farët e tyre.....Te *ironia* do të ndalemi tani, te ky trop e kjo figurë, siç quhet ky term, nga gr. *eironeia*- shndërrim, përqeshje - e trajtuar në rend të parë në 5 romanet, novelën e dramat e R. Qosjes, vepra që kërkojnë lexim paralel: *të tekstit përballë kontekstit* , si vëren A. Apolloni. Me stilin e përsëritjeve të prozës së Qosjes, autorja e kësaj monografie jo të zakonshme, karakterizon: “*Prandaj, ironia e Rexhep Qosjes, është jo vetëm e shumëkuptimshme dhe e shumëllojshme, por edhe shumëdrejtimshe e shumëaspektore.*”¹⁰Studiuesit më të njohur të kësaj figure stili, shkruan ajo, janë Linda Hurcheon, Ernst Behler, D.C. Muecke, Richard Rorty dhe R. Jakobson. “*Fuqia e ironisë së Qosjes, nënvizohet këtu, lëviz prej shkallës më të ulët e deri te shkalla më e lartë e ngarkesës emocionale.*”¹¹ Pasi na njeh me 8 veçoritë e këtij tropi në prozën e Qosjes, autorja trajton me shembuj konceptet *Ironia dhe semantika, Ironia dhe estetika* (si strategji narrative), ku mësojmë, në planin teorik, se ironia është ironi kur merr disa cilësi të veçanta- çelës, si:

a). *të përbëhet prej dy shtresave ose dy rrëfimeve;*

b). *të ketë praninë e kundërvënies së dy shtresave: kontradiktore, mospërputhëse e të papajtueshme;*

c). *të karakterizohet me një si pafajësi, sipas së cilës “viktima e ironisë nuk është e vetëdijshme ose ironisti shtiret se ajo nuk është e vetëdijshme”*-. Muecke-u e quan *papërgjegjshmëri e përgjegjshme e shkrimtarit*”.¹² (Kush Akxhiu ishte edhe ***Kush*** edhe ***kurrkush***, ishte: njeriu që sot ishte ***i këtillë***, nesër ishte ***i atillë*** e pasnesër ***i këtillë*** dhe ***i atillë***, prandaj: Në Varre u soll si atdhetar e u varros si hafije!), f. 714. Te *Funksionet e ironisë* kuptojmë se ky trop, si figurë gjuhësore, përdoret në dy kuptime: *në kuptim të gjerë-kur fjala e caktuar shpreh kuptim të kundërt nga kuptimi i saj tekstual, i fjalëpërfjalshëm, dhe në kuptim të ngushtë kur fjala a shprehja gjuhësore ka karakter shpotitës, përçmues*. Në raste të tilla dalin edhe figura trope, aforizma, frazeologji etj.¹³ Kurse, në *Veçoritë tipologjike* të prozës së Qosjes, ironia del e *thjeshtë* dhe e *dyfishtë* (si kundërshtuese dhe korrigjuese), apo edhe *ironinë verbale* – si ironi të fjalës dhe *ironi situatore* (me situata ironike), pasazhe që autorja i mbush me shembulla përkatëse. Përimtimi që i bën kësaj figure autorja, shkon më tej në klasifikim, me terma si këto: *ironi e hapur, ironi e fshehur, ironi private* – të cilësuara në tregues: *jopersonale, vetëvlerësuese, e mprehtë* dhe *e dramatizuar*. Për të gjitha këto lloje të figurshme mbështeten me fragmente nga proza e shkrimtarit. Modele ironie tjera ka dalluar prof. Islamaj në romanet e R. Qosjes, siç janë: *e veçanta* dhe ajo *e përgjithshme*, pas shembullzimeve të të cilave, janë zbuluar disa situata të ndryshme, ku shquhen: *paradoksi, ku e pamundshmja bëhet e mundshme; ana e shëmtuar e jetës: dehumanizmi, dhuna, varfëria, gëzimet, dhembjet etj.; shpalosje e marrëdhënieve burrë-grua; ndërtim i situatave shokuese e befasuese; paraqitje e pamjeve natyraliste e surrealiste dhe bota e brendshme e individit*. Për të veçantat e ironisë në veprat e Qosjes, autorja thekson se *ajo nuk mund të kuptohet dhe interpretohet sa e si duhet, pa njohur veçoritë e hapësirës, të kohës, kontekstit*

*politik, shoqëror dhe kulturor, historinë shqiptare, të vjetrën dhe të renë.....; ironia e tij sjell edhe frymën e ironisë së shekujve pararendës, sepse ai e njeh mirë trashëgiminë e pasur kulturore të njerëzimit në shekuj.*¹⁴

Para monografisë së prof. Islamaj, nëse ke menduar se di shumë për tropin e ironisë, pas leximit të saj, ke për të mësuar se etërit e studimit të kësaj figure duhen kërkuar tek helenët e lashtë: nga Sokrati, Platoni e Aristoteli; më vonë tek shkrimtarë e filozofë, si: Shlegeli, Kierkegard, Tomas Mani, Kafka, Llucaçi, Sartri, Adorno e Rorti- të gjithë këta, sipas autores,*janë mësuesit më të denjë të shkrimtarit erudit Rexhep Qosja.* (f.726)

Dhe, për ta kuptuar këtë ironi në prozën e shkrimtarit, duhet ditur më parë se *Ironia është figurë dhe mjet stilistik*; pra, shtrohet çështja cilat janë rrafshet kryesore ku realizohet ironia e tij; e ato i gjejmë të renditura në librin që kemi përpara: *ligjërimi i rrëfimitarit, monologët dhe dialogët e personazheve, komunikimi zytar, shkresat zyrtare, teksti me tematikë politike, shkencore, letrare, letrat, miniesetë, kujtimet, ëndrrat.*¹⁵ Në shembujt e shumtë që janë vjelë nga autorja, dalin në pah rastet kur ironia kthehet në sarkazëm, në ironi sarkastike, përzier edhe me satirën; kur sarkazmi shquan gjendjen emocionale të atij që i drejtohemì, *për ta nënçmuar, lënduar me leksik ironizues, përçmues e me vulgarizma*. I thuhet lexuesit se ka edhe grupime të tjera të kësaj figure letrare, por ajo ndalet kryesisht tek *ironia tragjike, ironia dramatike dhe ironia sarkastike*, nëpërmjet shembujve të shumtë duke e karakterizuar secilën në dallimet e afritë mes tyre. Mbyllet ky segment i monografisë me mjetet që shfrytëzohen në prozën e R.Qosjes, e ato janë: *mjete paragjuhësore* (mjete kinezike, toni e intonacioni, pauza sipas shenjave të pikësimit); *mjete gjuhësore-stilisitike* (njësi të leksikut, neologizma, arkaizma, vulgarizma etj.); *mjete gramatikore e morfologjike* (*fjalë emocionale shprehëse, onomatopetë, pezhorativët, pasthirrmat*) etj. Ndërsa, si forma kryesore për shprehjen e ironisë, autori i romaneve, përdor: *gjuhën ezopike, aluzionin, alegorinë, perifrazën, parabolat, antitezën, citatet, simbolin, krahasimet dhe përshkrimin në formë skicash.*¹⁶


III. Niveli i Sintaksës....

.....zë pjesën II të studimit të autores sonë, që nis me një citim të F. Konicës, ku cilësitë e gjuhës shqipe përtakohen e shtrihen në një me ato të popullit që e flet. Në fillim jepen disa veçori të përgjithshme për rrafshin e stilit brenda kësaj disipline, ku proza e shkrimtarit vjen e karakterizohet nga *saktësia, qartësia dhe ngjeshja semantike*, nën kriterin e shmangies, sipas parimit *të zgjerimit, rrëgjimit, zëvendësimit*

14 Po ajo, po aty, f. 726-727.

15 Po ajo, po aty, f. 728.

16 Po ajo, po aty, f. 738.



e tejvendosijes. Për dukurinë e *kumulimit* (grumbullimit) – sipas Rikard Simeonit – jepet shpjegimi se është grumbullim, kur përdoren më shumë shprehje të ngjashme për të paraqitur një mendim.¹⁷ Kjo realizohet me *fjalë e sintagma emërtuese, sinonime leksikore, sinonime sintagmatike, sinonime leksikore-sintagmatike, si dhe sinonime sintaksore*. (f.172) herë-herë, me këto dalin *blloqe leksikore*, bashkuar në fushë semantike, të përbëra prej emrash, foljeve dhe mbiemrave. Rexhep Qosja shquhet për veshjen e tekstit letrar me shprehësi e emocionalitet; ndër figura ai i vë rëndësi *përsëritjes me ndërtime sintaksore antonimike, fjalë sinonime, sintagma, frazema metaforike*, ku bien në sy *fjalët bosht, referentët*; grumbullime dalin edhe në fjali brenda periudhës (frazës), për të ndërtuar *tablo, pamje, situata ndodhi, gjendje të zakonshme e të pazakonshme*: të dendura, me *sekuenca veprimi*, të ngadalshme apo të vrullshme. Ana tjetër e grumbullimeve shkon tek gjymtyrët funksionale të fjalisë, nisur nga *predikatet që dinamizojnë ngjarjet e veprimin e fabulës romanore*; grumbullimi stilistik ngjet edhe me anë të *klasës së lidhëzave*, ashtu si, për variacione letrare, autori sjell edhe *grumbullime jolidhëzore*: me numërim, me shkallëzim, sodomos për *kryefjalët, kallëzuesit, kundrinat përcaktorët dhe plotësit e rrethanës*. Grumbullimi i emrave, në prozën e këtij autori, me semantikë të ndryshme, çon në *sinatroizëm* (kur me anë emrash grumbullohen veçori a hollësi në funksion të ngjyrimit emocional), pa përjashtuar edhe funksionin e *ironizimit e satirës*. Edhe foljet, sipas autores sonë, janë stilogjene, kur vijnë e grumbullohen në një tekst a segment të tij, edhe sintagmat foljore po ashtu.

Brenda rrafshit të sintaksës, autorja e ndjek kërkimin në prozën e R. Qosjes dhe zbulon Stilistikën e ngjyresave – shkallëzimin (f.186), ku njihemi me koncepte të tilla, si: *vargu shkallëzues, efektet ligjërimore* të tij, *zgjerimi kuptimor* – deri edhe tek përkufizimi i perifrazuar që jepet: “*shkallëzimi është kalim prej një shkalle në tjetrën, me rritje apo zbritje të shkallëzaur;*¹⁸ bazuar kjo paraqitje tek aurorë të huaj: Bratoljub Klaić, Zdenko Škreb, Rikard Simeon, Osvald Dykro, Cvetan Todorov dhe në prurjet e vetë autores. Gjatë këtij shtjellimi, mësojmë përimtimet e tipologjisë së shkallëzimeve, të grupuara sipas përbërjes dhe efektit stilistik, si: *shkallëzimi logjik, emocional, sasior*, dhënë nga gjuhëtarja Marina Katnic-Bakarčić; *shkallëzimi semantik- stilistik, shkallëzim leksikor, sintaksor, i përzier, tekstor-* që realizohet në rrafshe të ndryshme gjuhësore, sidomos në hapësirën e paragrafeve, kur renditen edhe katër shkallëzime njëherësh: nga *fjala, sintagma, fjalia* dhe *teksti*. Në monografi përcaktohen edhe raportet e shkallëzimeve

17 Po ajo, po aty, f. 168.

18 Po ajo, po aty, f. 186.



me: *hiperbolën* (më të dendura dhe më me afekt), *me antoniminë, me sinoniminë, lidhjet “shkallëzim-grumbullim dhe zmadhim”, shkallëzimi dhe krahasimi, shkallëzimi dhe përsëritja; shkallëzimi tekstori me konektorë* – me funksion lidhës dhe vetë *shkallëzimi quhet figurë intensifikimi, përforcimi a intenssiteti, që realizohet me mjete të veçanta sintaksore, shkallëzimi leksikor dhe stilistik me konektorë... Teksti*

letrar i Rexhep Qosjes ofron numër të madh variacionesh të gjedhes kryesore të shkallëzimit, përfundon prof. Islamaj në këtë segment stili për prozën e shkrimtarit Qosja.¹⁹ Edhe problemet e *Anasjellës* lidhen me sintaksën nëpërmjet rendit sintaksor, një shtjellim i plotë nga ana e gjuhëtares, ku lexuesi i interesuar ka çfarë të gjejë si nga ana teorike, ashtu edhe nga lënda e përzgjedhur në shkrimtarinë e R. Qoses. Tek hapësira e sintaksës duhet përfshirë edhe sythi *Fjalitë nistore dhe fjalitë fundore* (f 398-413), në të cilën studiuesja *trajton strukturat e fjalive nistore dhe atyre fundore të 5 romaneve të tij*, një vështrim që autorja e lidh me *përjetimin stilistik*, duke i quajtur *nyja të rëndësishme për strukturën poetike të romaneve të tij*.²⁰ Këtu do të gjejmë një shtjellim të gjerë për këto fjali, në dy këto pozicione, dhe ndërtimi i tyre, sillet pranë shembujve të shumtë, fraza me shumë fjali, që *u hapin rrugë fjalive në vijim*, më së shumti njësi predikative vendore, kohore; ndërsa për *fjalitë fundore* theksohet se janë *të shkurta, të thjeshta dhe japin kuptime përmbyllëse*. Me anë të shembujve të shumtë, të vendosura pranë e pranë, për krahasim, autorja bën dallimet mes këtyre njësive kallëzuesore, si: karakteri i tyre *shpjegues, informues, përshkrues* (për nistoret); kurse *fjalitë fundore* dalin si përmbyllëse të tekstit paraprak, japin edhe përsëritje kuptimore të segmenteve paraprijëse. Funksioni poetik i gjuhës artistike të shkrimtarit Qosja, sipas autores, del në pah si për fjalitë nistore, ashtu edhe për ato fundore. Edhe në këtë vështrim sintaksor, studiuesja e njohur e kësaj fushe, nxjerr përfundime të pjekura për prozën romanore të autorit: “*Me shkurtinë e ngjeshjen semantike të këtyre fjalive, shkrimtari dëshmon se di të rrëfejë shkurt, fare shkurt, dhe të thotë shumë.*”²¹

Natyrrshëm që në kufijtë e këtij përshkrimi të monografisë së Sh. Islamajt nuk mund të sjellim shembuj të plotë, me të cilët do të kuptoheshin më mirë nga lexuesi i kësaj disipline risitë dhe prurjet e autores, por themi me bindje që, për veprat e gjuhën e stilin e shkrimtarëve që ka hartuar deri më sot kjo gjuhëtare, do të duhej një libër për secilën monografi, kushtuar shkrimtarëve të majave të letërsisë sonë: nga Xoxa, Fishta dhe Qosja.

Me këtë monografi, prof. Shefkije Islamaj ka dhënë një model të shkëlqyer të hartimit të një vepre shkencore, duke treguar edhe një përshkallëzim të punës së saj kërkimore për gjuhën e stilin e shkrimtarëve, një realizim që e rendit atë ndër albanologët më prodhimtarë në studimet e sotme akademike, në Tiranë e Prishtinë. Me aq meritë e sjell në vëmendje punën e saj prof.. Xh.Lloshi, kur shkruan: “*Profesore Shefkije Islamaj ka një numër aq të pasur ndihmesash në fushën e stilistikës së shqipes; ajo është sot studiuesja më e shquar e kësaj disipline. Mjafton për këtë të shihen vetëm librat, artikujt dhe recensionet që ka botuar, të cilat qoftë nga numri, janë më shumë sesa të çdo autori tjetër në këta dhjetëvjeçarë.*”²²

Tiranë, 30 korrik 2024

9 Shefkije Islamaj, Ligjërimi, Gjuha dhe Stili – Në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2021, f. 684.

10 Po ajo, po aty, f. 710.

11 Po ajo, po aty, f. 710.

12 Po ajo, po aty, f. 714.

13 Po ajo, po aty, f. 715.

19 Po ajo, po aty, f. 213.

20 Po ajo, po aty, f. 400.

21 Po ajo, po aty, f. 410.

22 Instituti Albanologjik, Portreti intelektual, shkencor dhe letrar, Prishtinë, 2019: Xhevat Lloshi, “Studiuesja e shquar e stilistikës së shqipes”, f. 49 – 60.



ESMERALDA SHPATA

Atëherë, kur dinim të duheshim

tregim

Më në fund, arrita t'ia tërheq vëmendjen pas disa muajsh të rrëmuishëm e të lodhshëm kiamet. Tani e meritoj të marr ca ditë pushim, mendova me vete. Gjithë ajo qëndresë e kaloi testin, ia vlen të qetësohem disi e ta lë vajzën të presë me padurim hapin tim final. Kjo është fatura që më detyrohet, shto dhe dy palë këpucë që i bëra copë duke ndjekur atë.

Ia kuptova dëshirën e padurimin në sy. Kjo më pëlqeu dhe më bindi të nisesha i qetë në qytezën e vogël turistike. Sapo mbërrita në shtëpinë e lyer me gëlqere në rrëzë të kodrës, nxora nga çanta rrobat sportive, veshja një palë këpucë të lehta dhe mora rrugën për te kodrat. Ishte në të dalë të tetorit, por ende dreka të përvëlonte nga vapa. Shkurret më kanë tërhequr gjithmonë për harlisjen e degëve, dendësinë e gjetheve dhe frutat e egra e të panjohura për mua. Vendi nga isha unë, kishte vetëm thana, arra e gurë. U bëra njëzet vjeç pa pashë për herë të parë gjethet e fikut, kokrrat i kisha provuar nga reçeli që shitej në shitoren tonë.

Me këto gjëra në mendje dhe me kokrrat e zeza që nuk po i dalloja dot në ishin kulumbri apo boronicë, u shkëmbeva me një çetë zogjsh që fluturuan mbi kokën time drejt perëndimit. E ndoqa fluturimin aq sa më lejonte vazhda e tyre tej në horizont. Nuk e di si ndodhi, por, kur i humba nga sytë, u ndjeva shumë i mërëzitur, më dogji malli për atë dhe qytetin tim.

U ula në një gur të madh rrëzë ca drurëve të cëndelit dhe fjeta.

Kur ai u nis të pushonte në një qytet të vogël turistik, unë u ndjeva bosh. Kishte gjithë ato ditë që hapat e tij harmonizoheshin me rrahjet e zemrës sime. Në fakt, kishte ca muaj që më ishte qepur pas, aq sa do të shqetësohesha po të mos e ndieja ndonjëherë praninë e tij.

Disa nga shoqet e mia mblodhën një arsenal të tërë informacioni: nga ç'fis ishte, i kujt ishte, çfarë shkollë kishte. Të gjitha, të gjitha, madje dhe çfarë ëndrrash dinte të shihte ai.

Ia ndjeva ikjen sapo e pashë në sy, vrapova për në shtëpi, bëra gati valixhen time të vogël dhe preva biletën te stacioni i trenit për në kryeqytet. Kur mbërrita, kushërirat e mia më prisnin me kuriozitet të madh. Më rraskapitën me vështrime e pyetje provokuese për këtë udhëtim jashtë plani.

I gënjeva sa munda, ua lexova në sy zhgënjimin. Dhe ato, si unë, bënë sikur e besuan mundimin tim.

Nata e freskët më gjeti në ballkon duke shijuar mijëra drita mbi qytet e në qiell. U shtriva duke falënderuar Zotin që nuk ishte shpikur interneti. Largësia jonë kishte të tjera dimensione atëherë. Kjo gjendje ishte preludi më i bukur i dashurisë sonë, mister, emocion, kuriozitet, pasion e mall. Një shkëmbim numrash, një dridhje elektronike, ca zemra të kuqe dhe një fjalë gjysmake "puç-puç" nuk mund të ishin dashuria jonë.

Kur u zgjuam, ti kishe skicuar me mendje qëndisimat mbi copat e bardha, unë kisha vendosur kë do të sillja për të të kërkuar dorën. Nuk ishim aq të guximshëm sa të mos i respektonim ca rregulla që sot nuk e gjen kush forcën t'i shijojë.

Absurdi kompenson kohët, është krejt absurde të mos dish të duash.

SI E SHKROVA ROMANIN “NJË GRUA MIDIS DY BURRAVE” ME SHKRIMTARIN SHQIPTAR SKIFTER KËLLIÇI

Nga Carrie Hooper, ShBA

Jam nga Elmira, (New York), ShBA. Kam lindur krejtishtë e verbër, por verbëria nuk më ka penguar të jetoj një jetë të plotë me veprimtari të larmishme. Jap mësimë për piano dhe kanto, jap gjuhë të huaja, këndoj në një kor, jap koncerte vokale dhe shkruaj poezi.

Interesi im për gjuhë të huaja lulëzoi në moshën 20-vjeçare, kur ndoqa një kurs të gjermanishtes në universitet. Në shkollën e mesme kisha ndjekur kurse të frëngjishtes, por në atë kohë nuk kisha shumë dëshirë për të mësuar gjuhë të huaja. Mirëpo në ditën e parë të kursit të gjermanishtes më lindi dëshira që jo vetëm ta mësoja këtë gjuhë, por edhe gjuhë të tjera. Me kalimin e viteve kam mësuar suedisht, italisht, spanjisht, shqip dhe rumanisht. Kam mësuar edhe pak latinisht, rusisht dhe finlandisht, por nuk i di mirë këto gjuhë.

Fillova të mësoja shqip, kur kisha një student nga Shqipëria në kursin tim të italishtes, të cilën e dhashë në një universitet të vogël në qytetin tim të lindjes në vitin 2008. Njohja me të ma ndezi kureshtjen të dija më shumë për gjuhën shqipe, prandaj gjeta të vetmin libër në brail për të mësuar shqip te një bibliotekë për të verbërit në Angli.



Në fillim më ndihmoi studenti im dhe pastaj kalova dy verë me radhë duke ndjekur kurse të gjuhës shqipe tek Universiteti Shtetëror i Arizonës. Për ta ushtruar gjuhën, dëgjoja emisione radiofonike të cilat m'i inçizoi shoku im i ndjerë, Timi, edhe ai i verbër dhe profesor i gjuhëve të huaja. Më tej lexoja gazeta shqiptare si dhe vepra nga shkrimtarë dhe poetë si Migjeni, Naim Frashëri, Fan Noli, Ismail Kadare, etj. me kompjuterin tim brail.

Një prift ortodoks shqiptaro-amerikan më lidhi me shumë shqiptarë me të cilët flisja shqip në telefon, dhe u lidha gjithashtu me bashkësi shqiptare në Kanada. Mora pjesë në shumë koncerte të organizuara nga bashkësi shqiptare në SHBA dhe Kanada. Më tej dhashë intervistë për Zërin e Amerikës, për Radion "E diela në Toronto" të Kanadasë, për një kanal televiziv në New York, për "E diela shqiptare" në Tiranë dhe për një emision radiofonik në Kosovë. Veç kësaj kam përkthyer libra dhe artikuj nga shqipja në anglisht.

U njoha me Skifter Këlliçin, shkrimtar i njohur shqiptar me banim në Masachusetts, ShBA, nëpërmjet telefonit në tetor të vitit 2018, kur mora pjesë në një promovim të librit tim poetik shqip-anglisht, "Piktura në fjalë", organizuar nga kryetari i Shoqatës së shkrimtarëve shqiptaro-amerikanë, Adnan Mehmeti, në New York. Pas një bisede të këndshme me Skifterin, shkëmbyem të dhënat tona kontakti. Pastaj nisëm të flisnim shpesh në telefon dhe shkruheshim me email, natyrisht në gjuhën hyjnore shqipe.

Romani "Një grua midis dy burrave", ngjarjet e të cilit zhvillohen në shtetin e Kalifornisë, tregon historinë e infermierës Meri Davenport, e fejuar me shkencëtarin çarli Smith, e cila dashurohet me Kreshnik Gërmenin, biri i një shqiptari i arratisur nga Shqipëria komuniste, kur Krishniku është i vogël. Fatkeqësisht babai i Kreshnikut plagoset rëndë nga banditë duke shpëtuar jetën e një polici. Para se të vdesë, Ralph Kallagani, komandant i policëve, i premtonte se do ta dërgojë vogëlushin në jetimore, por nuk e mban fjalën dhe kështu Kreshniku birësohet nga Xhejms Klemensi, shoku i babait të tij, i cili është pijanec dhe kumarxhi. Kreshniku bëhet trafikant i drogave, për të shlyer një borxh të Xhejmsit. Sa më shumë e njeh Kreshnikun, aq më shumë Meri zbulon një njeri me dhunti poetike që e do edhe muzikën klasike dhe e nxit ta lërë pas jetën e filliur të trafikimit të drogave. Plot intriga dhe të papritura, "Një grua midis dy burrave" trajton anën e ndërlikuar të dashurisë.

E falënderoj kolegun tim Skifter Këlliçi për mundësinë që më dha të shkruaja një roman me të, që rezultoi të jetë bashkëpunimi i parë shqiptaro-amerikan në historinë e letërsisë shqiptare.



Megjithëse gllabëronte vëmendjen e pamundur, **libri**, natyrisht me ato kapriçiot e tij prej fëmije, nuk arrinte të merrte vesh se ku i përfundonin fuqitë. Për më tepër i kujtohen kohët e lumtura, bibliotekat e mobiluara bukur e plotësisht, sallonet e përfunduara me tapicerinë më të pëlqyer të kohës, por ndoshta edhe stononte, tepër i zbukuruar e mjaft i rënduar. Sidoqoftë, kreditorët (!) e torturonin librin më shumë se herët e tjera, pasi nuk kishin parà të thata për t'i paguar nga shteti, gjë që i shkaktonte një habi të vazhdueshme, sepse ata i mbanin si një model ekonomie, të lidhur fort edhe me Ministrinë e Ekonomisë, Teknologjisë (Inovacionit) dhe Kulturës, po ashtu edhe me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit...

Që prej muajsh - për t'i rënë shkurt dhe vitesh - kuptohet më gjatë, kreditorët mezi i gjenin paratë e duhura, madje me mundim të madh, ato ditë kur vazhdimisht i kërcënonte uria, se do të mbeteshin përfundimisht thatë, në qoftë se nuk siguronin dot regjistrimin në Panairin Ndërkombëtar (të Librit), nga më të mëdhenjtë në botë, atë të Frankfurtit. Fundja, le të mbetemi, pëshpëritin në QKLL apo në 1/3 e Ministrisë me tre emra ku përfshihet edhe kultura. Epo, fundja panair libri është, nuk është panair fjala vjen turizmi! Që tek e fundit ka edhe leverdi personale.

Për sa i takon kreditorëve të rastit, që nuk gjendeshin dot kurrë, njëri më idiot se tjetri, ata nuk dinin konkretisht se çfarë jepej e çfarë dhurohej dhe askush nuk mund të zemërohej me kopracinë e tyre. Ah! Sa do të kishin dashur ta sillnin vërdallë të gjithë këta burokratë që kanë në dorë librin, por ç'e do, ata përsëritnin njëzet herë në ditë maksima për një sjellje të mirë! Shaka? Jo, kurrë! Kush arrin ta kuptojë të vërtetën e hidhur të librit, le ta kuptojë! Mirë i bën vendit, fundja! Nuk ka asnjë projekt për të bërë librat, për asgjë në botë, përveç atyre të shoqërisë së ngushtë, lidhjeve të klanit, hyrje-daljeve të përditshme në "stanin" e librit... Kjo që them nuk është as paragjykim, as përshtypje, as gjykim nga përfundimet e një studimi. Nga ana tjetër e di mirë se në vendin tonë pa biblioteka (NUK KA ASNJË BIBLIOTEKË PËR TË QENË, që ta meritojë këtë emër me kaq ngarkesë semantike e të kulturës). Ju mund të thoni se kemi një bibliotekë kombëtare! Vetë Tirana nuk ka asnjë bibliotekë të paktën as sa ajo "Vexhi Buharaja" e Beratit, që për formalitet ngjan të jetë e këtyllë...

Duhet të ishte e arsyeshme, e matur, që LIBRI të thoshte për çdo mëngjes përshëndetjen e tij të bukur, ndërkohë që është i fiksuar pas atij vizioni republikan të vetes, për ta respektuar deri në fund, i cili tashmë është kthyer gati në një imazh që thërret, duke i ngjallur besim dhe shpresë, që s'i ndahet dhe që rritet e rritet vazhdimisht, por pa u mbështetur në taban. Është ulëritëse miq! **Ka mbi 30 vjet që për bibliotekat nuk blihet libër.** Kjo ishte arsyeja, që, me gjithë fërgëllimën e zemërimit të papërmbajtur, libri i nënshtrohet krahut të qeverisë, duke shkuar sa tek njëra vitrinë, tek tjetra, midis njerëzve që sa vinin e bëheshin më të rrallë, derisa të mos ketë më shqiptar që të lexojë shqip...

Kalldrëmet kanë nisur të thahen dhe një erë e freskët, e cila nis të fryjë përgjatë galerive të librit, që nuk e di pse më sjellin ndërmend galeritë e nëntokës kur dikur (jo shumë kohë larg, shkrimtarë të dënuar nxirrnin mineral!), zunë ta pastronin ajrin e ngrohtë poshtë dritareve, tronditnin fenerët ngjyra-ngjyra, llambat neon, freskoren gjigante e të zjarrtë si një fishekzjarr. Kalldrëme shëtitoresh për këmbësorë, në zonën historike të Tiranës, ku do të kishte paraqitje librash çdo javë (të paktën!) e që mbetën nëpër fletët e legjendave të reja.

- Oh! Sa e bukur! - thoshte një librar, i etur për të zhvilluar punën me librin, tek vitrina e fundit, (por që librat kishin avulluar, ngaqë ishte vënë reklama e filmit!) duke u kthyer disa hapa më pas për të soditur një kopertinë të hedhur në tokë.

Ata e lanë, më në fund, shëtitjen, por kreditorët nuk deshën të ecnin në këmbë, pastaj ata nuk kishin pse të nguteshin, kështu që në këtë mbrëmje të bukur do të

PËR LIBRIN FLITET E FLITET PA FUND DHE... BËHET ASGJË

Përshtypje nga Xhevair Lleshi

qe mrekulli të ktheheshin në këmbë. Pastaj, me të mbërritur tek një vend si punë librerie, librit i shkrep një dëshirë, thua se kishte uri dhe se do t'i pëlqente të hante midhje (**libri**, kështu!), duke i treguar se ata (kreditorët e famshëm të munguar të librit!) nuk kishin ngrënë asgjë që në mëngjes, për shkak të sëmundjes së të ngrënit.

E vënë re të gjithë se **librit** nuk ia mban të kundërshtojë. Mirëpo, ngaqë ende s'ka ekspozime me ndonjë libër, kërkon një sallë të rezervuar për një *bisedë letrare*, duke ecur përgjatë korridoreve. Ata, kreditorët dordolecë i shkonin nga pas *një libri të vetëm*, me pamjen e një femre që e nje mirë këtë mjedis dhe ata shkonin në një sallë ku një vajzë e re e bukur, e mbante derën hapur, ndërsa, prej sallonit ngjitur, nga vinin edhe të bërëtitura dhe të qeshura deri në kupë të qiellit, një burrë-kreditor libri del krejt papritur.

Ishte Drejtori i Librit në Ministrinë e Kulturës, sa 1/3 e Ministrisë ku edhe kultura bën pjesë. Domethënë LIBRI. Me shkathtësi, **ky** është zhdukur në një kthinë, dera e së cilës mbetet si gjithnjë gjysmë e mbyllur. Pasi zhduket kurrizi i rrumbullakët i kreditorit të mbetur ende gjallë (kreditorë sa për emër!), **libri** picërron sytë duke thënë pastaj, me një ton gastroleje: - Dreq o punë! Po të ecën mirë, me sa po shoh. Po i merr librat i pari, tani!

Mirëpo libri vë buzën në gaz dhe, që ta bëjë të heshtë, ia zë gojën me gishta. Ai e sheh dhe ndihet shumë i ekzaltuar, i lumtur megjithatë, i mbuluar çuditërisht nga jargët, që po e takon aty, sepse ende ruan për këtë tregti që nuk ekziston më, një ndjenjë dashurie, me gjithë ndyrësitë e qeverisë për të mos ia varur, kur ja, e pakta në letra, puna është shumë në rregull e për së mbari.

Dhe po ta vësh hollë-hollë libri i gJORë ngre supet me një shprehje dhembshurie. Mirëpo ai, duke bërë shaka, vazhdon të thotë se kjo nuk është jetë, sado që të fitosh në Bankë, pikërisht aq sa t'u japësh vetëm ndonjë buqetë me lule zonjave, për të mbetur, kështu, një subjekt i këndshëm. Por as këtë nuk ia pranojnë! Atij, **librit**, i kanë bërë një jetë jo më të gjatë se tetë ditë në vit (pesë në panair - që panair i thëncin, dhe tri ditë nga Zoti!). Kështu, pra, ai do që të jetë praktik, të krijojë të paktën familje me një vajzë që t'i sjellë një prikë të madhe, një bibliotekë ndoshta - dhe më pas të përfundonte si përgjegjës i bibliotekës, si i ati.

Padashur vura se **libri** i legëdisur buzëqeshte gjithmonë, në mënyrë mosbesuese. Dikush i tregon sallonin (e librit!) me një lëvizje të kokës.

- Mos ke ardhur, për të ngritur bibliotekën e re të Qendrës Kombëtare të Librit, pra të QKLL? Vërtet.

- Oh! Jo. Atë do ta ndërtojë një bandë, - tha libri i gërmuqur, duke i harruar menjëherë planet e tij, nën një afsh dehjeje. - Merret me mend që nuk është bandë muzikore. - Dhe tregon për udhëtimin e tij në Egjipt, në Nil, por pa *ethet e Nilit*. Të vësh duart në kokë! Histori me klandestinë në Gjadër...

Dhe ai nis t'ia tregojë historinë, ndërsa **libri** i legëdisur ia bën qejfin, duke e dëgjuar me dashamirësi.

Por shpejt, ata përfunduan të mbështetur pas murit të korridorit, njëri kundrejt tjetrit. *Libri* dhe kreditori (jo i qeverisë, natyrisht!).

Disa fenerë neoni digjeshin nën tavanin e ulët të sallonit (të librit), një aromë e papërcaktuar varej pezull mes palëve të perdeve që veç tundeshin pa pushim për



një ere që s'dihet ku e kishte burimin. Herë pas here, për të dëgjuar më mirë njëri-tjetrin, *libri dhe kreditori*, kur zhurma e sallonit bëhej e padurueshme, ata afronin fytyrat më pranë njëri-tjetrit. Pikërisht, në këto çaste, çdo njëzet minuta, se nga shfaqej një vajzë e re (që ruante librat) me një dëng me lule në duar, duke i mërëzitur të gjithë, sigurisht pa krijuar ndonjë brengë. Mirëpo, ata, pa u shpëputur, mënjanohej për t'i hapur rrugë, dhe vazhdonin pa e prishur fillin e bisedës, sikur të qenë në shtëpi të tyre, ndonëse nuk e dinin mirë nëse kish mbetur ndonjë libër në shtëpi, megjithëse qenë në mes të poteres që bënë personat të cilët darkonin aty mes rrëmujës së shërbimit... Pse nuk qenkej sallë leximi? Jo, kohët e fundit u arratis libri i marrosur dhe mbeti të bëhej sallë ngrënieje. Madje vjen "Fund java ndryshe", e specializuar për punë të tilla të holla, duke u dhënë drekë falas nevojtarëve! Edhe të **librit**...

- Pa shih pak, - mërmëriti *libri* i legëdisur, duke treguar me shenjë derën e sallës tjetër fqinjë ku kishte hyrë e qe zhdukur nëpunësi si lexues arkaik. Mund të ishte edhe Anesti Gjoni i pallatit tim. Më duket se është lexuesi i vetëm arkeologjik në botë. Lum kush ka fatin ta gjejë atë modem të gjallë!...

Të dy e vështruan një copë herë. Dera bënte ca lëkundje të lehta, sikur të dridhej nga një fllad. Në fund, s'lëvizti fare, dhe kreditorët e ngrirë te porta kryesore (jo e "Fund java ndryshe") qeshën në heshtje.

Libri duhet të ishte i arsyeshëm, vetëm, atje brenda.

- Meqë ra fjala, - pyeti Anesti (lexuesi si lëndë arkeologjike!), - e lexova reportazhin tënd të fundit në "ExLibris" për Prizrenin!

- Po, *mjeshtë*, - u përgjigj një nga poeteshat e atij eventi, - nuk të tregova për të se kisha frikë mos mërëziteshe dhe brengosesh.

- Të brengosem, po përse? Ishte reportazh shumë i gjatë. Ti shkruan shumë gjatë. Nuk i bie shkurt!

Libri i legëdisur ndihet i përkëdhelur që vetë po merrej me personin e poetes. Mirëpo, pa shpjegimet e Anesti Gjoni, i cili ia kishte sjellë gazetën, ndërsa ajo nuk do ta kishte marrë vesh që atje bëhej fjalë për të. Kreditori i fundit, edhe ai si lëndë arkeologjike, e vëzhgonte me dhëlpëri, duke u zgërdhirë me atë pamjen e vet tallëse, ironike. Por, në fund, përderisa Anesti vetë ndihej i lumtur, të gjithë duhet të ishin të tillë.

- Më falni, - thirri një gazetar, që s'dihet si u gjend aty, duke i ndarë nga njëri-tjetri, duke mbajtur me dy duar një raft të prishur librash, që ende s'dihet nga u gjend.

Anesti kishte bërë një hap drejt sallonit të vogël, ku e priste një fëmijë, me shall pionieri të dikurshëm.

- Eh, lamtumirë, atëherë! - tha libri i zgërlaqur. - Shko tek brinari yt.

Libri u ndal përsëri.

- Përse e quan brinar?

- Sepse është një brinar, sigurisht! Pastaj nuk e ditke që unë vetëm tallem me librat që s'mund të jenë brinarë kurrë!

Anesti, lexuesi i pallatit tim, domethënë lexuesi si lëndë arkeologjike, u mbështet përsëri tek muri, duke u treguar thellësisht e interesuar.

- Ah! - ia bëri dikush, ndoshta lexues, me thjeshtësi.

Po ja, papritur ai u nda nga unë, ndërkohë që po vija për këtu dhe dyshoj fort për një takim me librin, sonte. Seç kanë sajuar një udhëtim, kështu besoj.

Libri mbeti pa fjalë, i goditur nga emocioni.

- E kisha një dyshim! - tha kreditori më në fund, duke përplasur duart në tryezën e gjatë. -

Kisha parandier diçka, thjesht vetëm duke e parë, herën e kaluar, në rrugë... Në rrugën e librit!... - Mos! Paske ende rrugë libri, kur s'ka më libra!? Domethënë libri gëzon emrin kur e begenisin! Po qe se kjo do të ishte e mundur!

- Kjo nuk është tentativa e parë...

Atëherë njëri nga ata që s'dukej, shpërtheu në një klithmë zemërate: - Vërtet! Ç'njerëz! Kjo është shumë e ulët!

- Më falni!

Libri që nuk m'u nda gjatë kësaj përshtypjeje, e mori përpara dhe i mbajti dorën për një çast. Ai fliste me atë zërin e tij të kristaltë, një zë me nota harmonike që e bënte shumë të suksesshëm ndër zonjat e librave.

- Lamtumirë, e dashur... Ti e di, të dua si gjithmonë.

Anesti u lirua dhe, duke buzëqeshur, ndërsa gjithçka u mbulua nga një shpërthim britmash e duartrokitjesh, dhe ku dera e sallonit (jo të librit) zuri të dridhej, tha: - Kaqol, (librit!), gjithçka mbaroi... Por kjo s'ka rëndësi. Eja më tako në ndonjë nga këto ditë... Të flasim.

Kur, më në fund, hyri në sallën e rezervuar, libri pa andej-këtej, ulur në një divan të ngushtë, i lëshuar fare, me fytyrë të zbardhur, dhe duart që i dridheshin. Ai nuk i drejtoi asnjë lloj qortimi. Ndërsa Nesti, i trazuar, ndihet i ndarë më dysh, mes mëshirës dhe përbuzjes. Ky burrë i vërtetë, ky lexues i madh, ndonëse për lëndë arkeologjike, s'ka zot që e mashtron! Librit i vjen t'i hidhet në qafë dhe ta ngushëllojë, por, sido që kjo është e drejtë, megjithatë mëshira mbizotëron për çudi.

Libri nuk u nda prej tij, duke kujtuar që Nesti i kish mbetur të qe kreditor, edhe pasi hëngri midhjet që kishte dëshiruar, përkundrazi, ata ndenjen së bashku edhe një çerek ore në kafe dhe u kthyen në bulevard.

Ora kishte shkuar njëmbëdhjetë, ndërkohë, para mesnatës sekush mendonte se do ta gjente një mënyrë të përshtatshme për ta përzënë.

Si një masë paraprake, në paradhomë, **libri** dha një urdhër.

- Rri në gatishmëri, do t'u thuash të mos bëjnë zhurmë, kur tjetri të jetë akoma me mua.

- Po ku ta vendos, zonjë?

- Ruaje në kuzhinë, është më e sigurt. Nuk e ha njeri librin.

Një zjarr i madh ishte ndezur dhe digjej për bukuri. Ishte po ai sallon me orenditë e vjetra, me perdet dhe me ndenjëset me damask të ruajtur mirë, me lule të mëdha blu në sfondin ngjyrë hiri.

Libri kishte pasur vetëm një trill: për një lëkurë tigr përpara oxhakut dhe për një llambadar kristali të varur në tavan.

Ai i bindej me atë nënshtrimin e burrit që nuk ka më frikë se mund ta shikojnë. I vetmi merak i tij tani ishte që *të mos e mërëziste kush*, pastaj të mos e zemëronte sidomos Qendrën Kombëtare të Librit që tani do ngrinte Bibliotekën e Madhe të Librit, ende pa projekt...

Tiranë, më 7 gusht 2024

Ndër momentet ku kinemaja shqiptare dhe krijesit e saj - gjithë letërsia e arti - heshtin dhe meditojnë trishtueshëm, mbase edhe pendohen e vuajnë, është mungesa koherente e jetës intime, e dashurisë në përgjithësi. Kjo temë e, përkitazi, skenat intime, në të gjitha veprat filmike, në art përgjithësisht, përdoren për të 'vizatuar' çaste të rëndësishme, në harmoni me gjithë zhvillimin dramaturgjik të veprës, në akord me tregimin a përvojën që përcillet në publik. Për vetë rrethanat, në kinemanë shqiptare këto episode janë kaluar me ndonjë shikim, buzëqeshje, e shumta me ndonjë përkëdhelje. Këtë 'peng' e kam cekur disi edhe në një shënim të mëparshëm për kinemanë, atë me titull "Kinemaja shqiptare në një stad të ri"; por në këto radhë, kjo mangësi vështrohet më në gjerësi, me mungesat dhe ndikimet e saj nga pikëpamja profesionale, në brendinë dhe në formën artistike të filmit.

Natyrisht, nuk heq asnjë presje nga ai shënim dhe nga një sërë shkrime, ku përpiqem të vlerësoj çka ishte pozitive dhe me vlerë, sadopak vlerë, në gjithë krijimtarinë e trashëguar: në letërsi, në arte dhe, posaçërisht, në kinema. Ndërkaq, le të themi me thjeshtësi e drejtësi se në filmat shqiptarë të rendit 'tjetër', por edhe këtë në tranzicion, dashuria nuk është aq një dimension njerëzor, një arsye për të jetuar e luftuar, se sa një shtojcë e jetës dhe problemeve të tjera sociale. Të kohës. Është, e thënë ndryshe, njëllor arne, në pamundësi të ngjizjes së saj në krejt veprën.

Për hir të së vërtetës, në fillimet e veta, sado që gjithnjë nën censurë dhe - për keq a për mirë, nuk jam i sigurt - nën ndikimin e kinemasë sovjetike, filmat shqiptarë, si "Tana", "Vitet e para" etj., i kishin më me tepri skenat intime; së paku kërkimin për to. Në filmin e hershëm "Tana" (Fatmir Gjata, Kristaq Dhamo) shohim Naim Frashërin dhe Tinka Kurtin në rolin e dy të rinjve që e realizojnë dashurinë e tyre, por përmes një sërë pengesash. Në film nuk mungojnë çastet idilike - me njëllor ndikimi, siç u tha edhe më lart, nga kinemaja sovjetike - skena e përqafime që më vonë nuk do të shiheshin shpesh në filmat artistikë shqiptarë.

"Vitet e para". Pavarësisht vështirimit krejt ndryshe sot të ngjarjeve që vijnë në këtë film (bëhet fjalë për tharjen e Kënetës së Maliqit) ka disa skena të tilla, me një qasje intime. Janë në fillim të një lidhjeje të rinjtë vullnetarë Vera dhe Dalipi (nga rolet e para të aktorit të paharruar të karaktereve Jani Riza). Por në brendinë e asaj që po themi, ka ledhe e flirte edhe në raportin midis Zyraka Mingës (në rol Margarita Xhepa) e Stavri Larës (në

DASHURIA - NJË TABU NË FILMIN SHQIPTAR

Nga Vangjush Saro

rol Piro Mani).

Më pas, duke u larguar edhe nga 'shoqëria' e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore - gjithsesi, ishin vende e komunitete më të emancipuara se ne - ashtu si çdo produkt artistik a fushë e jetës, edhe kinemaja filloi të binte edhe më tej në skematizëm; kurse termi 'dashuri' u bë pothuaj njëllor mëkati, tabu, së paku deri në fillim të viteve '80, kur diçka pak filloi të ndryshonte në letërsi, në përktihme, në teatër dhe në film.

Është e dhimbshme, por në pasurinë e madhe filmike të disa dekadave, ka aq pak dashuri. Gjestë. Flirte. Puthje e skena intime jo që jo. Nuk është fjala për t'i parë intimitetet apo shtratin si qëllim në vetvete, por në funksion të zhvillimit të dramaturgjisë së filmit dhe, njëherazi, si një mbështetje për anën spektakolare të tij. Në shumë filma, aktorët vetëm sa shikohen në sy e ndonjëherë kapen për duarsh. ("Si gjithë të tjerët", "Zonja nga qyteti", "Yje mbi Drin", etj.) Në filmat e Kristaq Mitros dhe Ibrahim Muçajt, ndër kineastët që iu qasën temës së dashurisë me shumë sukses, ka kërkime në këtë temë, por në mënyrë të limituar, kryesisht si pjesë ilustruese të temave sociale që ata kanë trajtuar.

Janë aq shumë kuadro filmi që kanë pasur nevojë për skena intime; dhe ato kanë munguar: "Apasionata" e "Njeriu i mirë" (sipas novelave të Dritëro Agollit) dhe "Duaje emrin tënd" (skenari Nasi Lera). Skenat e dashurisë (së munguar) mund të kishin formuluar më shumë 'fat' edhe për filmat "Dhe vjen një ditë" e "Flutura në kabinën time" (Teodor Laço, Vladimir Prifti) apo "Hije që mbeten pas" (Diana Çuli, Esat Musliu) ku me gjithë gjetjet dhe mizanskenat e punuara mirë, dashuria është gjithnjë pjesë a shtojcë e një konflikti tjetër social. Te "Në çdo stinë" (Bashkim Hoxha, Viktor Gjika) edhe pse ka skena të bukura, pengu politik rëndon mbi pengun e dashurisë. Filmi "Shirat e vjeshtës"

(Nexhati Tafa, Spartak Pecani) gjithashtu e vë dashurinë në një provë sa vetjake, aq edhe sociale.

Në filmin "Familja ime" të kinoregjisorit Albert Xholi (skenari Rozi Theohari) të dashuruarit bëjnë një hap më shumë; së paku sa u takon 'kushteve të dashurisë': ata kërkojnë 'kohë' për t'u njohur dhe kjo vërtet që ishte... e parakohshme. Regjisori në fjalë gjithnjë ka synuar të sjellë tema sociale sa më pranë së vërtetës; ai i bën shumë vend pjesës njerëzore të dashurisë, që mbulon shumicën e skenave të filmit, bie fjala te "Fillim i vështirë"; kurse te kinokomedia "Shkëlqim i përkohshëm" ai realizoi për të parën herë në kinemanë shqiptare një puthje të vërtetë (e thënë ndryshe një 'puthje sagllam', siç u shpreh një moderatore e njohur në TV, gjatë bisedës me aktorin protagonist të filmit).

Një përpjekje të vlerësueshme në këtë temë, bëjnë Dhimitër Anagnosti në filmin "Në shtëpinë tonë" (skenari Kiço Blushi); Piro Milkani në filmin "Në prag të jetës" (skenari Vath Koreshi), si dhe kinoregjisori Spartak Pecani në filmin "Vetmia". Po ashtu, kinoregjisori Eduart Makri në filmin "Shpresa", me skenar të Dhimitër Xhuvanit, film ku dashuria e Piro (një inxhinier i ri, të cilin e luan vetë Eduart Makri) dhe Shpresës (një vajzë e përgojuar, luajtur plot hijeshi nga aktorja Matilda Makoçi) shpesh vendoset në një sfond lirik dhe në peizazhe herë të çelura e herë gri, sipas zhvillimit të ngjarjeve.

Në disa filma televizivë, dashuria gjithashtu ka qenë e përfshirë dukshëm në dramaturgji; ka ardhur disi në mënyrë poetike, ashtu në shenjtërinë e vet, shpesh me patetizëm; megjithatë, përgjithësisht, pa shumë lidhje me zhvillime të brendshme të jetës së personazheve dhe pa skena intime. "Unë e dua Erën" (Besa Myftiu, Albert Minga) "Të shoh në sy" (Nasi Lera, Mevlan Shanaj)

Pra, tema nuk mungoi, si e tillë, në asnjë art të asaj kohe; por ishte pak për çfarë duhej kërkuar e realizuar dhe për çfarë po flasim. Dashuria nuk ishte e ndërkallur bindshëm në veprën artistike në kuptimin më të



gjerë të fjalës, si përparësi në një subjekt, si ndjenjë e natyrshme dhe përtej klimës propagandistike, si një mundësi shprehjeje e ndjenjave dhe ëndrrave, fundja si një pistë ku drama dhe personazhet zbërthehen dhe 'vizatohen' plotësisht e pa brutalitetin e ndikimit ideologjik apo të moralit të kohës, që i çonte autorët në skena ku bashkëshortët apo të dashuruarit ngjanin më tepër si shokë...

Arsyet pse ka ndodhur kështu, mund të gjenden lehtë në kufizimet raskapitëse të atyre dekadave, në ndërhyrjen diktuese të komisioneve dhe të censures që, përveçse i kanë 'trembur' autorët, në disa raste - ç'po them, në shumë raste - kanë coptuar skenaret dhe kanë prerë aktet e skenat e xhiruara. Por ndërkaq, nuk mund të mos ndalemi edhe te efektet e autocensurës; në një kuptim, ftohtësia e vetë autorëve ndaj kësaj teme. Nuk besoj se gaboj shumë nëse them që duke e ditur se mund të kishin telashe e, fundja, nuk lejohej puthja e intimiteti, autorët vetë i shmangeshin këtij dimension; jo thesht temës së dashurisë, por sidomos episodeve intime, duke mos kërkuar shumë nga aktorët, duke mos guxuar për mizansena e vizatime të përafërta; me pak fjalë, duke i rënë shkurt... Po ashtu, pak mund të flitet në lidhje me atë se sa e përgatitur ishte për këtë 'sakrilegj' vetë familja shqiptare, si palë shikuese, por edhe ajo e vetë interpretuesve.

Për fat të keq, kjo 'shkollë' me prirje frenuese u shfaq për një kohë të gjatë edhe në filmat e xhiruar pas viteve '90; tradita të merr përpara dhe, nga ana tjetër, autorëve u mungonte përvoja dhe sensi realizues në këtë temë. Filmi "Vdekja e kalit" i kinoregjisorit Sajmir Kumburo, skenari Nexhati Tafa - u realizua me kontributin edhe të kinoregjisorit Albert Xholi - theu për së pari tabunë e jetës intime, të seksualitetit madje, si episodi më i nxehtë dhe ndonjëherë më domethënës i dashurisë, si akt e marrëdhënie jetike, që pasuron dhe shtyn më tej subjektin, i jep tone të tjera ngjarjes. Më tej, u panë të tjera skena aso e kërkime në këtë temë edhe në filmat "Trishtimi i zonjës Shnajder (Piro Milkani) e "Parrullat" (Ylljet Aliçaj, Gjergj Xhuvani) për të vazhduar me "Maya" (Luljeta Lleshanaku, Pluton Vasi) "Amnistia" (Bujar Alimani) etj.

Sot filmi përballlet me kërkesa të tjera; dimension i bashkëkohor është një sfidë e madhe, që ndonjëherë të tremb dhe e rreshton temën në fjalë (dashurinë) krahas gjithë vështirësive dhe pamundësive të tjera. Për fat të keq, shpesh, episodi i dashurisë prapë mbetet një gjë e veçuar, disi jashtë subjektit të veprës dhe së tërës në përgjithësi, pothuaj shtojcë për pak spektakël; dhe e gjithë kjo është thjesht mungesë përvoja, por edhe mangësi që nis me vetë skenarin. Në ndonjë rast, dashuria merr më shumë vend nga sa mban plani në akt apo vetë ngjarja, për të mos thënë që shikohen teprime; dhe kjo nuk i shërben veprës, mbetet gjithnjë pjesa e palidhur me skenarin.

Duke u përpjekur që në këto radhë të jem sa më i drejtpërdrejtë, por edhe mirëkuptues, vij në një riqasje me çfarë është shprehur edhe në shënime të mëparshme: kinemaja shqiptare - e së shkuarës apo e së tashmës - ka shfaqur dhe vazhdon të shfaqë ende tabu, të cilat e bjerrin mundësinë e filmit për ta rrëmbyer publikun. Është vendi të themi se kjo ndodh edhe për shkak të raporteve jo gjithnjë të shëndetshme midis letërsisë dhe filmit; një temë aq delikate. Gjithsesi, kinemaja shqiptare, ajo e sotmja, dalëngadalë po i kapërcen shumë nga ngërçet e trashëguara, mes tyre edhe mungesën e jetës intime dhe të dashurisë. Por ani, ky është vetëm njëri nga problemet e shumta të saj; (ato fillojnë me përzgjedhjen e skenarëve dhe përfundojnë te distribuimi që aq shumë lë për të dëshiruar).



Karikaturë nga Arben Meksi



Cdo fjalë të kësaj historie personale, unë e kam shënuar si me gjakun tim, ndërsa ndërmjet rreshtave kam vënë gjithë shpirtin tim. Por nuk është aspak e lehtë të dish të hapësh portat e ashtuquajtura “të pahapshme”. Jo vetëm në Trojë, por edhe anëekënd botës, ekzistojnë shumë porta, që njerëzit mbas shumë dështimeve për t’i hapur, i shpallën “të pahapshme”. Nga ana tjetër, e njëjta histori apo vdekje, tregohet ndryshe. Ka shumë raste kur për të njëjtin njeri, thuhet që ka vdekur në një festë duke kënduar, ose duke krijuar një kryevepër, ose duke luftuar në një betejë madhështore, apo në një gjumë çudibërës. Të tjerë thonë për të njëjtin person, që atë e hëngrën qentë të gjallë ose që u mbyt në një lumë, sepse nuk dinte të notonte. Një rrëfimtari i fundit thekson që ky person vdiq “duke pjerdhur”, por u tha që ai “vdiq si një hero”. Edhe për mua janë thënë shumë gjëra fantastike, që nuk vlejnë të përmenden. Për mua është treguar për shekuj me rradhë, një histori e rreme. Indiferenca trojane ishte kolosale dhe fatale. Si të verbuar, trojanët shkuan drejt vdekjes si në një festë. Unë kam parë me sytë e mi si binin në tokë, kokat e prera, duke gjëmuar si kambana të gjalla. Pastaj, duke u rrotulluar, kokat e prera përfundonin në një zjarr të madh. E gjithë Troja mori flakë dhe befas, secili, tepër vonë kuptoi që edhe ai vetë, po digjej me të vërtetë, dhe jo në një ëndërr. Përse u verbuan trojanët? Përse shfaqeshin kudo kontradikta dhe paradokse tepër të çuditshme?


Çudi e çudive, është sjellja jonë e pakuptueshme. Edhe nëse nuk duam ta themi, më në fund, të vërtetën, vjen befas momenti, që të zbulojmë sekretin tonë individual, dhe të mos e marrim gjithçka me vete në varr, dhe gjithçka të humbasë në oqeanin e harrimit dhe të falsifikimit, sikur ne të mos kishim ekzistuar kurrë, por të kishim qenë veçse ëndërra, hije ose fantazma mashtruese. Faktet përsëriten, pastaj, nga një rrëfim në tjetrin, por asnjëherë njëlloj. Gjithnjë shtohet ose hiqet diçka. Kështu pak nga pak, shekull pas shekulli, krijohen legjendat dhe mitet. Unë e kisha ndjekur këtë proces, nga rrëfimi në rrëfim, për të dalë, siç besoja me forcë, te e vërteta ime personale. Tanimë, madje krejt normalisht, më dukej vetja, herë si një tremijëetreqindvjeçar dhe herë si një fëmijë me një esprit të çuditshme.

Në fillim isha shumë i druajtur.

Skuqesha vërtet, si një fëmijë i zënë në faj.

Kishte shumë vjet, që dëshiroja të dilte në dritë, më në fund, e vërteta ime personale, autentike, që të mos vazhdonin të rrëfeshin legjenda akoma për mua, që nuk thoshnin të vërtetën, ose që e trajtonin atë, secili sipas imagjinatës së tij. Kështu, nisa disa herë ta shkruaja historinë time ashtu siç ishte, por menjëherë, miq dhe armiq, më paralajmëruan që të mos e nxirrja në dritë të vërtetën, sepse kjo do të shkaktonte reagime të forta, me pasoja të paparashikueshme, nga shumë persona të implikuar në mënyrë të drejpërdrejtë në këtë histori ose jo, dhe në mënyrë të veçantë, nuk duheshin trazuar, ata të shërbimit sekret, të cilët, ishin gjithnjë të gatshëm për t’i bërë gjëmën kujtdoqoftë edhe për hijëgjë. Ose, klithnin disa të tjerë, kjo mund të shërbejë madje si shkak për plasjen e një lufte tjetër, apo për një ndjekje fatale jo vetëm ndaj meje, por edhe kundër gjithë familjes sime si edhe gjithë miqve të mi, që mund të përfundonte fare mire me disa skena makabre dhe njëkohësisht groteske.

Disa herë, megjithatë, fillova ta shkruaja këtë histori, dhe pastaj i grisja ato që shkruaja, pa e kuptuar përse. Ndoshta më mungonin fjalët e duhura, ndoshta më mungonte guximi i duhur. Sepse të thuash të vërtetën, kjo kërkon në rradhë të parë, guxim, si dhe të mos presësh asnjë përfitim. Dy herë më paralajmëruan kinse me mirësjellje, ndërsa të tretën herë më



kërcënuan direkt. Pastaj, më shkruanin letra anonime, ku më kërcënonin indirekt, dhe më quanin, “personin më të rrezikshëm mbi tokë, në ditët e sotme.” Kështu u detyrova të tërhiqem, mbas shumë ngurrimesh dhe paqartësish të turbullta.

Koha kalonte shumë shpejt, shumë më shpejt nga ç’mendoja unë, dhe nuk po gjeja kurrfarë qetësie. Nuk dëshiroja aspak që të vdisja një ditë, para se ta kisha thënë të vërtetën ashtu siç ishte. Pikë për pikë. Pa asnjë zbulim dhe pa asnjë shtrembërim. Por nuk duhet harruar aspak dhe asnjëherë, që gjithmonë ka pasur të vërteta, që nuk ishin të vërteta. Sa i përket personit tim, ishte një nder dhe një mision i madh për mua, që të isha një mbrojtës konsekuent i të vërtetës. Nuk mund ta vazhdoja heshtjen time më gjatë, megjithëse asnjëherë nuk është aspak e lehtë të flasësh për veten dhe të jesh i paanshëm. Por kishte gjithashtu njerëz dhe jo pak miq të sinqertë, që më kishin qortuar disa herë për mosreagimin tim ndaj gjërave jo të vërteta, që tregonin për mua, madje për shpifje dhe mashtrime të rënda, që nuk kishin të bënin aspak me personin tim. Kështu ishte krijuar një tablo krejtësisht e rreme. Kishte ndodhur një deformim dinak i të vërtetës dhe dukej sikur nuk mund ta kundërshtonte askush. Unë nuk kisha jetuar kurrë i fshehur. Edhe sikur ta doja një gjë të tillë, për një prift si unë, kjo do të ishte një gjë krejtësisht e pamundur. Tani kishte ardhur momenti final, që e vërteta të dilte në dritë, plotësisht e kulluar. Nuk kisha asnjë arsye për të fshehur asgjë. Përkundrazi, ndjehesha i qetë dhe i gatshëm për të përballuar çdo situatë. Nëse do të mbetej e vërteta akoma në errësirë, drama e rastit tim do të kthehej në një tragjedi. Tragjedia është tragjedi kur dënohet një i pafajshëm me të vërtetë, ose në një mënyrë imagjinare, gjë që nuk ndryshon asgjë, sepse sot njerëzit besojnë madje, më shumë gjërat imagjinare sesa gjërat e vërteta. Tragjedia është një situatë pa rrugëdalje. Ky nuk ishte rasti im.

Gjëja më e vështirë m’u duk në këtë mes, gjetja e gjuhës dhe e tonit të duhur, sepse unë doja që gjithçka të ishte e saktë,

tërheqëse dhe e pandryshueshme. Nuk e kisha menduar kurrë që kjo punë të ishte diçka më shumë se të bëje një revolucion individual. Pastaj, m’u afruan disa herë shuma astronomike, vetëm e vetëm që të mos e shkruaja të vërtetën ashtu siç ishte, por unë nuk pranova asnjëherë prej tyre, megjithëse duke qenë një prift i thjeshtë trojan, nuk isha i pasur, prandaj një ofrim parash të tilla, në një rast tjetër, nuk do ta kisha refuzuar. Një herë më dërgonin para, me një shportë të madhe. Një herë tjetër, më ofronin një dokument që më bënte pronar të një vile të bukur buzë detit. Ose më ofronin dhurata nga më të ndryshmet: një anije, karroca luksoze, një udhëtim në Kinë ose në Indi, stoli prej ari, ose rroba të mrekullueshme, të ardhura nga vende mjaft të largta.

Herë të tjera u munduan shumë të më korruptonin, duke më ofruar gra shumë të bukura. Nuk kisha parë ndonjëherë më parë femra kaq të bukura. Ku i gjenin, vallë? Të gjitha ishin gati të bënin gjithçka, vetëm e vetëm që të ndalesha e të mos vazhdoja të shkruaja më tej. Por asgjë nuk më ndalonte dot, që të mos shkruaja më tej. Unë punoja nga mëngjesi në darkë dhe kisha një etje të çuditshme për të shkruar vetëm të vërtetën, sa më mirë dhe sa më bukur, por gjithnjë pa e kaluar kurrsezi sensin e masës, dhe pa bërë stilizime dhe zbulime të kota amatoreske.

Pastaj u orvatën tre herë që të më vidhnin dorëshkrimin. U organizuan tre tentativa të tilla brenda tre ditësh. Ditën dhe natën. Ishin tentativa mjaft të rrezikshme, por ia dola mbanë të ruhem vetë dhe ta ruaj edhe dorëshkrimin tim. Organizatorët u kapën dhe u arrestuan, por i liruan mbas tre ditëve dhe i dërguan në një vend të largët.

Një javë më vonë ndodhi një gjë akoma më e tmerrshme. Më kërcënuan disa herë, disa tipa të maskuar, që do të më vrisnin, “si një qen të tërbuar e të zgjebosur”, nëse nuk do të pushoja së shkruari. Dhe u organizuan tre atentate të ndryshme kundër meje. Nuk e di sesi shpëtova. Kur u mbushën tre muaj, dorëshkrimi mbaroi. Nuk më pëlqente të shkruaja gjatë. Por, duke e ditur mirë se

gjëja më e vështirë ishte të shkruaje shkurt, nuk u tremba nga sfida. Pastaj bëra disa kopje, për të qenë i sigurt, për çdo rast të mundshëm: të ashtuquajtur aksidental ose të organizuar.

Kur e morën vesh këtë, ndjekësit e mi, zunë të më ndiqnin këmba-këmbës, dhe më kërkonin çdo ditë, që t’ua shisja dorëshkrimin për një shumë astronomike. Me shumë dhimbje, nuk pranova. Pastaj më qëlluan tre herë në buzë të veshit, me shigjeta të holla dhe shumë të mprehta. Herën e katërt më plagosën këmbën e majtë. Dhe ajo që ishte më e çuditshmja, ishte indiferenca e miqve të mi dhe e pushtetit në fuqi.

Pastaj më dërguan një letër kërcënuese të tmerrshme:

“I nderuari zoti Laokont! Ne të duam të mirën. Ne duam vetëm të të ndihmojmë. Por që të të ndihmojmë ne ty, duhet që edhe ti të na ndihmosh ne. Gjërat janë gjithmonë reciproke në këtë botë. Por, po nuk na e shite ne dorëshkrimin tënd, atëherë do të ta presim dorën, me të cilën e ke shkruar. Përsëritetje miqësore! Nga ata që të duan me të vërtetë!”

Nuk më zuri gjumi gjithë natën. Të nesërmen u detyrova të paraqitem te shërbimi sekret, dhe u tregova letrën. Më priti vetë shefi i shërbimit sekret, me një përziemërsi mjaft solemne. U befasova disi, por nuk e tregova aspak befasinë time. Ai ishte një tip vërtet jo i zakonshëm, me sy paqësisht mizorë, që të zhbironin tej e tej. Duke qeshur ai mund të të ngulte një thikë në kurriz. Dukej jo si një njeri, por si një demon. Nuk dihej qartë sa viktima kishte çuar në botën tjetër. Dhe njëkohësisht ai ishte i aftë të sillej si një engjëll me viktimat dhe bashkëpunëtorët e tij. Thuhej nën zë, që “edhe Priami kishte frikë nga ai”.

Unë dyshoja që gjithçka e organizonte shërbimi sekret. Por natyrisht, nuk kisha asnjë provë. Sidoqoftë, duke ua treguar letrën atyre, që duhet ta kishin shkruar, ndoshta do të ndalohej urdhëri që ky kërcënim i tmerrshëm të vihej në jetë. Shefi i shërbimit sekret, më preku te supet dhe më tha me një zë thuajse miqësor:

- Ju jeni një nga njerëzit më të respektuar të shtetit tonë. Në dosjen tuaj nuk ka asgjë negative. Gjithçka është pozitive, përveç disa gjërave të vogla, që nuk kanë asnjë rëndësi. Prandaj, unë ju bëj thirrje në emër të mbretit dhe të shtetit tonë, që të të rrini i qetë, sepse kjo letër nuk mund të jetë diçka serioze.

- Çfarë?

Unë pyeta si i hutuar.

- Ju mendoni vërtet që një letër e tillë nuk është serioze. Në këtë letër, mua më kërcënojnë të më presin dorën. Nuk mjafton që më kanë plagosur në këmbën e majtë, nuk mjafton që më kanë bërë atentat disa herë, nuk mjafton që tani duan të më presin dorën, nuk mjaftojnë gjithë këto gjëra, zoti shef i shërbimit sekret, që e gjitha kjo të quhet diçka shumë serioze?

- Qetësohuni, zoti Laokont. Me siguri është fjala për ndonjë shaka.

- Shaka? Çfarë, akoma? Më duket se ju po bëni shaka me mua, apo jo?

- Aspak, por ju jeni mjaft i eksituar. Qetësohuni, që sot e tutje do të urdhëroj që të jeni nën një mbrojtje speciale nga ana jonë.

- Vërtet? Do ta bëni këtë gjë?

- Përse jo? Nëse ne nuk mbrojmë njerëz si ju, kë duhet të mbrojmë atëherë? Por, thjesht për kureshtje, po ju pyes: a keni ndonjë armik perosnal, a keni pasur kohët e fundit ndonjë konflikt me dikë?

- Jo, me askënd.

- Me çfarë jeni marrë kohët e fundit?

- Me kopshtin.

- Nuk keni bërë asgjë tjetër?

- Jo, asgjë.

- Dakord. Nëse do të keni ndonjë konflikt të tillë, ose diçka të dyshimtë, jeni të lutur

që të na informoni menjëherë, sepse kështu na ndihmoni, që ta kryejmë sa më mirë detyrën tonë. Oh, më falni, edhe një pyetje e fundit. A keni pasur takime këto kohët e fundit, me njerëz shumë të pasur që duan ta modernizojnë dhe ta ndryshojnë tërësisht shtetin tonë? Ose a keni pasur ndonjë përfitim prej tyre?

- Jo, zoti shef, nuk kam pasur takime të tilla dhe as nuk kam përfituar asgjë.

- Dakord. Mrekulli. A keni ndonjë gjë për të shtuar akoma?

- Jo, asgjë.

- Atëherë, më lejoni t’ju uroj jetë të gjatë dhe të qetë.

- Faleminderit, zoti shef.

Dola jashtë si i ndërkryer. Po binte errësira. Një erë e ftohtë dhe e fortë, sikur donte të më shtynte tutje. Ishte fundi i një dite të pazakontë. Kur mbërrita te pragu i shtëpisë sime, m’u kujtua fjala e fundit e letrës dhe me hyri tmerri. “Po nuk na e shite ne dorëshkrimin tënd, atëherë do të ta presim dorën me të cilën e ke shkruar”. Do të ta presim dorën. Do të ta presim dorën. Do të ta presim dorën me të cilën e ke shkruar historinë tënde. Fjalët përsëriteshin, me një ton kërcënues gjithnjë e më të egër. Mezi arrita të kapërceja pragu e shtëpisë.

Dhe prapë nuk më zuri gjumi, por mbeta në një gjendje as në gjumë, as i pagjumë. Pastaj, me sa duket rashë në një ëndërr. Gjëja e parë që pashë ishte një sharre shumë e madhe, që ishte varur në mur. Dhe ajo lëvizte pa pushim, majtas-djathtas, djathtas-majtas.

Nuk kuptohej kush e lëvizte. Pastaj, sharra u afrua te dora ime e djathtë, që u shtri vetvetiu, dhe u bë gati të ndjente një dhimbje të tmerrshme. Por kur sharra preu më shumë se gjysmën e dorës së djathtë, dhimbja ishte akoma e durueshme. Në çastin kur prerja thujse po përfundonte, dhe dora do të shpërbente nga krahu, dhimbja u bë e padurueshme dhe unë klitha si një i çmendur, dhe meqenëse u ngrita vetëtimthi më këmbë, rashë mbi një mur të dhomës, u mbajta disi në të, derisa rrëshqita në dysheme. Duke klithur akoma, “dora, dora”, erdha disi në vete.

Por nuk fjeta përsëri ose fjeta fare pak.

Kur ra mëngjesi, gjelat nuk kënduan, dhe kjo nuk m’u duk një shenjë e mirë. Por u përpoqa me të gjitha forcat e mia që të ruaja qetësinë. Kjo ishte diçka thujse e pamundur, por unë mendoja, që kisha ardhur në këtë botë, pikërisht për të sfiduar të pamundurën. E dija që nuk do të ishte aspak e lehtë. Ndjekësit e mi, me siguri, ishin duke organizuar një kurth tjetër, për të më zënë në të, si një trumcak të vogël. Por unë, më në fund, e mora veten mirë, mbasi bëra një dush të ftohtë dhe mbasi shijova një mëngjes mjaft jetëdhënës. Isha i gatshëm tanimë për çfarëdo që mund të më priste. Me sy të hapur dhe me mendje të kthjelltë. Dita po vinte me një ajër të dëlirë dhe me një premtim të sinqertë. Nuk bënte ftohtë, por as ngrohtë. Nuk ishte qetësi, por as zhurmajë. Më dukej sikur po ndodhnin ndryshime klimatike të çuditshme. Stinët ishin ngatërruar keq me njëra-tjetrën. Por unë vetë përfjeta një stinë të pestë, që nuk dija si t’ja vija emrin. Plaga e këmbës u shërua shumë më shpejt sesa mendoja unë. Por shqetësimet nuk kishin fund.

Nganjëherë më dukej sikur gjithçka nuk ishte asgjë tjetër, përveçse një kontradiktë e madhe. Nëse ndonjëherë edhe rrëfimi im, mund të duket kontradiktor ose paradoksal, më duhet të pranoj që edhe unë vetë, e përfjeta thujse çdo histori, si të tillë. Ne mbijetojmë madje në saj të kontradiktave dhe paradokseve. E vërteta është gjithashtu gjithnjë kontradiktore dhe paradoksale. Në fund të fundit, krejt njerëzimi qeveriset nga kontradiktat dhe nga imagjinata. Nuk e di sesi, por imagjinata ime kalon me lehtësi nga një kohë në tjetrën, nga një moshë në tjetrën dhe nga një ngjarje në një tjetër.



DURIM ÇAÇA

Ritme kadence vere

poezi

*Për Zhoze-Flore Tapy dhe
Filip Zhakotek**

1.
mosha që shikon borën
tek largohet në alpe
në një hënë agimi vere

ujërat e buhithshëm zbresin nga malet
nàjrin gjithnjë e më të tejdukshëm
me cërlojtë e parë që ngarendin
nëpër të druajturit drurë të durueshëm

trupat tanë që iu jepen më mirë njëri-tjetrit
nëpër trëndafilin prush të puthjes
e bien befas si gështenja nga folejëza e vet
drejt e në ajthin e zjarmit

në ditën më të gjatë afsh-kulluar
me dritën gjithnjë e më afër...

2.
shiu i imët i hënës
shpluhuron tej
floknejat e pemëve

pjepër i madh i portokalltë
regëtin kjo hënë
mbi çatitë e fshatrave

herë-herë hëna drejt tokës kthehet
kallustër e cilit vapor të madh
prej cilit breg po vjen...

3.

“midis zambakut
dhe luleshpatave të egra

një dritë
në shije buke”

dhe deti pranë derdh valët e tij
kundër natës ngjyëmanushaqe

vetëm era do të sillët
mbi zërat tanë të zhdukur

“çfarë gjurmë, çfarë
mbishkrim i lehtë”
do të mund të shpëtonte sikur dhe
vetëm kujtesën e një dite...

4.

nga shkëmbi në shkëmb
në pllajat e larta të grurit
kjo busull endacake hëne

krejt atje lart valëvitet
hëna sikur valëvitën ndërresat e lara
n’flladin e thatë të veriut

një krehër zjarri hëne
rrëshqet nëpërmes natës
nëpër valëzimin e një gjumi ëndrre...

5.
a të kam folur ndonjëherë për shikimin
e ngadaltë, të butë, mallëngjyes të një burri
tek dhel trupin e bukur të një gruaje të re
si me një ngrohtësi e siguri kafshe në vlug

për kaosin e hareshëm, mallin sflitës për
rininë
dalldinë e mëndafshhtë që na dhurojnë
ëndrrat
s’e di nëse të kam folur ndonjëherë

për etruskët që e dinin mirë se të vdesësh
është gjithë një akt erotik
për çastin që vetëm ai ka rëndësi
çastin e bukur që nuk kalon kurrë

në t’kam folur për druajtjen e fshehtë që më
ngjall
dielli i nxehtë i Venecies, lagunat, gratë e
hirshme
aroma e luleve, uji midis shtëpive, gondolat
kthjelltësia e çative ngjyrë çiklamini

sharmin piktoresk të një dialekti në Nju Jork
për dialogun barok, moralin e çmendur
mënyrën se si njerëzit thonë “mirupafshim”
n’platformat e stacioneve të trenave në
Hungari
vallë të kam folur ndonjëherë

për portat me trëndafilë e dritaret me
manxuranë
mes muresh të gurt’ e kalldrëmsh t’Senicës
në Delvinë

palcën e puthjes ngushë në gusht,për rastin
në ajth
që është ngaherë një fat që s’e dimë...

6.

trëndafili i prushtë i puthjes
midis gurit e ëndërrimit

zjarr lakmitar, zëra të fshehur
vrapime dhe psherëtima

hija e shkurtër e reve, e mjellmave
sikur një gjumë i pasdrekes n’fërfëllitje

ah, kënga është një lloj vështrimi
që banon shtëpinë gjithëherë
në mënyrën e një zogu prilli...

7.

hëna gulçon mbi gjunjët tanë të afshtë
një hukamë të nxehtë vere
ku futen tinëz pulëbardhat

midis merlucit e verës së bardhë
dhisku i hënës rrotullohet e merr vendin e
vet
mbi tryezën e alltë

kjo përkëdhelje e ngadalt’ e vjetër
mbi shkrepë e shkëmbinjtë ku thepisen
shpatulla guri të mermë...

8.

pulsi i rastësisë së dëshirës
me kuptimin e fjalës së re
(misioni i një njeriu në tokë
është’ që të sjellë në kujtesë)

prania e pavarur e fjalëve
n’alfabetin e mëngjesit
në korrik

lëbyrja që të vjen papritur në sy
para dritës së lumit të Drinit

të folurit tanë që janë’ duart tona
buzët tona, sekset tan’, sytë tanë

melankolia e arinjve të Berlinit
fushat e Kastijës së Maçados
bre, përdorimi i botës
(misioni në tokë i njeriut
është që të kujtojë)

asgjë s’është’ më e rëndësishme
se këto ngjyra, parfume, zëra

erosi që drejton xixëllimin e syve

sandalja e vetme tunxhi e Empedoklit
nëpër llavën e Etnas në Siçili

rëra e bregut e mbushur me guacka
që i rrokullis deti i ngrohtë tej

seç buzët e saj fërgëlluese
mes degëve të manave në gardhe
gëzimi i skajshëm i fëmijërisë
që asnjëherë më s’ndahet
nga skajshmëria e dhembjes

pirja e një gote vere t’vakët në Spanjë
(misioni i një njeriu në tokë
që është’ të sjellë në kujtesë)
ah, të bukurat jobesnike
ah, tristie e re

buzët tona që i lëviz më shumë
ajo që është’ e pashprehëshme...

9.

margaritari i humbur i hënës së re
paj, nëpër këtë ag
të kulluar vere...

*Poetë francezë nga Zvicra.

Dritat e KUQE të neonit filluan të ndriçonin dhe një zë i çjerrë doli nga altoparlantët.

”Treni nisët nga peroni numër tre... treni në drejtim... nisët...”

“Ky duhet të jetë treni yt,” tha nëna e Maria Venturas. “Jam e sigurt se është treni yt, Meri . Nxito. Nxito tani. E ke biletën?”

” Po, mami, e kam. Por a duhet të shkoj menjëherë. Kaq shpejt “

”Ti e di si është me trenat,” i tha babai Marisë . Ai dukej anonim me kapelën e tij gri, sikur të udhëtonte inkognito.

”Ti e di se si është me trenat. Ata nuk presin.”

“Po baba, e di.”

Akrepi i gjatë e i zi i orës së murit mori edhe një minutë tjetër. Kudo kishte njerëz që vraponin, për të udhëtuar në ndonjë tren. Mbi ta ngrihej çatia me kupolë e stacionit hekurudhor si kasaforta e një katedraleje të madhe.

“Treni nisët nga peroni tre... treni drejt... nisët...”

”Nxito zemër.”

Zonja Ventura e kapi Marinë për krahu dhe kaloi sallat e mermerta që shkëlqenin në stacionin hekurudhor. Babai i Marisë e përcolli me valixhen e saj. Njerëz të tjerë nxituan drejt daljes në peronin tre. Një konduktor me një kostum të zi, me fytyrën e hijezuar nga ekrani i kapelës së tij, e futi turmën përmes portave të zeza, të zbukuruar prej hekuri në platformën prapa.

”Nënë, tha Maria, dhe u ndal kur dëgjoji zhurmën e lokomotivës në trasenë e ulur. ” Nënë, nuk mund të udhëtoj sot. Thjesht nuk mund ta bëj këtë. Nuk jam ende gati për këtë udhëtim. ”

”Dokrra, - ia preu fjalën babai i gëzuar. ”Ti je thjesht e shqetësuar. Udhëtimi për në veri nuk është diçka e madhe. Vetëm duhet të hipësh në tren dhe të mos shqetësohesh për asgjë derisa të arrish atje. Konduktori do të të tregojë se ku të shkosh kur të mbërrish atje.”

“Eja tani, trego se je një vajzë e mirë.” Nëna e Marisë futi një fije floku të saj blond nën kapelën e zezë prej kadifeje. “Gjithëcka do të shkojë mirë. Të gjithë largohen nga shtëpia ndonjëherë. Të gjithë thonë lamtumirë, herët a vonë.”

Maria u dorëzua. “Po, po, do të bëj siç thua ti.”

Ajo hyri nëpër portat dredha-dredha, të punuara me hekur dhe zbriti poshtë platformës së pjerrët prej betoni ku ajri ishte rënduar nga avulli.

“Lajmet e fundit, lajmet më të fundit!”

Djemtë që shisnin gazeta thërrisnin titujt e faqeve të para, ata shisnin gazeta ditore para dyerve të trenit. “Lajmet e sotme... dhjetë mijë persona të dënuar... dhjetë mijë të tjerë...”

“Nuk ka asgjë, absolutisht asgjë për të cilën duhet të shqetësohesh, tha nëna e Marisë”.

Ajo e hapi rrugën dhe u përvodh përmes kaosit duke i shtyrë udhëtarët dhe Meri i shkoi pas, duke kaluar vagon pas vagoni deri në fund të trenit . Brenda kishte sedilje prej pelushi të rreshtuara, pothuajse merrnin ngjyrë të kuqërremtë nën ndriçimin e ashpër nga taveni, dhe tegelet e përforcuara me gozhda të vogla tunxhi.

“Si të duket kjo ndenjësë, mu këtu në mes?» Zotri Ventura nuk priti përgjigje, por e hodhi valixhen e Marisë në raftin e bagazheve. Ai bëri një hap prapa. Zonja Ventura vuri një shami në buzët e saj të lvera me të kuqe, filloi të thoshte diçka, pastaj heshti. Në fund të fundit, nuk kishte asgjë më shumë për të thënë.

”Mirupafshim, tha Maria me dashuri. ”

”Mirupafshim, zemër. Kalofsh mirë.”

Zonja Ventura u përkul për t’i dhënë asaj një puthje të lehtë ,distrahuese .

Zoti dhe zonja Ventura u kthyen dhe filluan të largoheshin ngadalë, duke ndjekur

SYLVIA PLATH

Mari Ventura dhe mbretëria e nëntë

Përktheu Qerim Raqi

shtegun në mes për t’u zhdukur më në fund nga porta. Maria u bëri me dorë, por ata tashmë ishin larguar dhe nuk e panë .

Ajo zgjodhi ndenjësën më afër dritares, por përpara se të ulej hoqi pallton e saj të kuqe dhe e vari në grepin prej tunxhi pranë kornizës së dritares.

Shumica e pasagjerëve të tjerë ishin tashmë në vendet e tyre, por disa qëndronin ende në këmbë në korridor, duke kërkuar një vend për t’u ulur. Një grua me një xhakëtë blu me një foshnjë në krahë të mbështjellë me një batanije të bardhë u ndal në ndenjësën pranë Marisë për pak kohë, por pastaj vazhdoi tek vagoni ku kishte më shumë vende të lira.

“Është e lirë këtu?».”

Gruaja erdhi duke çaluar, duke gulçuar, e skuqur në fytyrë, me një çantë ngjyrë kafe në dorë. Lëkura rreth syve të saj blu ishte plot me rrudha dhe goja e saj e madhe, miqësore formoi një buzëqeshje.

“Po, e lirë është .»

Maria nuk mundi të mos buzëqeshte. Ajo iu afrua dritares dhe e vështroi gruan tek hoqi kapelën dhe pallton e leshtë ngjyrë kafe.

“Uh”, psherëtiu ajo dhe u ul në ndenjësën e kuqe prej pelushi. “Nuk isha e sigurt se do ta zija këtë tren. Treni është gati të nisët.”

Lokomotiva lëshoi një zhurmë gërhitëse, duke u tundur dhe ndaloi. “Në bord... të gjithë në bord!” bërtiti një zë nga jashtë. Dyert e trenit u mbyllën me një zhurmë të vogël të fundit, duke i mbyllur të gjithë brenda.

“Është koha të nisemi” tha gruaa. Avulli ngrihej pas xhamit të dritares ndërsa treni lëvizte ngadalë përgjatë shinave dhe qielli nuk mund të shihej nëpër retë e dendura të tymit dhe blozës .

Gruaja futi dorën në çantën e saj dhe nxori një pëlhurë për thurje, fillin e një veshjeje leshi të butë e jeshile.

“Ah,” shfryu Maria. “Sa mirë. Çka do të thurësh?”

“Një fustan.” Gruaja e studjoi Marinë me sy. “Për një vajzë që ka rastisur të ketë pikërisht masat e tua.”

“Jam e sigurt që do ta pëlqejë.” Gruaja i dha Marisë një buzëqeshje argëtuese. “Shpresoj që po”, tha ajo dhe pastaj heshti.

Treni sapo kishte kaluar me shpejtësi përmes një tuneli të errët kur filloi një zënkë në sediljen përpara tyre. Dy djem të vegjël ishin ulur aty pranë njëri-tjetrit, dhe në anën tjetër qëndronte ulur nëna e tyre duke lexuar një gazetë javore. Ata luanin me ushtarë prej kallaji.

“Ma jep këtë”, i tha djali më i madh me sy të zinj vëllait të tij. “Ky është ushtari im. “Ti ma more ushtarin tim.”

“Nuk ta mora fare, - tha djali blond . “E bëre që çke me të. Të pashë kur e more.”

Djali i madh mori një ushtar prej kallaji dhe ia përplasi në ballë të vëllait.

“Merre pra! E meritove”.

Gjaku i rrodhi të vëllait nga gunga tashmë e mavijosur.

Djali i vogël u shkreh në vaj.

“Të urrej. Të urrej “

Nëna e tyre vazhdonte të lexonte gazetën.

“Mjaft tani”, tha gruaa pranë Marisë, duke u përkulur në pjesën e pasme të sediljes. Me një skaj të shamisë së saj të

bardhë prej liri, ajo i fshiu butësisht djalit të vogël gjakun nga balli.

“Duhet të keni turp që të dy, që grindeni kështu për asgjë. Për disa ushtarë prej kallaji”.

Djemtë e vegjël varën buzët për këtë qortim dhe filluan të luanin përsëri në heshtje.

Gruaja u përkul mbrapa. “ Nuk di çfarë nuk shkon me fëmijët në kohën e sotme . Thjesht më duket se po bëhet gjithnjë e më keq.” Ajo psherëtiu dhe filloi përsëri të punonte me shtiza.

Jashtë, drita papritmas u bë më e fortë.

“Shiko, - tha Maria. “Kemi dalë nga tuneli.”

Treni u zhyt në pasditen gri dhe fushat e zbehta të vjeshtës u përhapën në të dy anët e trasesë nën retë e përhimta. Në qiell varej një disk i mërzitshëm portokalli, dielli.

“Ajri është aq i rëndë dhe me tym!” bërtiti Maria. ”Nuk e kam parë kurrë më parë diellin me një ngjyrë kaq të çuditshme.”

“Janë zjarret e pyjeve”, u përgjigj gruaa, “Gjithmonë fryn tym nga veriu në këtë stinë të vitit . Do të shohim këtë fenomen edhe më shumë në të ardhmen.”

Një shtëpi prej druri me dritare të gozhduara paraprakisht u shfaq pranë peronit dhe u zhduk pastaj në horizont. Pse ajo shtëpi atje është aq e largët nga bota?

“Nuk është shtëpi. Dikur ishte stacioni i parë në itinerar, por tani përdoret aq rrallë sa është mbyllur. Ky udhëtim është bërë linjë e shpejtë.”

E përkundur nga lëvizjet ritmike të rrotave, Maria hodhi shikimin nga dritarja. Në njërën nga fushat ajo pa një dordolec. Dy shkopinj të kryqëzuar, dhe poshtë tyre ca gjethe të kalbura misri. Palltoja e vjetër dhe e errët lëvizte nga era, e zbrazur, pa përmbajtje. Poshtë figurës qesharake , sorrat e zeza kërcenin, duke kërkuar kokrra misri në tokën e thatë.

Treni lëvizte tutje. “Mendoj të pi një filxhan kafe në restorantin e trenit”, tha gruaa dhe pastaj iu drejtua Marisë: dëshiron të vish?

“Po , sigurisht,” u përgjigj ajo. “Edhe dua t’ i shtrij këmbët paksa.”

Ato u ngritën dhe ecën përgjatë korridorit deri te vagoni tjetër. Ishte vagoni ku pihej duhan dhe ajri i dendur i thumbi sytë Marisë. Pranë dritareve ishin vendosur tavolina lojrash, ku shumica e burrave luanin poker. Kamarierët veshur me pallto të bardha shërbenin pije me tabaka. Në sfond dëgjohej zhurma e të qeshurave të forta dhe kërcitja e copave të akullit tek hidheshin nëpër gota. “Në radhë është vagoni i restorantit”, thirri gruaa mbi supe. Ajo e shtyu derën, u përvodh nëpër korridorin lëkundës midis dy vagonëve dhe hyri në tjetrin vagon, me Marinë ngjitur pas shpine. Në shezlonet e kuqe prej pelushi, klientët e restorantit mbështeshin rehat nëpër karriget e tyre derisa hanin mollë, kumbulla dhe rrush nga kupat me fruta nëpër tryezat e drunjta e të lëmuara . Muzika qetësuese e darkës dilte nga një fortafolës i fshehur diku në mur. Gruaja u ndal në një tavolinë për dy veta dhe i bëri shenjë Marisë që të ulej.

“Çfarë doni të porosisni?” pyeti kamerieri i zi me kostumin e tij të bardhë. Stilolapsi i pushonte në dorë mbi bllokun e shënimeve. Maria as që e kishte vënë re se ai ishte aty. Ai

kishte nga një gotë ujë me akull për secilën .

“ Do të doja një gotë me ale xhinxheri , “ tha Maria.

“Për mua një pije të zakonshme,» buzëqeshi gruaa .

“Sigurisht... kafe, krem dhe sheqer.” Kamerieri i zi i buzëqeshi gruas dhe shkarraviti diçka të palexueshme në bllokun e tij.

Porosia erdhi. Marisë ia shërbyen kafën me xhenxhefil në një filxhan të gjelbër prej porcelani të laseruar, me fluska të vogla argjendi, në një gotë të hollë e të gjatë dhe një qershi e kuqe vënë në fund të gotës.

“Sa e bukur! tha Maria. “Nuk jam ulur kurrë më parë në një restorant treni. Duket kaq luksoz.”

“Po,” u pajtua gruaa ndërsa ngrohte duart duke shtrënguar filxhanin e pijes që po avullonte. “ Po, ata bëjnë çmos për ta bërë udhëtimin sa më të këndshëm.”

Maria u ndje e relaksuar, piu me gllënka të vogla nga gota. Në vagonin me ndriçim të zbehtë, sediljet e veshura me tapiceri morën një ngjyrë të kuqe të ngrohtë dhe muzika vazhdoi në një rrjedhë të qëndrueshme nga altoparlanti i fshehur. Maria piu pikat e fundit nga aleja me xhenxhefil, pastaj e ktheu gotën anash derisa qershia u rrokullis në dorën e saj. E futi në gojë dhe e kafshoi frutin e ëmbël.

Jashtë dritares, dielli hyri në një përfundim të brustë. Dukej më i vogël se kur Maria e kishte parë për herë të fundit dhe ngjyra e tij kishte lëvizur nga portokallja në një të kuqe më të theksuar.

“O Zot, sa shpejt u bë vonë,” vuri në dukje Maria derisa shikoi peizazhin e shkretë, të zymtë. “

Vështirë se e vëmë re sa shpejt kalon koha në këtë udhëtim”, u pajtua gruaa. “Është shumë rehati këtu në tren. Por ne sapo kaluam ndalesën e pestë të rrugës dhe kjo do të thotë se së shpejti do të kalojmë nëpër një tunel të gjatë. Të kthehemi në vagonin tonë?”

“Po. Ta bëjmë pagesën tani?»

“Jo”, u përgjigj gruaa. “ Ata e shënojnë shumën në faturën tuaj në fund të udhëtimit.”

Ajo u ngrit në këmbë dhe filloi të kthehej, me kujdes se ku po i lëshonte këmbët, hap pas hapi nëpër vagonët e trenit që lëvizte me shpejtësi.

Pasi u kthyen në vendet e tyre, gruaa vazhdoi të thurte, kurse Maria vështronte fushat sterile jashtë. Në pjesën e pasme të trenit, një foshnje filloi të bërtasë, e lodhur dhe e pakënaqur. Tre afaristë erdhën nga vagoni i koktejeve, duke u lëkundur në takt me lëvizjen e trenit, duke qeshur. Dritat në tavan ishin yje të mëdhenj ndriçues.

“Dreq fëmijë”, - tha një burrë.

“Shumë e vërtetë”, tha tjetri. Dhe nën kapelet e tyre gri, të tre burrat dukeshin njësoj. Duke u lëkundur dhe duke i shtyrë të tjerët, ata kaluan nëpër korridorin e trenit dhe foshnja vazhdoi të bërtiste sikur do të bërtiste përjetësisht.

Treni pastaj hyri në një tunel tjetër nëntokësor. Gurë të errët shfaqeshin pa zë para dritares dhe rrotat e trenit kafshonin si akrepat e një ore gjigante.

Një shitës hapi derën e vagonit dhe doli ngadalë në korridor, duke bërtitur : “Kamele, kokoshka, shqeme... Kamele, kokoshka, shqeme, këtu është ...»

“Prit,” tha gruaa, hapi çantën e saj ngjyrë kafe dhe nxori një kuletë të vjetruar. “Dua të blej një tortë me çokollatë, na bënë mirë...”

“Ah, jo,” protestoi Maria. “Ju lutem më lejoni të paguaj unë”

“As që bëhet fjalë, mikja ime,” tha gruaa.

“ Tani jam unë që ju qeras. Çokollata do t’ju bëjë mirë. Përveç kësaj, ju do të paguani mjaft në fund të udhëtimit.”

Shitësi ndaloi në kupe, ngriti kapelën e tij të kuqe prej monitori dhe futi gishtat e mëdhenj në jelekun e mëndafshhtë me vija të kuqe e të bardha.

“Çfarë dëshironi?” tha ai mekanikisht dhe me një zë monoton. “Kemi ...” Ai bëri një pauzë, shikoi gruan dhe pastaj shpërtheu në një të qeshur të ngjirur .

“Bën përsëri të njëjtin udhëtim?”

Ai uli zërin në një pëshpëritje të fshehtë. “Nuk ka asgjë për të marrë këtu, e di. Gjithçka tashmë është e kryer”.

“Mos ji aq i sigurt, Bert,” buzëqeshi gruaja me dashamirësi. “Edhe një kontabilist mund të gabojë ndonjëherë .”

“Një kontabilist ndoshta, por jo shefi.”

Berti tundi çantën e zezë të monedhave dhe buzëqeshi. “Shefi ka rregulluar gjithçka. Personalisht, këtë herë, personalisht .”

Gruaja qeshi e gëzuar.

“Po, mund ta marr me mend, duke marrë parasysh gabimin që bëri ai në udhëtimin e fundit, kur bëri që trenat të takohen mbi tokë. Ai kurrë nuk do t’i largonte të gjithë ata njerëz nga kopshtet nëntokësore tani, edhe po të përpiquej. Vrapuan drejt oborreve si fëmijë, të gëzuar si lauresha. A mendoni se do t’i binden atij dhe do të kthehen në tunelin e nëndheshëm ku e kanë vendin? Kurrën e kurrës”

Berti nënqeshi si majmun.

“Po,” tha ai në heshtje. “Po, supozoj se një përqindje mund të shkoj gabim ndonjëherë.”

“Prandaj jam këtu”, tha gruaja. “Po marr një tortë me çokollatë.”

“Të madhe apo të vogël?”

“Të madhe,” u përgjigj gruaja duke ia zgjatur një monedhë .

“Epo, lamtumirë tani,” tha Berti dhe vuri dorën mbi kapuç. “Suksese,” dhe pastaj vazhdoi në korridor, duke iu kthyer numërimit të tij monoton: “Kamele, kokoshka, shqeme...”

“I gjori Bert,” i tha gruaja Marisë teksa ajo përpiquej të hapte çokollatën pa e grisur mbështjellësin e brishtë prej argjenti. “ Ai dëshiron shumë që të flasë me dikend gjatë turnit të tij. Është një udhëtim kaq i gjatë sa që vështirë se dikush mund ta bëjë du herë.”

Ajo e preu një copë të madhe të tortës me çokollatë dhe ia dha Marisë. Era e çokollatës ishte e ëmbël dhe e këndshme.

“Mmm,” tha Maria. “Ka aromë të mirë.» Ajo kafshoi një copë dhe e mbajti në gojë që t’ i shkrihej nën gjuhë, duke shijuar ëmbëlsinë e çokollatës së shkrirë duke e përtypur ngadalë në fyt.

“Duket se ju dini shumë për këtë tren,” i tha Maria gruas. “A udhëtoni shumë?”

“Oh, po. Unë kam udhëtuar andej-këtej për aq kohë sa mbaj mend. Por këtë udhëtim e bëj më shpesh.”

“Nuk më habit. Vërtet *është* një udhëtim i rehatsëm. Kanë kaq shumë gjëra shtesë, gjëra të vogla si p.sh pijet freskuese çdo orë, dhe barin e koktejeve në dhomën e lojërave dhe shezlonget në vagonin e ngrënies. Është aq komod pothuajse si në ndonjë hotel.”

Gruaja i hodhi një vështrim të shpejtë. “ Po, mikja ime, - tha ajo ftohtë, “ por mos harro se po paguani për këtë. Ju paguani për këtë në fund. Kjo është ideja e tyre e biznesit për ta bërë udhëtimin tërheqës. Kompania e trenit ka më shumë se sa një interes thjesht miqësor për pasagjerët e saj”.

“Me siguri ke të drejtë,” pranoi Maria duke qeshur. “ Nuk e mendova kështu. Por më thuaj, si do të jetë kur të zbresim? Nuk e kam idenë. Nuk ka asgjë në broshurat e udhëtimit për motin, apo njerëzit në veri, asgjë fare.”

Gruaja u përkul dhe vazhdoi të thurte, papritmas me përqendrim maksimal. Kishte një nyjë në fjetet. Shpejt e zgjidhi nyjen dhe vazhdoi thurjen.

“Pra, ju do të udhëtoni gjatë gjithë rrugës, nëse e interpretoj saktë,” tha ajo.

“Ashtu është, gjithë rrugën. Babai më tha se s’kam pse të shqetësohem për lidhjet apo diç tjetër , dhe se konduktori do të më tregoj rrugën kur të mbërrij.»

“Stacionin e fundit,” mërmëriti gruaja. “A je e sigurt?”



“Po. Të paktën kështu shkruan në biletën time. Është një biletë kaq e veçantë sa më kujtohet numri, i kuq në të zezë. Mbretëria e Nëntë, shkruan aty. Gjë qesharake të emërtosh kështu një stacion treni”

“Njeriu mësohet pas një kohe ”, tha gruaja, sikur të fliste me veten e saj. “Dhe në të gjitha repartet e vogla, nënrepartet dhe sektionet. Arbitrare, ja kjo është. Arbitrare. Por askush nuk duket se e kupton këtë tani. Një lëvizje e vogël, një gjest vendimtar dhe e gjithë struktura do të shembej, do të rrënohej plotësisht”.

“Nuk e kuptoj mirë se ç’ do të thuash me këtë,” tha Maria.

“Sigurisht që jo, sigurisht që jo, mikja ime . E harroj plotësisht veten. Flas aq çuditshëm . Por më thuaj, tani që je ulur këtu, a ke vënë re ndonjë gjë të pazakontë te njerëzit në këtë tren?”

“Asgjë,” tha Maria ngadalë, duke parë përreth . “Asgjë,” përsëriti ajo e hutuar. “Mendoj se duken krejt të zakonshëm.”

Gruaja psherëtiu. “Mendoj se thjesht jam tepër e ndjeshme”, tha ajo.

Dritat e kuqe të neonit vezulluan jashtë dritares , treni u ngadalësua dhe frenoi në stacionin e Mbretërisë së Gjashtë. Dera e vagonit u hap dhe hapat e konduktorit lëvizën në drejtim të një gruaje me buzë të lyera me të kuqe disa ulëse përpara. Ajo u zbeh në fytyrë dhe tërhoqi pallton, u struk në ndenjësen e saj.

“Jo akoma,” tha ajo. “Ju lutem, jo këtu. Nuk zbres këtu. Më lër të shkoj pak më tej.”

“Të shoh biletën tuaj,” tha konduktori dhe gruaja i lyu buzët e saj, gjak të kuqe.

“E kam humbur. Nuk mund ta gjej” - tha ajo.

“E ke në gishtin tregues të dorezës së djathtë, - tha konduktori me zë një zë mbytur, - aty ku e fshehe kur hyra unë “

E inatosur, gruaja hoqi dorezën nga dora e djathtë, nxori biletën e mbështjellë me letër të kuqe dhe ia zgjati konduktorit. Ai e shpoi biletën me pincë, e grisi dhe ia dha asaj copën më të vogël.

“Bileta juaj për të kaluar lumin,” tha ai. “Mendoj se është më mirë të zbresësh tani.”

Gruaja nuk u përpoq të ngrihej. Konduktori zgjati dorën dhe e kapi për krahu. “ Fatkeqësisht, duhet të zbresësh tani” tha ai. Ne nuk mund të sillemi me përkëdheli në këtë tren. Kemi një orar për të

ndjekur. Kemi një kuotë fikse pasagjerësh.”

“Po vij,” mërmëriti gruaja. “Por më lësho krahun. Më dhemb. Më djeg.”

Ajo u ngrit në këmbë dhe shkoi drejt derës, me fundin e saj të purpurt prej leshi që i tundej këmbëve, krenare dhe sfiduese. Jashtë trenit , në platformë, e prisnin dy roje stacioni. Në shkëlqimin e kuq të dritave të neonit, ata morën gruan, secili në njërën anë dhe u zhdukën përmes daljes së hekurt. Konduktori hyri përsëri në tren, e fshiu ballin me një faculetë të madhe mëndafshi të kuqe. Ai u ndal në kupenë e Marisë dhe i buzëqeshi gruas. Sytë e tij ishin të zinj, pa fund, por tani me një nyancë të qeshure të ftohtë.

“Zakonisht nuk kemi shumë probleme me pasagjerët kur është koha që të zbresin” , i tha gruas.

Ajo i ktheu buzëqeshjen, por zëri i saj ishte i brishtë, i trishtuar. “Jo, zakonisht ata nuk protestojnë fare. Vetëm e pranojnë kur është koha e duhur.”

“Pranojnë çfarë?”

Maria i shikoi të dy me kureshtje , iu kujtua fytyra e tmerruar e gruas bjonde , buzët e saj të lagura, të qarta, të kuqe si gjaku.

Konduktori i shkeli syrin gruas dhe eci tutje poshtë rreshtit, me fenerët që ndriçonin në mbajtëset e llambave në mur si qirinj dhe me tavanin metalik lart. Drita e neonit nga stacioni depërtoi përmes dritareve, duke i ngjyrosur për një kohë të shkurtër fytyrat e pasagjerëve me ngjyrë të kuqe të ndezur. Menjëherë pas kësaj, treni u nis.

“Pranojnë çfarë?” vazhdoi Maria. Një drithërimë ia përshkoi trupin, sikur një erë e ftohtë ta kishte përfshirë papritur.

“Ke të ftohtë, zonjë?»

“Jo,” tha Maria. “Pranojnë çfarë?” “Destinacionin,” u përgjigj gruaja, duke marrë thurjen nga prehri dhe duke vënë një lëmsh të ri të gjelbër. Me një lëvizje të zakonshme, ajo futi gjilpërën në lëmshin në rritje, kapi një lak dhe e la të rrëshqiste. Maria vëzhgoi duart e shkathëta dhe të shpejta të gruas.

“Udhëtarët blejnë biletat e tyre”, vazhdoi gruaja duke numëruar në heshtje qepjet në gjilpërën e thurjes . “Ata blejnë biletat e tyre dhe janë vetë përgjegjës për të zbritur në stacionin e duhur... Ata zgjedhin trenat,

peronët dhe udhëtojnë për në destinacionin e tyre.”

“E di. Por ajo grua. Ajo dukej aq e frikësuar.”

“Po, ndonjëherë ndodh kështu me pasagjerët. Ata duan të zbresin në sekondën e fundit, e kupton. Pendohen që kanë blerë biletën, por edhe e kuptojnë me vonesë. Pendimi nuk ndihmon. Ata duhet ta kishin menduar vendimin e tyre shumë më herët.”

“Ende nuk e kuptoj pse nuk u lejua të ndryshonte mendje dhe të mos zbriste. Ajo mund të paguante më shumë në fund të udhëtimit.”

“Kompania e trenit nuk e lejon këtë në këtë rrugëtim”, tha gruaja. “Do të krijohej konfuzion.”

Maria psherëtiu. “Pjesa tjetër e pasagjerëve duken të kënaqur megjithatë.”

“Po, kështu është. Mu kjo është e frikshme.”

“E frikshme?” Maria ngriti zërin. “Si e frikshme?. Tani thua gjëra që tingëllojnë kaq misterioze.”

”Në fakt është mjaft e thjeshtë. Pasagjerët janë aq indiferentë, aq apatikë sa nuk u intereson as ku shkojnë. Ata nuk do të brengosen derisa të vijë koha e duhur, për në Mbretërinë e Nëntë”

“Por çfarë është Mbretëria e Nëntë?” pyeti Maria e indinjuar.

Shprehja e saj e fytyrës ishte mbushur me shqetësim, sikur do të fillonte të qante. “Çfarë është kaq e tmerrshme në Mbretërinë e Nëntë?”

“Qetësohuni, qetësohuni, — e ngushëlloi gruaja, — merrni pak më shumë çokollatë. Nuk mund t’i ha të gjitha vetë.”

Maria mori një copë dhe e futi në gojë, por ndjeu një shije të hidhur në gjuhë.

”Më mirë të mos e dini, - tha gruaja me zë qetësues . “Mbase, nuk është aq keq atje. Udhëtimi është shumë i gjatë nëpër tunel dhe klima ndryshon gradualisht. Dhimbja nuk është aq intensive kur mësoheni me të ftohtin. Shikoni nga dritarja. Në muret e tunelit ka filluar të krijohet akulli dhe askush nuk e ka vënë re dhe as nuk është ankuar.

Maria ktheu shikimin nga dritarja dhe pa muret e zeza që shfaqeshin dredha-dredha. Ca vija gri akulli u shfaqën midis të çarave të gurëve. Sipërfaqja e ngrirë mbërthente dritën nga vagoni i trenit dhe shkëlqente sikur të ishte mbuluar me gjilpëra të ftohta argjendi.

Maria u rrënqeth. “Kurrë nuk do të udhëtoja po ta dija. Nuk do të qëndroj këtu. Nuk e bëj”, - tha ajo.”Do të marr trenin tjetër menjëherë.”

“Nuk ka trena kthimi nga kjo rrugë,” tha gruaja. “Sapo të arrini në Mbretërinë e Nëntë, nuk ka kthim prapa. Është mbretëria e mohimit, mbretëria e vullnetit të ngrirë. Ka shumë emërtime për këtë.”

“Nuk më intereson. Do të zbres në stacionin tjetër. Nuk do të qëndroj në tren me gjithë këta njerëz të tmerrshëm . Nuk e dinë se ku shkojnë?. Nuk ju intereson?”

“Janë të verbër, — tha gruaja me sytë e ngulur nga Maria. “Të gjithë janë krejtësisht të verbër.»

“Po ti,” bërtiti Maria duke kthyer me zemërim fytyrën kah gruaja, “edhe ti duhet të jesh e verbër!”

Zëri i saj tani ishte i lartë dhe i mprehtë, por askush nuk reagoi. Askush nuk ktheu kokën për ta shikuar.

“Jo,” tha gruaja, befas me një zë të dashur, “nuk jam e verbër”. As e shurdhër. Por më rastisi ta kuptoja se treni nuk do të ketë më ndalesa. Nuk janë planifikuar ndalesa të tjera derisa të arrijmë në Mbretërinë e Nëntë.

“Por ti nuk e kupton.” Maria vuri duart mbi faqe dhe filloi të qante. Lotët e nxehtë i rrodhën mes gishtërinjëve. “Ti nuk e kupton. Nuk është faji im që jam në këtë tren. Është

Më thuaj, si e shikoni poezinë në jetën e përditshme?

Të mos kemi pretendime, jeta është një cirk brutal, shpesh jemi të rrethuar nga katastrofa më të mëdha ose më të vogla. S'ka nevojë ta dekorojmë këtë me poezi dhe metafora. Ne të gjithë luftojmë kundër çmendurisë së zakonshme që kërcënon të pushtojë jetët tona dhe të përmbysë universin, ndërkohë që lumturia shkon dorë për dorë me brengën dhe mjerimin, monstat brejnë vazhdimisht derën e qilarit dhe fëmijët vallëzojnë nëpër rrugë me pritshmëri të forta. Këto elemente janë kushtet normale për poezinë. Ja ku jemi, ky është dheu ku rritet poezia.

Çfarë mendoni se duhet të jetë qëndrimi i poetit për problemet sociale, luftën, mjedisin, varfërinë, ekonominë, etj?

Të shërbyerit është kundër natyrës së poezisë. Ky nuk është obligim, por poeti natyrisht duhet të jetë i përfshirë në problemet aktuale për aq shumë sa mundet, si të gjithë qytetarët e tjerë. Nëse shkrimtari dëshiron gjithashtu të përfshijë edhe poezinë e tij, kjo varet nga fokusi, talenti dhe mundësitë. Letërsia kurrë nuk mund të jetë agjitacion, në thelbin e saj poezia refuzon çdo kapje për fyti. Poezia para së gjithash duhet të jetë art, kjo është një çështje për jetë a vdekje. Por pastaj në poezinë e mirë mbi çdo lloj teme gjithmonë do të ketë nënrryma humanizuese- të shprehura ose të nënkuptuara- një angazhim kundër shfrytëzimit social, dhunës dhe të gjitha llojeve të së keqes politike apo shkatërrimit të natyrës dhe planetit.

Çfarë mendoni për kultin aktual të shëndetit dhe trupit që paragjykon njerëzit të cilët kanë preferencat dhe zakonet e tyre në botë? Cigaret, alkoli, etj.

Vdekja është tabu. Shëndeti fizik duket të jetë feja zyrtare me trupin si një tempull për adhurim. Shpresa për një nirvana tokësore dhe një lumturi të përjetshme është një iluzion laik. Një fantazi e brishtë, ja pse misionarët duhet të jenë kaq fanatikë. Le të bashkëjetojmë me to dhe të shpresojmë se asketizmi dhe heqja dorë nga dëshirat personale dhurojnë jetë të amëshuar. Fatkeqësisht, kam frikë se jemi të gjithë në një mision vetëvrasës.

Si mund ta zbulojmë që dikush e ka këtë “sëmundje të lemerishme” siç e kanë quajtur poezinë? Cilët janë simptomat që e karakterizojnë?

Disa nga miqtë e mi janë shumë të tronditur rreth këtij formulimi, jo të gjithë poetët janë të pajisur me një sens humorit. Por fakt është që pasioni ynë për poezinë është një neveri e tmerrshme, ne e kalojmë kohën duke gjuajtur fjalë – shpesh unë neglizhoj të bërit e gjërave më të dobishme me qëllim që të vras mendjen për misteret e jetës, me shpresën e kapjes së një mendimi apo artikulimi në fluturim. Simptomat janë të shumta, ne jemi antisocialë, dhe shpesh ndërmjet një vështrimi të hutuar dhe aktiviteti të ethshëm. Pak vetëironi është e nevojshme.

A besoni se poezia duhet të përqendrohet tani më shumë në jetën e përditshme, duke lënë abstraksionin e ideve të mëdha?

Çdo poet duhet të gjejë rrugën e vet në rrjedhë dhe ai që shkruan për çfarë i ndodh atij natyrisht në rrjedhën e jetës së përditshme kaotike, është në gjurmë të mira. Detyra e poezisë është jeta e përditshme por unë nuk besoj se



Intervistë me poetin danez, Nga Julian Alejandro dhe I.C. Bermeo Gamboa, revista Phenomenal Literature, Nju Deli, Indi

NIELS HAV

Vdekja është Tabu

Përkthyer nga Kujtim Morina

poezia duhet të heqë dorë nga ndonjë gjë dhe kuptueshëm idetë e mëdha janë të nevojshme për të na udhëzuar në këtë epokë të konfuzionit elementar. Çfarë s'më pëlqen është kur poezia noton në sentimentalizëm abstrakt konvencional pa kontakt me realitetet e luftës për jetesë të njerëzve të zakonshëm. Liricizmi personal dhe emocionalizmi i pakontrolluar shpesh rrezikon ta mbysë poezinë.

Çfarë mendoni për rolin e institucioneve shtetërore në zhvillimin e kulturës, roli i shtetit për shkrimtarin dhe i shkrimtarit për shtetin?

Është e shëndetshme për poezinë- por mbase jo për poetin- të qëndrojnë në opozitë ndaj institucioneve politike dhe atyre në pushtet. Disa regjime e keqkuptojnë gjendjen dhe iu ofrojnë poetëve dhomë falas dhe ushqim në burg. Shumë bujare dhe plotësisht idioteshke. Është detyra e poezisë të jetë kritike ndaj qeverisë dhe detyra e shtetit të mbështesë dhe mbrojtë artin dhe kulturën, financiarisht dhe në çdo mënyrë të mundshme. Një shoqëri e shëndetshme ka nevojë për një dialog kritik. Udhëheqësit dhe politikanët e mençur e kuptojnë këtë. Kur libri “Les Fleurs du Mal” (Lulet e së Keqes) u botua, Charl Bodler u zvarrit në gjykatë dhe u akuzua për imoralitet dhe blasfemi. Kush ishte perandor apo president i Francës në atë kohë? Askush nuk e mban mend, politikanët rrëshqasin prapë në zonën e hijes ndërkohë që libri i Bodler qëndron si një kryevepër.

Ç'mendoni për kontributin e promovimit të kulturës në përmirësimin e një kombi?

Arti nuk duhet të mbështetet vetëm në një nivel kombëtar por edhe qytetet, rajonet dhe bashkitë duhet të kontribuojnë në mbështetjen e artit dhe kulturës. Bibloteka të mira publike, salla koncertesh, teatro, galeri arti, dhe të gjitha institucionet e tjera arsimore me radhë, janë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Kjo i forcon komunitetet dhe kontribuon në një klimë biznesi të shëndetshme dhe tërheqëse dhe kështu qytetet, rajonet dhe kombet do të lulëzojnë. Kultura është një investim i mirë. Gabriel Garsia Marquez ndoshta kontribuon më shumë për GNP (prodhimin e brendshëm bruto), për lumturinë dhe mirëqenien në Kolumbi sesa shumica e lordëve të drogës.

Cilët autorë ju kanë ndikuar?

Një prej poetëve të parë që ka pasur ndikim tek unë ishte Pablo Neruda. Kur isha adoleshent, pashë një program portretizues me të në television dhe u godita nga një ëndërr ngacmuese. Doja të bëhesha poet. Biseda jonë këtu më kujton rëndësinë e Nerudas në trurin tim të ngatërruar, ai është një mik i vjetër i njohur. Mjeshtër i madh, ai është unik. Në të njëjtën kohë, ndesha Dostojevskin në një libër shkolle. Por janë dyzina autorësh të tjerë që kanë ndikuar tek unë, çmoj Tomas Transtromer, Cezlav Milosh, dhe Elizabet Bishop dhe nëse duhet të përmend disa emra danezë, ata mund të

jenë Per Hojholt dhe Peter Seeberg.

A keni lexuar ndonjë autor kolumbian? A i vlerësoni autorët e gjuhës spanjolle? A keni lexuar ndonjë autor bashkëkohor?

Letërsia e Amerikës së Jugut shpesh vjen në Danimarkë me vonesë. Aktualisht po lexoj me kënaqësi romanin e fundit të Roberto Bolanos: “2666”. Kam lexuar disa prej poezive të tij të cilat gjithashtu i pëlqej. Kam një të metë që nuk jam në gjendje të lexoj spanjisht, është sporadike ajo që di nga shkrimtarët e kohëve të fundit. Ndërmjet klasikëve, çmoj Cesar Valejo, dhe Borgesin natyrisht. Kam shkruar një poezi për këtë të fundit dhe Xhojsin e cila huazon titullin nga Borges: Në Verbërinë e Tij.

Kujtoj Markezin. Gjithashtu Oktavio Paz, Albertin, Aleiksander dhe shumë të tjerë. Të mos harrojmë Julio Kortazar, për të cilin Neruda thotë: “Çdokush që nuk e lexon Kortazar është i paracaktuar të dështojë. Të mos e lexosh atë është një sëmundje e rëndë, e padukshme e cila në kohë mund të ketë pasoja të tmerrshme. Diçka e ngjashme me një njeri që nuk ka shijuar kurrë pjeshkën. Ai do të bëhet në heshtje më i trishtuar dhe ndoshta pak nga pak, do të fillojnë t'í bien flokët.” Fatkeqësisht pak është përkthyer Kortazar në danisht, ne jemi në zonën e riskut për të humbur flokët.

Cila është një prej fjalëve në danisht që e preferoni? (Lutem jep kuptimin në anglisht të fjalës dhe na thuaj për të)

Lëkundem ndërmjet fjalëve *ømhed* dhe *sødme*. Le të zgjedh *sødme*. Nuk është vetëm ëmbëlsia por që dikush ose diçka është duke të hyrë në zemër apo prekur me personalitetin, sjelljen apo pamjen- gjithashtu do të thotë një shije apo aromë e ëmbël. E çmoj kur njerëzit e kanë këtë cilësi.

Ka një paragjykim që i konsideron nordikët si pak të shprehur lidhur me afeksinin ndërpersonal. Çfarë mund të na thuash për këtë?

Si të gjithë paragjykimet, kjo ndoshta ka një të vërtetë të tmerrshme që përpiqemi ta heqim qafe por digjet brenda të gjithë skandinavëve- prapa një fasade të ftohtë- ka një zjarr të nxehtë që ulërin. Kështu që ki kujdes mos digj buzët, të lutem.

Në një shoqëri si juaja, në të cilën ka një përputhje mes shtetit dhe njerëzve, ku niveli i kulturës është nga më të lartat, një shoqëri qytetare dhe paqësore, ju si poet çfarë do të kritikoni për këtë sistem?

Tashmë edhe Shekspiri ishte i vetëdijshëm për të, diçka është kalbur në shtetin e Danimarkës. Dhe ende sot, jo çdo gjë është e përkryer. Së bashku me Bashkimin Evropian dhe pjesën tjetër të botës, jemi në mes të krize, administrata jonë aktuale ka një tendencë për t'ía shitur faturën të dobët dhe të varfërit dhe të transferojë fitimet tek të pasurit. Një Robin Hud i kundërt. Aktualisht ka një orvatje të pështirë për të minimizuar emigracionin e refugjatëve nga pjesët më të paprivileguara të botës.

Çfarë mendimi keni se një nga karakteret kryesore në veprat e Shekspirit dhe të gjithë letërsisë ishte një princ danez i quajtur Hamlet?

Një pyetje interesante. Shekspiri kishte një aftësi fabuloze për të gjetur lëndë për tragjeditë e mëdha dhe për të shprehur emocionet njerëzore me

fjalë të thjeshta dhe të thella. Ai mund të ketë takuar danezë në Londër që i kanë treguar atij për princin mistik. Çmenduria e Hamletit dhe melankolia e Ofelisë- mbase mishërojnë veçoritë esenciale daneze por njerëzit kudo në planet gjejnë aspekte të vetes së tyre në këto karaktere. Jemi të gjithë të mbërthyer nga këto dilema të paepura: “Të jesh a të mos jesh, kjo është çështja”.

Në vendet e Amerikës Jugore, po marrim si rast Kolumbinë, ka një lexim prej 1.6 librash në vit për person, një shifër minimale krahasuar për shembull me leximet vjetore në vendet nordike. Megjithë këto tregues, ne kemi lexuesit dhe poetët tanë këtu, Kujt do t’ia atribuonit këtë që në këto shoqëri të varfra pavarësisht nga këta tregues, ekzistojnë lexuesit dhe poetët?

E di që realiteti kolumbian është i komplikuar dhe prapë ju keni lexues entuziastë dhe poetë të fortë që punojnë intensivisht për ta rishpikur poezinë dhe ridefinuar identitetin kulturor të Kolumbisë. Kam respekt për këtë. Shpresoj se qeveria juaj do të gjejë mënyrat për të mbështetur këto synime, veçanërisht në kombet me një poezi të tillë të pasur dhe diverse që mbase mund të përbëjnë një fenomen unik. Shpresoj që në të ardhmen të kem mundësinë të mësoj më shumë për poezinë kolumbiane. Ky kontinent ka një rëndësi në rritje në ekonominë globale, dhe letërsia e Amerikës Jugore mund të ketë shumë për të ofruar në vitet e ardhshme.

Në vende si juaji, ku shteti subvencionon njerëzit që i janë kushtuar letërsisë, dhe shkrimtarët marrin pensione, kultura është një alternativë. Kolumbia nuk ka diçka të tillë. Si do t’i inkurajonit të rinjtë që dëshirojnë të shkruajnë poezi në këto vende?

Mbase këshilla më e mirë për t’i dhënë një shkrimtari të ri në këto rrethana do të ishte të kryente vetëvrasje. Shumë prej nesh ndoshta e kanë konsideruar këtë mundësi por kanë ngurruar paksa. Një këshillë e imja: prit pak. Dil për një shëtitje, luaj me fëmijët, tako miqtë, puth kur të vijë shansi. Për më tepër, shkruaj, shkruaj, shkruaj më të mirën që mundesh. Mbase do të ndodhë një mrekulli që e gjitha kjo të mos shkojë më kot. Në çdo rast, kjo është e gjitha që mund të bëjmë. Le të përgjigjem me një poezi:

Nxitje

A nuk është një mendim shpresëdhënës
Që brenda disa dekadave, ne
Dhe e gjithë kjo epokë konfuze
Me presidentët e saj cinikë
Argumentet e bjerra
Prezantueset e spitulluara të
televizionit, gazetarët mediokër
Dhe i gjithë kori jubilar kapitalist
Të ikin,
Për të gjithë kohën!
Ne do të zhdukemi
Ata do të zhduken
Unë do të zhdukem
Ju do të zhdukeni
Do të zhduket gjithçka
Urra!

Phenomenal Literature është një revistë e printuar gjashtëmujore kushtuar gjuhës, letërsisë dhe shkrimeve letrare. Është botim i Authorspress, Nju Delhi, Indi.

27 qershor 2024

(Vijon nga faqja 21)

faji i prindërve të mi. Ata donin që ta merrja këtë udhëtim.”

Por ti i lejove ata të prejnë biletën për ty, theksoi gruaja. “I le të të hipin në tren, apo jo? Ti pranove dhe nuk rezistove.”

“Megjithatë nuk është faji im,” protestoi Maria me zë të lartë, por përballë e kishte vështirimin qortues të gruas dhe Maria e ndjeu si po zhytej në turp. Kërcitja e rrotave mbi binarë bënte që gjykimi të zinte rrënjë në trurin e saj. Faji, regëtimja e rrotave të trenit si zogj të zinj e të rrumbullakët, faji, faji, faji.

Faji, tha kërcitja e grepave të thurjes në duart e gruas .

“Ti nuk e kupton”, filloi përsëri Maria. “Ju lutem më lejoni t’ua shpjegoj. U përpoqa të qëndroja në shtëpi. Në fakt nuk doja të udhëtoja fare. Madje edhe kur isha në stacion doja të kthehesha në shtëpi.”

“Por nuk e bëre,” tha gruaja dhe ndërsa mori një rrjetë fijesh jeshile pa sytë e saj të trishtuar. “Ju zgjodhët të mos ktheheshit dhe tani nuk mund të bëni asgjë për këtë.”

Maria menjëherë u ul drejt dhe e shikoi gruan mes lotëve.

“Po, sigurisht që ka!” tha ajo me kokëfortësi. “Ka ende diçka që mund të bëj. Kam ndërmend të zbres, sa ka ende kohë. Kam ndërmend të tërheq frenin e urgjencës.»

Gruaja papritmas i buzëqeshi Marisë, dhe sytë e saj shkëlqyen nga admirimi. “Aha”, pëshpëriti ajo, “mirë. Ju jeni trime. E keni kuptuar. Është truku i fundit që ka mbetur. E vetmja shprehje e vullnetit që ka mbetur. Mendova se edhe kjo ishte e ngrirë . Tani ekziston një mundësi.”

“Çfarë mendoni?”. Maria u tërhoq me dyshim. “Çfarë kuptoni me një mundësi?”

“Një mundësi për të ikur. Tani dëgjoni me kujdes, po i afrohem stacionit të shtatë. Unë e njoh mirë këtë udhëtim. Ka ende kohë. Unë do t’ju them kur është momenti për të tërhequr frerin e urgjencës dhe pastaj duhet të vraponi. Platforma në stacion do të jetë e shkretë. Ata nuk presin të ketë pasagjerë që zbresin apo hipin në këtë tren.”

“Nga e dini këtë? Si mund t’ ju besoj?”
“Oh, fëmijë mosbesues.” Zëri i gruas tani ishte plot butësi. “Kam qëndruar pranë jush gjatë gjithë kohës. Por nuk mund të të thoja asgjë. Nuk mund të të ndihmoja para se vetë të merrje vendimin e parë vendimtar. Kjo është një nga rregullat.”

”Rregullat, çfarë rregullash?”
“Rregullat në dokumentin e kompanisë së trenave. Çdo kompani duhet të ketë rregulla, e dini. Disa dispozita për të funksionuar gjërat .”

Gruaja vazhdoi. “Po i afrohem stacionit të Mbretërisë së Shtatë. Ju duhet të shkoni në pjesën e pasme të trenit. Askush nuk do t’ ju shoh. Tërhiqni frenat që andej dhe mos

hezitoni, pavarësisht se çfarë do të ndodh. Vetëm vrapo.”

“Po ju?” pyeti Maria. “Nuk do të vini me mua?”

“Unë? Unë nuk mund të vij me ju. Duhet vetë të frenoni, por të jeni e sigurt, ne do të shihemi së shpejti.”

”Por si? Nuk e kuptoj si. Ju thatë se nuk ka tren kthyes. Thatë se askush kurrë nuk mund të largohet nga Mbretëria e Nëntë.”

“Ka përjashtime”, tha gruaja duke buzëqeshur. ” Unë kam nevojë të ndjek të gjitha rregullat. Vetëm të vetëkuptueshmet. Por ju duhet të nxitoni. Stacioni po afrohet dhe tani është koha.“

“Prisni, vetëm një moment. Më duhet të marr valixhen time. Kam të gjitha gjërat persinale në të.

“Lëre valixhen,” e udhëzoi gruaja . Nuk ju duhet. Do të ishte vetëm pengesë për ju. Por mos harroni, vraponi, vraponi si era.”

Ajo uli zërin. “ Do të shihni një daljen e ndriçuar mirë. Mos e merrni atë. Ngjituani shkallëve, edhe nëse është errët, edhe nëse ka hardhuca atje. Më premton, se do të marrësh shkallët?”

“Po,” tha Maria, duke u ngritur në këmbë dhe duke ecur pranë gruas, jashtë në korridor. “Po.”

Ngadalë ajo filloi të shkonte në fund të trenit. Askush nuk e shikoi . Në fund të korridorit, ajo u afrua tek dorëza, ku shkruante “Freri i Urgjencës” , e shtrëngoi dhe e tërhoqi. Menjëherë filloi një alarm i tmerrshëm , duke e thyer heshtjen. Maria hapi derën e kupesë dhe u rrëzua midis dy kupeve . Një zhurmë kërcitëse e frenave, një fërkim i metalit me metal, një lëkundje e fuqishme dhe treni ndaloi.

Ishte platforma e Mbretërisë së Shtatë, dukej e shkretë. Maria ngjiti të tre shkallët me një kërcim dhe ndjeu një dhimbje nën shputat e këmbëve ndërsa shkeli betonin. Tani u dëgjuan britmat e konduktorëve nga treni.

“Ron, çfarë ndodhi?”
Zëri ishte i vrullshëm. Shkëlqimi i elektrikëve të kuq të dorës u përhap nëpër vagona.

“ Çfarë ndodhi pra? Mendova se ishe ti.”
Më tej ishte një dalje, plot me drita neoni të kuqe që shkëlqenin. Dhe nga larg dëgjohej një xhaz i sinkopuar, joshës. Jo, nuk duhej të shkonte kah dalja. Në të djathtë, në një shkallë të pandriçuar, kërcënuese dhe të ngushtë. Maria shikoi dhe pastaj vrapoi drejt saj, me jehonën që vinte nga muret e gurma. Në krahëror

frymëmarrja i vinte e sforcuar, e fuqishme dhe e dhimbshme. Thirrjet u bënë më të forta.

“Shiko! Është një vajzë. Ajo po ikën! “Kapeni shpejt!» Drita e kuqe i vinte pas, afrohej gjithnjë e më shumë.

“Shefi do t’na pushojë nga puna nëse humbasim një shpirt të vetëm në këtë

udhëtim!”

Maria u ndal për një sekondë në shkallë dhe shikoi prapa. Dritaret e trenit ishin katrorë me fije të praruara dhe fytyrat që shikonin jashtë ishin të mërzitura, të zbehta, formale. Vetëm konduktorët vrapuan shpejt pas saj , me fytyrat të skuqura nga dritat e neonit, duke tundur elektrikët e tyre ndriçues.

Një britmë që i ngeci në fyt. Ajo ktheu vështirimin sërish nga shkalla e errët dhe e pjerrët dhe filloi të vraponte lart. Një rrjetë merimangeje iu ngjit në faqe, por ajo vazhdoi vrapin, duke u rrëzuar , duke gërvishtur gishtat pas mureve të gurma e të mprehta. Papritur nga një çarje në shkallë u shfaq një gjarpër i vogël, i shpejtë. Ndjeu gjarpurin tek iu mbështoll rreth kyçit të këmbës, por megjithatë vazhdoi të vraponte. Thirrjet e konduktorëve më në fund u ndalën, pastaj ajo dëgjoi trenin që filloi të lëvizte përsëri, rrugës për në bërthamën e ngrirë të tokës, duke lëshuar një tingull si të një bubullime të largët. Vetëm atëherë ajo u ndal.

Mbështetur për një çast pas murit të njollosur nga bloza, duke gulçuar si një kafshë e rënë në pre, ajo u përpoq të gëlltiste shijen e lëngshme të tunxhit në gojën e saj. Ishte e lirë.

Bëri ca hapa të tjerë duke u tërhequr zvarrë nëpër shkallët e errëta, dhe sa më lart që shkonte, aq më të gjera e më të lëmuara bëheshin shkalloret, dhe ajri më i hollë, më i lehtë. Dalëngadalë e çara u zgjerua dhe nga aty, diku nga lartë, u dëgjua zhurma e një zileje , e qartë dhe melodike. Gjarpri doli nga kyçi i këmbës dhe u zhduk në mur.

Ndërsa bëri kthesën tjetër në shkallë, rrezet e diellit shpërthyen dhe ajo ndjeu aromën e harruar të ajrit të ëmbël, tokës dhe barit të sapokositur . Më tej ishte një portë harkore që të çonte në një park.

Maria arriti në majë të shkallëve, duke shikuar drejt rrjetës së gjallë dhe të artë të dritës së diellit. Nga trotuari u ngritën ca pëllumba e bardhë e blu duke fluturuar mbi kokën e saj; ajo dëgjoi të qeshurat e fëmijëve duke lozur nëpër shkurrete . Rreth e qark parkut, bedenat e qytetit ngriheshin në kunja të larta graniti të bardhë, dritaret e të cilave shkëlqenin në diell.

Si të ishte zgjuar nga gjumi i vdekjes, ajo ndoqi rrugën e zhavorrit që vezullonte me gurë të vegjël stralli. Ishte pranverë dhe në një cep të rrugës ajo vuri re një grua që po shiste lule ndërsa ajo vetë këndonte nën zë. Maria pa kutitë plot me trëndafila të bardhë dhe agulice të verdha, me gjethe gri të shpërndara si fjongo rreth tyre dhe gruan me pallton e kafenjtë që përkulej me një ndjenjë mëmësie mbi tufën me lule. Kur u afrua Maria, gruaja ngriti kokën, ndeshi shikimin e Marisë me sytë e saj blu duke i buzëqeshur asaj në mënyrë triumfuese.

“Të kam pritur, mikja ime,” tha ajo.



së shpejti

Gjovalin Gjadri

B2

Dramë në pesë akte



Onufri